



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr Gjergji Pendavinji
2. Prof.Dr Irena Nikaj

Prill 2023

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore” që prezantohet nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës ofrohet në përputhje me interesat kombëtare, në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë dhe në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin.

Tërësia e komponentëve të programit të studimit në mënyrë të harmonizuar synon të përgatitë qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale duke kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Programi është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Ai synon t’i orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe kritik dhe t’i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës, në procesin e zhvillimit lokal dhe kombëtar.

Gjithashtu programi synon t’i aftësojë studentët të hartojnë një projekt kërkimi si përvojë e vlefshme që studenti të vijojë edhe ciklin e tretë të studimeve .

Institucioni dhe Departamenti i Sociologjisë ka kryer në mënyrë periodike studime mbi nevojat e tregut lokal e kombëtar të punës për programet e studimit duke mbledhur të dhëna mbi punësimin e studentëve pas diplomimit dhe sektorët e punësimit. Departamenti ka zhvilluar intervista, sondazhe lidhur me nevojat e tregut kombëtar të punës. Ai ka reflektuar ndryshimet në kuadrin ligjor të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e implementimit të Kartës së Bolonjës, riorganizimin e programit të studimit në tre nivele (bachelor, master dhe doktoratura).

Programi i studimit, i hartuar në vitin 2008 dhe i përmirësuar ndër vite, plotëson kriteret dhe objektivat lidhur me legjislacionin e BE-së për arsimin e lartë si dhe mbështetet në përvojën disa vjecare.



Përvoja dhe kapacitetet akademike janë premisa themelore për të programuar dhe zhvilluar këtë program studimi. Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë që ofrojnë programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit.

Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, është mbështetur në procesin mësimor e formues të studentëve përmes praktikave profesionale me mbi 45 institucione qendrore e lokale.

Në fushën e kërkimit shkencor departamenti vlerëson ecurinë e rezultateve të paktën një herë në vit nëpërmjet një analize për ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të secilit pedagog, dhe të projekteve shkencore të departamentit.

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat



mësimore dhe aktivitetet e tjera të veprimtarive formuese janë organizuar në disa kategori në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe me kreditet përkatëse.

Kemi mendimin se ky program zhvillon njohuri të avancuara akademike, aftësi dhe kompetenca të përparuara profesionale në fushën e studimit të shoqërisë.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standarteve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”.



Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për organizmin e ASCAL, dhe në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni për akreditimin e programit Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Gjergji Pendavinji dhe Prof. Dr. Irena Nikaj. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Pas komunikimit nga ASCAL, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët studiuuan dhe vlerësuan dosjen e programit, raportin e vetëvlerësimit dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, ngarkuar në sistem. Ekspertët mbas njohjes dhe vlerësimit të gjithë dokumentacionit, bënë përgatitjet e nevojshme, përpiluan pyetjet dhe evidentuan paqartësitë e tyre, si dhe u caktuan nëpërmjet ASCAL-it datat e vizitave në institucion. Vizita në institucion u krye në datat 12-13 shtator 2022. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i Fakultetit të Shkencave Sociale, UT, u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 27/03/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/59 Prot., datë 27/03/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1045 Prot., datë 07/04/2023 ku shprehet se dakordësohet me DRVJ-në e hartuar nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore” prezantohet nga Departamenti i Sociologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës ofrohet në përputhje me interesat kombëtare, në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë dhe në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (2017-2022).
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Tërësia e komponentëve të programit të studimit në mënyrë të harmonizuar synojnë që përmes kërkimit shkencor dhe edukimit të përgatisin qytetarë të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Programi i studimit bazohet në ofrimin e një kurrikule bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore” konsideron si pjesë të vizionit të tij promovimin e vlerave kulturore kombëtare në kontekstin ndërkombëtar, nëpërmjet studentëve të ekselencës si dhe nëpërmjet kurrikulës dhe përmbajtjes së programit. Ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike dhe kombëtare shprehet çartë edhe në planet lëndore të programit të studimit si psh: Sociologji e kulturës, Ndryshimet bashkëkohore të familjes, Perspektiva e ndryshimeve urbane, Sociologji e procesit zgjedhor, Politikat sociale krahasuese, Analiza sociologjike e imazhit, etj. Në hartimin e programeve lëndore të programit konsiderohet në mënyrë konsistente profili kombëtar i lëndëve. [Evidencat 3.5.; 4.1. dhe 4.3.]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” i cili paraqitet nga Departamenti i Sociologjisë në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Ky program studimi ka si mision të tijin të ofrojë program mësimor konkurues bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikula bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësinë së jetës dhe kërkimin shkencor në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë. [Evidencat 1.2.; 2.6.; 3.5.; 3.6.]
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në	Në dokumentet e strategjive të zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë, të kërkimit shkencor, të kurrikulave të studimit dhe të zhvillimit të programit të

<p>përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>studimit, vënë në dispozicion të RVJ, shprehet qartë prirja për të optimalizuar potencialin e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Kurrikula e programit të studimit dhe përmbajtjet lëndore janë në mbështetje të zhvillimit të prioriteteteve kombëtare. Ky program synon t'i orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe kritik me bazë ndërdisiplinore dhe t'i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës, duke ndikuar kështu në krijimin e një kapitali social që në tregun e punës do të ndikojë pozitivisht për zhvillimin lokal dhe kombëtar. Programi i studimit "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore", synon promovimin e aftësisë së mendimit kritik, të domosdoshëm për një pjesëmarrje efektive personale, profesionale të studentëve në çështje me interes publik.</p> <p>[Evidencat 1.4.; 3.5.; 3.2.; 4.1.]</p>						
<p>Kriteri 5. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe pas intervistave me aktorët e përfshirë në këtë program studimi rezulton se programi ofron një sërë mjetesh teoriko-praktike për të vijuar në studimet e nivelit të tretë. Ky program i aftëson studentët të hartojnë një projekt kërkimi si dhe përpunimin e tij përgjatë procesit metodologjik në fazat përkatëse të tij. Kjo përvojë është e vlefshme që studenti të vijojë ciklin e tretë të studimeve dhe të punojë në mënyrë të pavarur një projekt kërkimi doktorat. Më konkretisht, ndjekja e programit të studimit "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore" ju mundëson të diplomuarve, përveç të tjerash, mundësi për të avancuar në karrierë akademike dhe për të kryer studime të thelluara të ciklit të tretë në programe doktorale brenda dhe jashtë vendit në fushën e Sociologjisë. Në këtë kuadër veçojmë: Metodrat e kërkimit të avancuar në sociologjinë e zhvillimit, si dhe njohuri të thelluara akademike të përfshira në këtë program studimi.</p> <p>[Evidencat 1.2; 3.2.1.; 3.2.2.; 3.5.; 4.1]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 1111 708 1189">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="708 1111 948 1189">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="948 1111 1179 1189">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1189 708 1234"></td> <td data-bbox="708 1189 948 1234"></td> <td data-bbox="948 1189 1179 1234" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit konstatohet se programi "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore" ofrohet në përputhje me Statutin e UT dhe Strategjinë e UT 2018-2023. Strategjia e zhvillimit të këtij programi studimi është hartuar duke u bazuar, përveç të tjerash edhe në «Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023) ». Në strategjinë e Universitetit të Tiranës theksohet se të gjitha programet e studimit në UT kanë si emërues të përbashkët nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debat i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike. Në programin "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore", synohet promovimi i aftësisë së mendimit kritik, i domosdoshëm për një pjesëmarrje efektive personale,</p>





	profesionale të studentëve në çështje me interes publik. [Evidencat 1.4.; 3.5.; 3.6.]		
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezultojnë se drejtimit prioritar të zhvillimit akademik të institucionit janë përcaktuar në Strategjinë e Institucionit, Statutin e Universitetit si dhe në rregulloren e Universitetit. Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” i ofruar nga Departamenti i Sociologjisë, funksionon në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Tiranës. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë; Statuti dhe rregullore të Universitetit të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe të shprehura në formimin e sociologëve. [Evidencat 1.2.; 1.3.; 1.4.; 3.5. 4.1.]		
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se në Fakultetin e Shkencave Sociale, sipas standarteve ndërkombëtare të arsimit të lartë, ofrohen programe studimi në fushën e psikologjisë, edukimit, shkencave politike, punë dhe politika sociale si dhe në sociologji. Hartimi i programit të studimit Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, syllabusave të lëndëve, rregullores përkatëse e dokumenteve të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe veçanërisht Departamentit të Sociologjisë. Emërtimi, organizimi dhe struktura e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. [Evidencat 1.3.; 2.6.; 3.3.; 3.6.; 4.1.]		
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Programi “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare dhe zhvillohet në funksion të saj. Në fokus të tij qëndron zhvillimi shoqëror i bazuar në vlerat dhe drejtimit e një shoqërie demokratike që ka në themel të drejtat dhe liritë e qytetarit. Programi është në kohezion me strategjinë kombëtare dhe karakterin evolutiv të saj. Ai është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022), miratuar me VKM Nr. 710, datë 1.12.2017, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, duke u përpjekur edhe të ndjekë prirjet globale të zhvillimit, përmes përditësimit të njohurive dhe pasurimit të literaturës që ofrohen nga kurset universitare. [Evidencat 3.2.1.; 3.2.2.; 3.5.; 4.1]		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3



Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentit: “Kornizat konceptuale të programit të studimit dhe Strategjia e zhvillimit të programit të studimit” Departamenti i Sociologjisë ka përcaktuar dy objektiva themelore: 1.Programi të ndërtohet mbi bazën e njohurive të fituara nga niveli “Baçelor” dhe 2.Programi të integrojë njohuri të thelluara shkencore së bashku me metodat e avancuara të kërkimit sociologjik në qasjet sasiore dhe cilësore. Pra nga ky dokumentacion i vënë në dispozicion rezulton se objektivat e programit janë ndërtuar në bazë të vazhdimësisë së formimit të mëparshëm të studentëve dhe synimeve të pritshmërisë formuese të këtij programi. Shprehimisht synimet e programit që po vlerësojmë, sintetizojnë njohuritë e thelluara akademike, shprehitë dhe kompetencat profesionale si vijon: Ai synon;</p> <ul style="list-style-type: none"> • dije të avancuara në teoritë dhe konceptet sociologjike, si dhe metodat e kërkimit; • aftësitë për të kuptuar ndryshimet e mëdha shoqërore jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon, si dhe në nivelin global; • aftësitë për të aplikuar dijen e avancuar sociologjike ndaj problemeve sociale; • aftësitë e duhura në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ndjekin karrierë në sektorin publik, privat, si dhe në sektorin jofitimprurës; • një themel të shëndoshë akademik, në mënyrë që ata të jenë të suksesshëm në ndjekjen e studimeve doktorale pasi ata të kenë mbaruar programin e masterit. <p>[Evidencat 3.5.; 4.1.]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Pas shqyrtimit të të dhënave rezulton se ky program studimi është hapur me Vendim Nr.1331, datë 01.10.2008. Në vitin 2008, Departamenti i asaj kohe i (Sociologji-Filozofi- Shkenca Politike) u riorganizua përkatësisht në tre departamente. Departamenti i ri i Sociologjisë ka zhvilluar intervista, sondazhe lidhur me nevojat e tregut kombëtar të punës, ndryshimet në kuadrin ligjor të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e implementimit të Kartës së Bolonjës, riorganizimin e programit të studimit në tre nivele (bachelor, master dhe doktoratura) e në këtë kuadër të studimeve të ciklit të dytë “Diplomë e nivelit të dytë” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”.</p> <p>[Evidenca 3.4.; 3.4.1.]</p> <p>Më tej institucioni ka kryer në mënyrë periodike studime mbi nevojat e tregut lokal e kombëtar të punës për programet e studimit duke mbledhur të dhëna mbi punësimin e studentëve pas diplomimit dhe sektorët e punësimit të fushës. Kështu Departamenti i Sociologjisë ka kryer në vitin 2021 studimin e tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve për intervalin kohor 2018-2021.</p> <p>[Evidenca 3.31.]</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësive e kompetencave që i</p>	<p>Duke ju referuar analizës së “Kornizës konceptuale” të këtij programi si dhe dokumentacionit shoqëruar të dosjes rezulton të ketë patur një vëmendje të posaçme njohja e kërkesave të tregut të punës në kushtëzimin e njohurive, aftësive, shprehive dhe kompetencave të përfshira në programin “Master i shkencave” në “Sociologjinë e zhvillimeve shoqërore” Ajo që ne</p>




<p>përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>evidentojmë lidhet me përfshirjen në një strukturë të përmbajtjes që mundëson përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> <p>Studentët në përfundim të studimeve të këtij programi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohin me kompetencë metodat dhe instrumentet e kërkimit sociologjik; janë të aftë të konceptojnë, ndërtojnë dhe zbatojnë një projekt kërkimi; - zotërojnë dije dhe njohuri të plota mbi teoritë dhe paradigmat bashkëkohore sociologjike; - zhvillojnë analiza teorike dhe praktike të dukurive dhe problemeve sociale; - janë të aftë të shfaqin standarde të larta etike dhe formimi sociologjik për të zhvilluar me dinjitet aktivitetin e tyre në shoqëri; - njohin problematikën, punën në grup dhe zbatojnë me korrektësi afatet e punës; - orientojnë karrierën e tyre si sociologë në shërbim të interesave më të larta të shoqërisë.” <p>- [Evidencat 4.1.; 3.5.]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar të dhënave dhe takimeve në institucion rezulton se ky program është hartuar dhe orientuar duke mbajtur parasysh edhe programe të ngjashme të universiteteve evropiane duke e vënë theksin në përvojat universitare gjermane dhe angleze. Përvoja evropiane ofron programe të ngjashme të nivelit “Master i shkencave” sidomos tek zhvillimet e faktorëve njerëzorë e sociale për të moderuar dhe drejtuar proceset e sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm lokal e kombëtar. Kështu mund të përmendim edhe programe të tilla si “Master shkencash” në fushën e “Inovacionit dhe shoqërisë” mbi bazën e programeve të ngjashme në universitete evropiane perëndimore dhe kryesisht referuar modeleve Gjermane dhe Angleze. Tema e inovacionit shoqëror është prioritarë për studimet evropiane të këtij niveli. Ndaj dhe u sugjerua në takimin me GVB dhe Departamentin e Sociologjisë përfshirja në këtë program edhe të ndonjë moduli mbi “Inovacionin në shoqëri”</p> <p>Mbështetja tek përvoja evropiane reflektohet edhe tek literatura e rekomanduar e kurikulës përkatëse e cila u vihej në dispozicion studentëve nga biblioteka e Institucionit. Por anëtarët e personelit akademik pohuan se programi “Master i shkencave” mbështetet edhe tek programe të ngjashme në “Shtetet e Bashkuara, Francë, Itali etj, falë specializimeve të kryera jashtë vendit për këtë qëllim. Ky program është i organizuar në lëndë të vlerësuara sipas sistemit ECTS të krediteve, si rrjedhojë e të cilit mundësohet transferimi dhe njohja e kurikulës së këtij programi studimi të ofruar nga Departamenti i Sociologjisë në universitete të tjera brenda apo jashtë vendit.</p> <p>[Evidencat 3.5.; 4.1.; 4.2.]</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveqare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit, i hartuar në vitin 2008 dhe i përmirësuar dhe përshtatur ndër vite, plotëson kriteret dhe objektivat lidhur me legjislacionin e BE-së për arsimin e lartë si dhe mbështetet në përvojën disa vjecare të Departamentit të Sociologjisë, të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe UT-së, Karta e Bolonjës, misioni i së cilës ka qënë integrimi universitar evropian duke krijuar një hapësirë evropiane të studimeve universitare dhe njohjen reciproke, në këtë kuadër të njohurive, niveleve të diplomimit nëpërmjet</p>





	<p>sistemit ECTS (të transferimit të krediteve). Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë kanë punuar intensivisht për organizimin e studimeve sipas procesit të Bolonjës.</p> <p>Ky program studimesh është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas "Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve" (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite.</p> <p>I mbështetur në përvojat më të mirat të disa vendeve të zhvilluara si: Gjermanisë, Francës, Italisë etj, ky program studimi ofrohet në mënyrë të harmonizuar me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.</p> <p>[Evidencat 3.5.; 4.1.; 4.2.3.]</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se programi përfshin kurse, koncepte, metoda dhe mjete të tjera në funksion të aftësimin profesional dhe praktik të studentëve. Ata kryejnë një praktikë profesionale pranë institucioneve publike ose jo publike, gjatë zhvillimit të programit. Kjo ka ndikuar shumë jo vetëm në përmbushje të objektivave të programit por edhe të praktikave europiane për profesionet e rregulluara,</p> <p>Referuar dokumentacionit dhe intervistave me pedagogët dhe studentët theksi u vu mbi zhvillimin e aftësive përmes veprimtarive formuese që përfshin ky program si: puna mësimore në auditor nëpërmjet leksioneve, seminareve, formave të kontrollit të vazhdueshëm, refleksionit të praktikave profesionale në sënca të veçanta në auditor; studimi individual, realizim detyrash kursi apo projektsh kërkimi; përgatitjes për provime; përgatitjes dhe mbrojtjes të temave të diplomave; por edhe veprimtari të tjera në shërbim të veprimtarive formuese si sesione shkencore, konferenca, promovime punimesh studimore etj.</p> <p>[Evidencat 4.2.; 4.2.1.; 4.3.; 3.21.]²</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Në funksion të krijimit të një klime favorizuese për ndjekjen e studimeve në këtë program por edhe për të rritur atraktivitetin për studentët qoftë nga trojet shqiptare qoftë nga vendet e tjera Institucioni dhe Departamenti i Sociologjisë ka përpunuar procedurat dhe kriteret e pranimit që lejojnë çdo student të interesuar për t'u bërë pjesë e këtij masteri shkencor. Në kuadër të ndërkombëtarizimit, i cili përbën një nga prioritetet strategjike të zhvillimit të programit të studimit "Master i Shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore", Departamenti ka përgatitur sillabuset dhe literaturën në anglisht, për të qenë të hapur edhe ndaj kandidatave të studentëve të huaj jashtë hapësirës shqipfolëse.</p> <p>Gjithashtu stafi mësimdhënës ka synuar aftësimin e tij për të dhënë mësim në gjuhë të ndryshme të BE, OECD, dhe G20, kryesisht në gjuhën angleze. Zhvillimi i kompetencës gjuhësore të stafit akademik shihet edhe si prioritet për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore shkencore si kongrese, konferenca shkencore, trajnime profesionale jashtë vendit. Stafi akademik është angazhuar në mjaft veprimtari kërkimore shkencore të publikuar në vende të ndryshme të botës, dhe duke u angazhuar në mobilitete mësimdhënies jashtë Republikës së Shqipërisë. Në dokumentacionin e depozituar, në kontekstin e hapave drejt ndërkombëtarizimit përpos marrëveshjeve insitucionale kuadër bie në sy draft marrëveshja e bashkëpunimit të Departamentit të Sociologjisë me University of Southern Denmark, e cila gjatë takimeve rezultoi se kishte marrë formë ekzekutive në korrik të vitit</p>






	2022 me nënshkrimin nga palët respektive, duke dëshmuar kështu një hap tjetër drejt mundësive për thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.” [Evidencat 5.1.; 5.2.; 5.3.; 5.4.; 3.21. 4.11.; 4.6.]						
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për këtë program studimi, krahas dokumentave në shqip, ofrohen në gjuhën angleze edhe: <ul style="list-style-type: none"> - Suplement i diplomës. - Programet e të gjitha lëndëve - Një pjesë e rëndësishme e literaturës për cdo lëndë - Korniza konceptuale e programit të studimit - Plani mësimor i programit të studimit - Rregullorja e programit të studimit [Evidencat 3.10.; 4.10.; 5.1.; 5.2.; 5.3.; 5.4.]						
Shkalla e përmbushjes së standardit kuptim	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.4	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Përvoja dhe kapacitetet akademike vlerësohen nga pedagogët dhe GVB si premisë themelore për të programuar dhe zhvilluar këtë program studimi. Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë që ofrojnë programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” dëshmojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit. Departamenti i Sociologjisë, në vitin akademik 2021-2022, ka patur në përbërjen e tij 10 lektorë me kohë të plotë, me grada e tituj shkencorë (1) Prof. Dr.; (2) Prof. Asoc. Dr.; (6) Dr.; (1) Dr.proc., të cilët ofrojnë kapacitetet e duhura profesionale për ofrimin cilësor të mësimdhënies për programin e studimit. Kurrikula e këtij program studimi mbulohet në masën 90% nga personel akademik me kohë të plotë në Departamentin e Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale. [Evidencat 4.5.; 4.7.; 4.11.; 4.12.; 4.13; 4.15.]
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi që po vlerësohet, “Master i Shkencave në Sociologjinë e zhvillimeve shoqërore”, ofrohet nga Departamenti i Sociologjisë si njësi bazë përgjegjëse pranë njësisë kryesore; Fakultetit të Shkencave Sociale. Kjo na lejon të pohojmë se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, referuar rregullores së këtij fakulteti dhe Rregullores së Programit të Studimit. Parimet dhe kërkesat themelore të programit të studimit, burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë; Statuti dhe rregullore të Universitetit të Tiranës në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e sociologëve. Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, është program






	<p>studimesh i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS). Po kështu integrimi në hapësirën universitare evropiane shtron si nevojë të domosdoshme përafrimin e standardeve akademike shkencore me standardet evropiane. Ky përbën edhe një objektivi të rëndësishëm të shprehur edhe në Strategjitë e Zhvillimit të Departamentit si dhe të programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Në dokumentat e strategjive institucionale përmendet nevoja e harmonizimit të akteve ligjore e udhëzimeve tona kombëtare me ato evropiane.</p> <p>[Evidencat 1.4.; 2.4.; 3.5.; 3.6.; 4.1.]</p>						
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Duke ju referuar klasifikimit të fushave të studimit dhe kodifikimit të programeve të studimit na rezulton se programi që po vlerësojmë “Master i shkencave,, në ‘Sociologjine e zhvillimeve shoqërore” ka përputhje midis fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushes akademike e kërkimore të njësisë bazë pra Departamentit të Sociologjisë që është edhe përgjegjëse për këtë program studimi. Gjithashtu kjo përkatësi vërehet se është në përputhje me klasifikimet e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. [Evidencat 3.3.; 3.6.; 4.1.]</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Pas vlerësimit të të dhënave të vëna në dispozicion si dhe pas shqyrtimit të marrëdhënieve mes aktorëve të ndryshëm brenda institucionit rezultoi se keto marrëdhënie akademike dhe profesionale mes njësisë bazë në FSHS të angazhuara në procesin akademik të zhvillimit dhe realizimit të këtij programi janë korrekte dhe funksionojnë mbi një klimë bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe mbështetjeje reciproke. Fryma e mirëkuptimit është e pranishme jo vetëm midis njësisë bazë por edhe midis pedagogëve. Mjaft pedagogë të njësisë bazë mbulojnë lëndë në njësi të tjera bazë të FSHS-së dhe më gjerë UT-së, sipas kompetencës së tyre akademike. Kjo frymë bashkëpunimi vërehet edhe në organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore për prezantimin e rezultateve të projekteve kërkimore si konferenca e sesione shkencore. Departamenti i Sociologjisë inspiron një përvijë të mirë bashkëpunimi jo vetëm me njësi bazë brenda FSHS-së, por dhe me fakultete të tjera me të cilat ka ndërtuar kurrikula studimi të përbashkëta për programe studimi të ciklit të II. Ky bashkëpunim ka ndikuar pozitivisht në arritjen e konsensusit për ndërtimin e kurrikulave, ndarjen e krediteve, përcaktimin e raporteve të ngarkesës akademike mbi bazën e udhëzimeve përkatëse qeveritare e institucionale. Referuar dosjes të</p>






	<p>vënë në dispozicionin tonë vërehet se këto marrëdhënie analizohen periodikisht në raportet vjetore të punës së departamentit si dhe në raportet e sigurimit të cilësisë</p> <p>[Evidencat 2.1.; 3.18.; 3.23.]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nëpërmjet dokumentacionit dhe pas vizitave në institucion dëshmohet se njësia kryesore, por edhe ajo bazë kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të tjera akademike shtetërore e private dhe shumë aktorë të tjerë që lehtësojnë e ndihmojnë në formimin akademik e profesional të studentëve të këtij programi. Kështu mund të përmendim; organizata profesionale, komunitetin e biznesit, si dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm, në hapësirën universitare shqiptare dhe me universitete evropiane.</p> <p>Në këtë aspekt programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, është mbështetur në procesin mësimor e formues të studentëve përmes praktikave profesionale me mbi 45 institucione ku mund të përmenden: Agjencia e Rinisë, Qendra Komunitare Multidisiplinare, Bashkia e Tiranës, e një sërë organizatash të tjera kombëtare, lokale ose përfaqësuese të shoqërisë civile. Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit janë organizuar Konferenca shkencore në bashkëpunim me partnerët homologë të universiteteve publike si Universitetin “Fan Noli” të Korçës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan etj, Në këto konferenca janë angazhuar edhe studentë të cikleve të ndryshme të studimit, përfshirë edhe studentët e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”.</p> <p>[Evidencat 3.18.; 3.19.; 3.21.; 3.21.2.; 4.6.]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” dëshmohet të jetë nënshkruar një numur marrëveshesh të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, të cilat organizohen dhe drejtohen sipas një udhëzuesi të posaçëm mbi praktikat profesionale. Vëllimi i marrëveshjeve është i konsiderueshëm, ato afërsisht janë 44 të tilla duke përfshirë marrëveshje ndëruniversitare, marrëveshje me institute kërkimi, me aktorë të qeverisjes vendore (Bashkia e Tiranës), me organizata joqeveritare (Agjencia e rinisë), me Qendrën komunitare multidisiplinare) e të tjera. Realizimi i praktikës profesionale në institucione orientohet dhe zhvillohet mbi bazën e Manualit të Praktikave që Departamenti i Sociologjisë e ka përgatitur për këtë qëllim.</p> <p>[Evidencat 3.6.; 3.21.; 4.4.]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në takimin e zhvilluar në dt.12 shtator 2022 si dhe në dokumentet e referuara tek evidencat e më poshtme u evidentua se ky departament ka hartuar marrëveshje zyrtare, të nënshkruara nga punëdhënësit e institucioneve të ndryshme, ku studentët e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” zhvillojnë praktikat profesionale.</p> <p>Gjithashtu, lektorët që mbikëqyrin praktikat profesionale, ndjekin nga afër ecurinë e bashkëpunimit me këto institucione në funksion të realizimit të qëllimit të praktikave profesionale dhe të zbatimit të objektivave të programit të studimit. Ato janë bërë vijimësisht objekt i analizave vjetore në këtë departament.</p> <p>[Evidencat 3.21.; 4.4.]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe</p>	<p>IUT dhe Fakulteti i Shkencave Sociale ka mundur dhe garantuar bashkëpunimin me fakultete apo institucione të tjera, duke ofruar lehtësira në mobilitetin e stafit pedagogjik. Personeli akademik i Departamentit ka marrë</p>

<p>mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>pjesë në mjaft aktivitete kërkimore- shkencore si kongrese, konferenca, seminare etj, duke u ndihmuar dhe lehtësuar sipas mundësive nga institucioni.</p> <p>Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe projekteve ndërkombëtare. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë vendit ose kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit, për aq sa është e mundur.</p> <p>Departamenti i Sociologjise ka pritur dhe mbështetur edhe studentë nga universitete të tjera (rasti i studentes nga Universiteti i Trentos), duke i asistuar edhe përgjatë punës së tyre për kërkime në kuadrë të përgatitjes së temës të diplomës.</p> <p>[Evidenca 1.6.; 2.24.; 2.25.; 3.6.; 3.20.; 3.22]</p>								
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë nëpërmjet analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit analizon edhe impaktin dhe përfitimin nga bashkëpunimi me universitete apo institucione kërkimore duke reflektuar anët positive dhe mangësitë të cilat duhet të përmirësohen në vijimësinë e bashkëpunimit. Referuar dokumentave ka të dhëna të përgjithshme të marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve akademike apo profesionale. Analiza e vazhdueshme e kësaj pune pasqyrohet edhe në raportet e sigurimit të cilësisë. Pasqyra të analizës krahasuese tregojnë angazhimet e lektorëve dhe studentëve në veprimtari kërkimore shkencore dhe aktivitete të zhvilluara në sajë të bashkëpunimeve institucionale. Këto të fundit paraqiten periodikisht në raporte përmbledhëse si raportet e efikasitetit të marrëveshjeve, apo raportet vjetore të punës së Departamentit .</p> <p>[Evidencat 3.18.; 3.19.; 4.6.]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet						
			X						

<p>Standardi I.6 Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni dëshmon se ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. Nëpërmjet Vendimit Nr.36, datë 02.09.2021 UT-ja mbështet personelin akademik për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit në veprimtari kërkimore shkencore ndërkombëtare duke miratuar programin e Grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare. UT-ja gjithashtu nxit aktivitetin kërkimor nëpërmjet praktikës së thirrjeve për projekte të financuara nga UT, në të cilat aplikues janë personeli akademik, por mund të përfshihen edhe studentë duke hartuar edhe udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor në UT. Një tjetër praktikë e evidentuar është mbështetja financiare e realizimit të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare me pjesëmarrje të personelit akademik dhe studentëve, si dhe botimeve të revistave në FSHS dhe përkatësisht edhe të DS.</p> <p>[Evidenca 1.18.; 1.16. 3.24.; 4.11.; 4.6.]</p>





<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Rezultoni se departamenti vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të paktën një herë në vit nëpërmjet një analize për ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të secilit pedagog, dhe të projekteve shkencore të departamentit. Vlerësimi i rezultateve dhe ecurisë së punës kërkimore shqyrtohet në një analizë vjetore të posaçme të veprimtarisë kërkimore-shkencore në rang departamenti dhe fakulteti. Vlerësimi i arritjeve të punës kërkimore realizohet edhe nga komisioni ad hoc i përbërë nga profesorë të fakultetit. [Evidencat 3.18.; 4.6.; 4.11.]</p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në këtë kuadër institucioni ndjek një politikë promovuese të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Nga të dhënat dhe opinionet e stafit akademik të këtij departamenti si dhe opinionit të studentëve dëshmohet se institucioni ka ndërmarrë disa përmirësime rregulluese që synojnë promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, si dhe mbështetjen e stafit për mobilitet jashtë vendit. [Evidencat 1.16.; 1.18.; 3.18.; 3.25.; 4.6.; 4.11]</p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika të qarta për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese, shprehur në dokumente si Kodi i Etikës së UT, në strategjitë e zhvillimit të Institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit. Politikat e mbrojtjes së pronësisë gjenden të shprehura qartë edhe në udhëzimet për detyrat e kursit në syllabuset e lëndëve si dhe në udhëzuesin për punimin e diplomës. [Evidencat 1.3.; 1.4.; 1.5.; 2.3.; 2.4.; 3.6.; 3.6.1.; 4.3.]</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Gjatë takimeve me studentë dhe bisedave me ta rezultoi se personeli i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, vazhdimisht inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor dhe mbështet me asistencë profesionale këto iniciativa. Këto dëshmi faktohen edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Gjithashtu studentët inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete me qëllim kërkimor e shkencor, nëpërmjet thirrjeve të ndryshme që publikohen në rrjetet zyrtare sociale të Departamentit të Sociologjisë. Inkurajimi i mobilitetit të studentëve që ndjekin programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, përbën një tjetër rrugë mbështetjeje në funksion të kërkimit dhe zhvillimit të aftësive të tyre për tu marrë me punë të pavarur kërkimore. [Evidencat 4.6.; 3.21.1.; 3.20.; 3.30.]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTERI SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Pas njohjes me programin e studimit rezulton se programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera të veprimtarive formuese janë organizuar në disa kategori në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore dhe me kreditet përkatëse. Programi i studimit është organizuar në 4 semestra (2 vite akademike me nga 60 kredite cdo vit) dhe një total prej 120 kreditesh. Lëndët janë të organizuara dhe të vlerësuara në raport me peshën specifike që kanë në program, në semestra si dhe në varësi të orëve që ato kanë në program duke i llogaritur me kohën (fizike në auditor dhe jashtë tij) që përmbahet në një kredit.</p> <p><i>[Evidencat 4.1.; 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Pas njohjes me dokumentacionin përkatës rezulton se ky program ofron njohuri të gjëra akademike dhe profesionale për profilin e sociologut. Gjithashtu programi ka edhe synim specializues duke i aftësuar studentët për të thelluar mëtej këto njohuri. Programi, njëkohësisht synon formimin e shprehive të veçanta të domosdoshme për këtë profesion si shprehitë komunikuese me subjektet sociale, të punës në grup, shprehitë e kapjes së problematikës sociale, problematizimin e situatave sociale që kërkojnë një ndërhyrje, shprehitë e një dialogu konstruktiv dhe bindës, kulturën e bashkëpunimit me subjekte në nevojë, disiplinën dhe korrektesinë në marrëdhëniet e punës, etj. Ajo që ka rëndësi në këtë proces është që krahas vëzhgimit dhe konstatimit të fenomenit social programi synon të zhvillojë edhe nuhatjen e një kërkuesi përmes përvetësimit të njohurive nga fusha e kërkimit sociologjik duke i kushtuar vëmendje konceptualizimit të fenomenit, parashtrimin të tij në një projekt kërkimi bazuar tek rregullat e metodologjisë. Kjo rrugë do t'i bëjë më të suksesshëm studentët në këtë profesion.</p> <p>Gama e shprehive, mendojmë se është e gjerë në aspektin e problematikës me të cilin ata do të merren si sociologë. Kështu ata mund të jenë në kontakt me një mjedis shkollor dhe mund të merren me problematikat e këtij sektori, siç mund të jenë, problemet e sjelljes, problemet e komunikimit me shokët dhe shoqet, problemet e paragjytimeve dhe stereotipeve, e shumë çështje të tjera. Nëse dikush mund të punojë në një komunitet; ai aftësohet për të menaxhuar konfliktet duke u bërë mediator në zgjidhjen me pajtim të tyre, nëse do të punësohet në organet e pushtetit vendor ose qëndror do të aktivizojë shprehitë</p>






	<p>analitike dhe ato të diskursit por edhe shprehitë dhe aftësitë e hartimit të një projekti sociologjik.</p> <p>Falë njohurve të konsoliduara në fushën e kërkimit; të analizës kulturore të konflikteve; të zhvillimeve bashkëkohore shoqërore në institucione si familja, politika, feja, arsimit; të prirjeve të zhvillimeve të hapësirës rurale dhe urbane; të çështjeve të barazisë dhe pabarazive, përfshirjes dhe përjashtimit social; të çështjeve gjinore, të politikave sociale; të zhvillimeve më të fundit në fushën e drejtësisë tranzitore, etj. Studentët e këtij programi kanë një hapje të gjerë dhe të larmishme profesionale dhe specialitetesh.</p> <p>[Evidencat 4.1.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi përmban mjaft lëndë me njohuri teorike të fushës së sociologjisë në kuadrin e të cilave integrohet edhe kritika nëpërmjet argumenteve teorike. Këto njohuri janë bashkëkohore në fushën e studimeve sociologjike duke nxitur dhe edukuar, qasje kritike dhe analitike nëpërmjet një larmie teknikash metodologjike. Nga kurrikula dhe bisedat me aktorë të përfshirë në realizimin e këtij program duket se njohuritë dhe studimi orientohen në një perspektivë të analizave të avancuara teorike sociologjike ndaj zhvillimeve të aktualitetit duke përmirësuar dhe pasuruar në mënyrë të vazhdueshme ofertën e studimit në këtë program si dhe duke respektuar parimet akademike të fushës së studimit.</p> <p>[Evidencat 4.1.; 3.5.; 3.6.; 4.2.1.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nisur nga një vështrim analitik i programit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” kemi mendimin se ai zhvillon njohuri të avancuara akademike, aftësi dhe kompetenca të përparura profesionale në fushën e studimit të shoqërisë. Gjithashtu studentet aftësohen për kapjen dhe zgjidhjen e problemeve komplekse që shoqërojnë zhvillimin e shoqërisë. Kështu ata:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aftësohen të hetojnë problemet sociale, ti konceptojnë dhe të parashtrajnë rrugën e zgjidhjes. - përvetësojnë mjaft njohuri bashkëkohore të teorive sociologjike dhe të një refleksioni kritik mbi këto teori. - njohin metodat dhe instrumentet e kërkimit të avancuar sociologjik; - aftësohen të hartojnë një projekt kërkimi; - zhvillojnë analiza teorike dhe praktike të dukurive komplekse dhe problemeve të mprehta sociale; - aftësohen të shfaqin standarte të larta etike dhe formimi sociologjik për të zhvilluar me dinjitet aktivitetin e tyre në shoqëri; - aftësohen për punën në grup dhe zbatimin me korrektësi të disiplinës së punës; - orientojnë karrierën e tyre si sociologë në shërbim të interesave më të larta të shoqërisë. <p>[Evidenca 4.1]</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit, syllabusat e lëndëve, rregullorja përkatëse e dokumenta të tjera që e shoqërojnë atë, mbajnë parasysh parimet e përgjithshme të zhvillimit të arsimit të lartë e kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ai është hartuar konform Ligjit të Arsimit të Lartë, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore qeveritare, udhëzimeve të Ministrit të Arsimit, Statutit dhe rregullores të UT. Programi i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e tij të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>[Evidenca 4.1.; 3.6.; 4.2.; 4.3.]</p>

<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ konstaton se programi studimor dhe kurset përkatëse janë formuar në mënyrë organike dhe funksionale në përgatitjen e studentit duke përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite:</p> <p>A. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 1 lëndë, ose 5 % të planit mësimor;</p> <p>B. Për përgatitje për disiplinën shkencore – 11 lëndë , ose 55 % e planit mësimor;</p> <p>C. Në lëndet ndërdisiplinore/integruse, përfshihen nëndisiplina dhe lëndë me zgjedhje - 3 lëndë, ose 15% te planit;</p> <p>D. Lëndët plotësuese përfshijnë 2 lëndë të planit, ose 10% të tij.</p> <p>E. Lëndet përmblylëse (Mbrojtja e Diplomës), ose 15 % të planit mësimor.</p> <p>[Evidenca 4.1.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3]</p>						
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj.</p>	<p>Në shqyrtim të planit të studimit GVJ konstaton se programi i studimit i ka të përcaktuara kreditet e nevojshme për dhënien e diplomës, d.m.th, 120 kredite. Programi përmbillet me hartimin e një mikroteze kërkimore-shkencore (prova finale), e cila ka të përcaktuara kreditet përkatëse dhe zë 15% të numrit të krediteve të planit mësimor, në përputhje me aktet nënligjore. Për provën finale të punimit të diplomës është hartuar edhe një rregullore e posaçme për diplomat e ciklit të dytë të studimeve në të cilën përshkruhen rregullat dhe aktivitetet e realizimit dhe hartimit të punimit të diplomës.</p> <p>[Evidencat 4.2.; 4.2.1.; 3.6.1]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe biseda me dekanin, përgjegjës in e departamentit konstatohet se menaxhimi i cilësisë për programet e studimit është në vëmendje dhe në rend të ditës. Pra është në interesin e institucionit administrimi dhe menaxhimi i cilësisë. Në Fakultetin e Shkencave Sociale ky aktivitet kryhet nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila në mënyrë periodike kryen vlerësime për cilësinë e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” brenda kuadrit të proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo njësi bashkëpunon me departamentin për përmbushjen me sukses të veprimtarisë vlerësuese dhe të hartimit të raporteve mbi cilësinë e programit të studimit. Ajo bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si edhe me agjensi dhe institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase e të huaja, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke siguruar një klimë bashkëpunuese për vlerësimin e cilësisë nëpërmjet proceseve të akreditimit.</p>



	<p>Në funksion të tyre, me propozim të njësisë bazë, ngrihen grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, të cilat miratohen dhe shpallen me vendim nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Sociale.</p> <p>[Evidencat 1.2.; 2.14.; 3.6.; 2.12.; 2.17.]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe njësia bazë, Departamenti i Sociologjisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, i përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike lidhur me ofrimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Organizimi dhe struktura akademike përbush detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, të akteve të brendshme rregullatore të Universitetit të Tiranës.</p> <p>[Evidencat 1.2.; 1.3.; 2.4.; 2.6.; 3.3.; 3.5.; 3.6.; 3.18.; 4.2.]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Mendojmë se Departamenti i Sociologjisë i përbush kërkesat që parashikon Ligji i Arsimit të Lartë, si njësi bazë, në lidhje me numrin e personelit akademik efektiv me kohë të plotë (10 pedagogë); dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik - departamenti ka 1 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 1 Ph.D., 1 Doc. Dr., 4 Dr. dhe 1 në proces doktorature.</p> <p>Gjithashtu departamenti ka edhe personel me kohë të pjesshme, dhe respekton raportin personel me kohë të plotë / personel me kohë të pjesshme dhe të ftuar nga ku rezulton se 90% e ngarkesës mësimore të programit të studimit realizohet nga personeli akademik me kohë të plotë në Departamentin e Sociologjisë. Angazhimi i personelit akademik përkon me fushën dhe nivelin e tyre të kualifikimit.</p> <p>[Evidencat 3.18.; 4.5.; 4.7.; 4.13.; 4.15.]</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë dëshmon se ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e gjithë programit mësimor “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Për ofrimin e këtij programi janë përfshirë lektorë të stafit akademik të këtij departamenti me tituj e grada deri te lektorë me kohë të pjesshme.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, dekanati i Fakultetit të Shkencave Sociale miraton strukturën mësimore të vitit akademik vijues të zhvillimit të programit të studimit.</p> <p>[Evidencat 2.6.; 3.18.; 4.5.; 4.2.; 4.15.]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësia bazë sigurojnë kapacitetet e mjaftueshme në burime njerëzore mbështetëse si personel administrativ dhe personel ndihmës/akademik. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel administrativ për vendet e lira të punës, propozohen nga kancelari. Dekani pasi i verifikon paraprakisht dhe është dakord me to, i përcjell në Rektorat për miratim dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës.</p> <p>[Evidenca 2.4]</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit</p>	<p>Nga dokumentacioni, por dhe nga dëshmitë pas takimeve në institucion rezulton se Departamenti i Sociologjisë ka caktuar një person përgjegjës në rolin e koordinatorit nga personeli akademik (PAE). Koordinatori bashkërendon punët për zhvillimin e programit dhe organizimin e praktikave mësimore. Mënyra se si caktohet koordinatori si dhe detyrat e përgjegjësitë e tij janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>[Evidencat 3.11.; 3.6.]</p>




dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.									
Kriteri-7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektiveve të programit dhe raporton në mënyrë periodike pranë drejtuesit të njësisë bazë ose departamentit në mbledhjet e tij. Detyrat dhe përgjegjësi e koordinatorit të programit të studimit përcaktohen në rregulloren e programit të studimit. [Evidenca 3.6. Neni 10.2.2.]								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet plotësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Konstatohet se Departamenti i Sociologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion pasqyrohet në Kornizën konceptuale të këtij programi studimi, planin mësimor të këtij programi, rregulloren e këtij programi studimi, rregulloren e praktikave, programet për çdo lëndë/modul, etj, ku janë të shprehura të gjithë elementët sasiore të tij: orët mësimore, ngarkesa në auditor, orët e studimit individual, kreditet, emërtimet e kurseve etj. [Evidenca 3.3.; 3.6.; 4.1.; 4.2.; 4.3.; 4.5.]
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Rezulton se plani mësimor i programit të studimit është në harmoni me Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (të ndryshuar) në drejtim të krediteve sipas ECTS-së. Programi studimor dhe kurset përkatëse janë formuar në mënyrë organike dhe funksionale për përgatitjen e studentit mbi bazën ngarkesës mësimore mbi të llogaritur në kredite. Ai përmban: lëndë, module, praktika profesionale dhe veprimtari formuese. Këta elementë strukturohen në: A. Për formimin e përgjithshëm kulturor e metodologjik – 1 lëndë, ose 5 % të planit mësimor; B. Për përgatitjen Përgatitje për disiplinën shkencore – 11 lëndë, ose 55 % e planit mësimor; C. Në lëndet ndërdisiplinore/integruese, përfshihen nëndisiplina dhe lëndë me zgjedhje - 3 lëndë, ose 15% të planit; Lëndët plotësuse përfshijnë 2 lëndë të planit, ose 10% të tij. D. Lëndet përmbyllëse (Mbrojtja e Diplomës), ose 15 % të planit mësimor. [Evidencat 4.1.; 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]
Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të	Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve

<p>vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>shoqërore” është organizuar konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimorë në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p>Në hartimin e programit respektohet standardi për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë një viti akademik. Një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p>[Evidenca 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit, që po vlerësohet, respekton të gjitha kriteret për sa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me akte nënligjore (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar) duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas semestrave akademike.</p> <p>[Evidencat 4.2.; 4.2.2.; 4.2.1.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ vëren se programi i studimit ka një rregullore të detajuar, të hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Këtu studenti mund të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, si edhe për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Në këtë program studimi pranohen për t'u rregjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor e nënligjor në fuqi.</p> <p>[Evidencat 3.6.; 3.14.1.]</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga dokumentacioni dëshmohet se programi i studimit përmban të gjitha programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë. Për praktikën profesionale është hartuar manuali për organizimin dhe drejtimin e tyre. Programi i studimit përmban gjithashtu shpërndarjen e orëve në seminare, leksione, orë praktike, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me udhëzimet e miratuara.</p> <p>Syllabuset e programeve përmbajnë informacion në lidhje me titullin e lëndës, objektivat e përgjithshëm/ specifike të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e leksioneve dhe seminareve për çdo lëndë, kohëzgjatjen e zhvillimit të lëndës, formën e kontrollit të dijes, numrin e krediteve, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar si dhe emrat e pedagogëve titullarë e lektorë. Syllabuset u jepen studentëve çdo fillim të kursit universitar, që të mund të njihet me elementet e përmendur më sipër.</p> <p>[Evidencat 3.6.; 4.3.; 4.4.]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik. miratohen ndryshimet eventuale dhe</p>	<p>Rezulton se programi i studimit përmirësohet në mënyrë periodike përmes pasurimit të literaturës së lëndëve, çështjeve, problematikave, koncepteve dhe teorive sociologjike.</p>

arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Plani mësimor ndryshohet vetëm kur ndryshimi është i domosdoshëm dhe i argumentuar brenda hapësirave ligjore që ka departamenti për t'ju përshtatur më mirë formimit akademik e profesional të studentëve si dhe tregut të punës. Programet e lëndëve mund të përmirësohen çdo vit akademik. Përgjegjesi i njësisë bazë ka detyrim të paraqesë programet e lëndëve në fillim të vitit akademik dhe në çdo rast përpara fillimit të procesit mësimor të asaj lënde duke e arkivuar dosjen e plotë në shqip dhe anglisht. [Evidencat 3.6.; 4.2.3.; 5.1.; 5.2.; 5.3.; 5.4.]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Konstatohet se ngarkesa e këtij programi studimi është organizuar dhe strukturuar në përputhje me parashikimet e akteve ligjore në fuqi, referuar veprimtarive formuese, ngarkesës mësimore shpërndarjes së krediteve. Programi ka 120 kredite, kohëzgjatja normale e tij është në dy vite akademike, secili me 60 kredite. Tipologjia e lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin mbështetet në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e UT, FSHS dhe programit të studimit. [Evidencat 4.1.; 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.]
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit, përmbajtja e veprimtarive formuese, lëndët dhe praktikat mësimore krijojnë kushte të favorshme jo vetëm në drejtim të përfitimit të njohurive dhe aftësive por edhe të thellimit të mëtejshëm mbi bazën e punës individuale gjatë ushtrimit të profesionit të sociologut. Ato ju japin mundësi studentëve të marrin njohuri të reja nga fusha e sociologjisë duke rritur potencialin për thellim të njohurive por edhe aftësive për studime të mëtejshme duke ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të shoqërisë. [Evidencat 4.1.; 4.2.; 4.3.; 3.5.]
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e organizuar dhe sistematike e lëndëve moduleve, vlerësuar sipas sistemit ETCS dhe orëve respektive, në dy vite dhe katër semestra, mendojmë se kënaqin objektivat formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. [Evidencat 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]
Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me	Kurrikula e programeve është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve euro-atlantike. Programet lëndore janë bazuar dhe kanë evoluar duke u mbështetur në programet ndërkombëtare dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al




<p>profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>duke marrë si model zhvillimi, qasjen që këto vende kanë pasur ndaj programeve të ngjashme të studimit. Bazuar në një shqyrtim analitik kemi mendimin se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e programit master dhe të përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. [Evidencat 4.1.; 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi përfshin veprimtari formuese të cilat zhvillojnë aftësi dhe shprehi profesionale që e ndihmojnë studentin të specializohet duke fituar kompetenca të nevojshme profesionale por edhe ndjekjen e një rruge të suksesshme kërkimore dhe akademike. Programi ka balancuar mirë aktivitetet teorike me ato praktike, aktivitetet formuese specifike, të cilat synojnë të mbështesin aspektin aplikativ të dijeve të akumuluar nga studentët. Bazuar në ngjashmëritë në kurrikul, sistemit ETCS, ky program lehtëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jashtë vendit si dhe punësimin e tyre. [Evidenca 4.1.; 4.2.; 4.2.1.; 4.2.2.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve dhe moduleve janë vazhdimisht në përmirësim duke reflektuar literaturën e rezultateve të reja studimore të publikuara në monografi e revista shkencore si dhe me të dhëna të reja nga fusha e eksplorimit në terren, të kerkimeve nga fusha e sociologjisë. Programi i studimit gjithashtu përmban syllabuset e detajuara si dhe formatet e miratuara në të cilat ato prezantohen. Ato përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse për studentët. Syllabuset përditësohen çdo vit akademik nga titullari i lëndës dhe dorëzohen në departament. Titullari kujdeset që syllabusat të mbështeten dhe të bazohen në literaturë bashkëkohore. [3.6. Rregullore e programit të studimit "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore". Neni 15, 16] [4.2.3. Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 11)]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit, në përmbajtjen e tij garanton përmbushjen e objektivave të synuara. Kurrikula e tij është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë të gjitha nevojat akademike për studentët, që ata të jenë të aftë të ndjekin studimet e thelluara pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve si dhe të zhvillojnë kompetencat profesionale në administrimin e problematikave sociale. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit. [Evidenca 3.5.; 3.6.; 3.18.; 3.23.; 4.1.]</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore" mundëson studentët të vijojnë, në varësi të rezultateve të arritura, studimet e ciklit të tretë, të studimeve doktorale si studime terminale. Po kështu programi synon të formojë sociologë të rinj të pajisur me aftësitë e duhura në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të ndjekin karrierë në sektorin publik, privat, si dhe në sektorin jofitimprurës. Të dhënat mbi punësimin e alumnit i posedon zyra e karrierës, por edhe Departamenti i Sociologjisë, kryhen vlerësime periodike të përshtatjes me tregun e punës të të diplomuarve, përpos studimeve që kryhen edhe nga UT. [Evidencat 4.1.; 3.6.; 3.5.; 4.9.; 3.31.]</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit</p>	<p>Nga dëshmitë e aktorëve të ndryshëm të takuar dhe nga dokumentacioni rezulton se përpunimi dhe përmirësimi i përmbajtjes të këtij programi për të</p>

<p>dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>qenë gjithmonë e më shumë atraktiv për tregun e punës mbetet preokupim themelor i Departamentit të Sociologjisë. Kjo u vu në dukje edhe nga takimi me personelin akademik por edhe me studentët. Për këtë qëllim organizohen konsulta me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës duke njohur mirë sugjerimet dhe nevojat e tyre. Departamenti i Sociologjisë gjithashtu zhvillon dhe përmirëson edhe më tej marrëveshjet e bashkëpunimit dhe të zhvillimit të partneriteteve në funksion të programit të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Këto marrëveshje orientohen si në përfshirjen e sa më shumë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Njësia bazë dëshmon se konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Ky reflektim shprehet në përmirësimet e nevojshme si të programit, ashtu edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>[Evidencat 3.5.; 3.18.; 3.19.; 3.31.]</p>						
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor në programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, mundësojnë përfitimin e njohurive të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve. Nga vizitat në institucion, takimin me studentët si dhe të dhënat e ofruara dëshmojnë se një përqindje e lartë e të diplomuarve në programin e ciklit të tretë kanë qenë të diplomuar në këtë program studimi në ciklin e dytë.</p> <p>[Evidenca 3.5.; 3.18.; 3.6.]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i brendshëm është punësuar pranë këtij departamenti në bazë të konkursit, procesi i cili ka përcaktuar kriteret sipas akteve ligjore në fuqi; Ligjit nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës, Statutit dhe Rregullores të Universitetit të Tiranës. Procedurat ligjore dhe transparente të parashikuara nga UT për rekrutimin e personelit akademik efektiv (PAE) dhe të jashtëm (PAK) shpallen publikisht dhe perzgjedhja realizohet me konkurs. Mbas rekrutimit, personeli akademik efektiv i nënshtrohet një procesi intensiv kualifikimi brenda dhe jashtë vendit. Ai e zhvillon këtë kualifikim sipas procesit ligjor të marrjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë.</p> <p>PAE në vitin akademik 2019-2020 përbëhej nga 8 antarë:</p> <p>1- Prof. Dr. 1- Prof. As. Dr. 5- Dr. 1- Dr.proc. .</p> <p>Ai mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit.</p>




Personeli akademik me kohë të pjesëshme (PAK) përbëhet nga 4 Dr. GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik për vendet e lira të punës, propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Rektori i Universitetit të Tiranës, i cili pasi i verifikon dhe është dakort me to, lejon nisjen e procedurës për publikimin e kritereve të konkursit për punësimin e personelit.
[Evidenca 1.2.; 1.3.; 3.17.]

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.



Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe Departamenti i Sociologjisë garanton mbulimin e lëndëve me staf akademik në përputhje me drejtimin e programit të studimit dhe specifikat e lëndëve. Në vitin akademik 2020-2021 Departamenti i Sociologjisë ka rritur me dy antarë PAE, dhe ka reduktuar PAK në 1 antar. Këtë vit ky program studimi mbulohet në rreth 90% të tij nga personeli efektiv i departamentit. Tabela e mëposhtme pasqyron përbërjen e departamentit:

Fakulteti i Shkencave Sociale (Viti akademik 2019- 2020)						
IAL	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i P ndihmës Akademik	Total
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	
Departamenti i Sociologjisë	8	(1) Prof. Dr. (1) Prof. Asoc. Dr. (5) Dr. (1) Dr.proc. (0) MSc.	4	(0) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. Dr. (4) Dr. (0) Dr.proc. (0) MSc.	3	15
Në total	8		4		3	15

Fakulteti i Shkencave Sociale (Viti akademik 2020-2021)						
IAL	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i P ndihmës Akademik	Total
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	
Departamenti i Sociologjisë	10	(1) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc. Dr. (6) Dr. (1) Dr.proc. (0) MSc.	1	(0) Prof. Dr. (0) Prof. Asoc. Dr. (1) Dr. (0) Dr.proc. (0) MSc.	4	15
Në total	10		1		4	15

[4.12. Tabelë përmbledhëse- Numri i personelit akademik për çdo njësi Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat, Personel ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabela 1 dhe 2)]

	<p>[4.11 Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit]</p> <p>[Evidenca 4.5.; 4.7.; 4.13.; 4.12.; 4.11.; 4.15.]</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik efektiv është i angazhuar tërësisht në veprimtari kërkimore. Fushat e drejtimit të kësaj veprimtarie janë në përputhje me procesin akademik si në kontekstin e përgjithshëm ashtu edhe atë specifik. Kjo veçori konstatohet në tematikat e Konferencave shkencore që i organizon Departamenti, në veprimtarinë botuese kërkimore-shkencore, në organin periodik por edhe në botimet e “Përmbledhjes së studimeve”. Po kështu edhe projektet kërkimore të doktoraturave që i miraton departamenti dhe i udhëheqin forcat e kualifikuara përgjithësisht përputhen me programin në aspektin akademik por edhe specifikën e moduleve të studimit.</p> <p>Personeli akademik ka një pjesëmarrje të gjerë në konferenca dhe veprimtari shkencore të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit me pjesëmarrje aktive dhe me prezantime të rezultateve të kërkimit në këto aktivitete shkencore. Karakteristikë e njësisë është që nëpërmjet koordinimit të brendshëm dhe përvojës në kërkim dhe mësimdhënie në departament ka edhe specialistë me prirje specifike fushash, gjë që ndihmon në procesin e mësimdhënies. Në disa raste, elementë të veçantë të punës shkencore pas diskutimeve, bëhen pjesë integrale e procesit mësimor .</p> <p>[Evidencat 3.18.; 4.7.; 4.11.; 4.15.]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti është pjesë e rrjetit të bashkëpunimit akademik e kërkimor me pedagogë e studentë të Institucioneve arsimore të larta homologe. Kjo është konkretizuar me organizimin e konferencave, seminareve e tryezave të përbashkëta, duke synuar forcimin dhe zgjerimin e shkëmbimit të përvojave akademike dhe atyre kërkimore në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Përfshirja e studentëve në konferencat dhe kërkimin shkencor ka qenë në vëmendjen e Departamentit të Sociologjisë.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët e vitit të dytë “Master i Shkencave” njihen nga drejtuesi i Departamentit të Sociologjisë me rregulloren e punimit të diplomës. Studentët ftohen të paraqesin idetë e tyre në formën e një projekti kërkimi ku paraqesin fushën e tyre të interesit për punimin e diplomës.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë i FShS, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, udhëheqjen e mikrotezave si punime diplome për sa i takon programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”.</p> <p>[Evidencat 3.21.; 4.4.; 3.6.1.]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni i angazhon punonjësit e personelit ndihmës mësimor-shkencor për mirëmbajtjen e mjediseve të infrastrukturës së Fakultetit. Për specifikat e fushës së veprimtarisë të Departamentit të Shkencave Sociale, fusha kërkimore e së cilës janë kërkime në terren, kryesisht mjedisi kryesor mbështetes është Biblioteka e FShS . Ajo siguron dhe garanton personelin ndihmës të përshtatshëm për realizimin e kërkimit bibliografik në mjediset e saj. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale aktualisht disponon 2 (dy) salla, aktualisht ka dy punonjëse: Përgjegjëse biblioteke dhe Klasifikatore. Për nga natyra e programit të studimit e rëndësishme është që studentëve t’ju krijohen lehtësira të aksesit në internet, biblioteka fizike dhe virtuale dhe mjedise komode</p>





	me akses wireles në cilindo kat dhe ambjent, sikurse i disponon Fakulteti i Shkencave Sociale, në mënyrë që ata të shfrytëzojnë mundësitë për kërkim dhe shfrytëzim literature. [Evidencat 2.34.; 2.30.]		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përgjegjësi i departamentit të sociologjisë koordinon punën për përmirësimin e rregullores së programit të studimit; për ta përafuar atë me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Ai gjithashtu koordinon veprimtarinë ndërmjet bashkëpunëtorëve për programin; merr pjesë në organizimin e takimeve me palët e interesuara për të kryer studime të tregut të sotëm të punës në lidhje me kompetencat në dalje që duhet të fitojnë studentët dhe sugjerimet e tyre reflektohen kohë pas kohë në përmirësimin e programit të studimit. [Evidencat 3.6.; 3.18.]
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimin të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Nga takimet në institucion me aktorët e përfshirë në realizimin e programit të studimit rezultoi se Departamenti i Sociologjisë kryen takime me studentët dhe perfaqesuesit e Këshillit Studentor të përfshirë në këtë program për të ndjekur nga afër problematikat e shfaqura. Kur ka qënë e nevojshme është diskutuar me pedagogë të caktuar për të përmirësuar çështjet që mund të kenë dalë, ose për përshtatjen e orareve kur studentët kanë qënë të punësuar. Përgjegjësi i Departamentit garanton cilësinë e veprimtarisë së programit, duke angazhuar edhe studentët në veprimtaritë për monitorimin dhe vlerësimin e mësimdhënies, të kurrikulës nga studentët duke reflektuar përmirësimet e programit që vijnë nga sugjerime konstruktive të studentëve. [Evidenca 3.6.; 3.18.; 3.23.]
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Departamenti i Sociologjisë dëshmon se mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Departamenti përdor disa forma komunikimi si përdorimi i mundësive të vendosjes së kontakteve të komunikimit me anën e e-mail-eve, rrjeteve sociale, organizimit të konsultave lidhur me problematikat e punësimit, njohjen e kërkesave të tregut të punës dhe hartimi i programeve kualifikuese me anën e formimit të vazhduar, angazhimi i tyre si subjekte të sondazheve për studimin e tregut të punës etj. Kështu nëpërmjet këtyre adresave studentëve të diplomuar u është shpërndarë pyetësori për studimin e tregut të punës. Gjithashtu Departamenti i Sociologjisë angazhon si asistent/lektorë me kohë të pjesshme edhe studentë ekselente, të diplomuar ne programin “Master i shkencave” ne “Sociologjinë e zhvillimeve shoqërore”, të punësuar me kohë të plotë në institucione të tjera.

	[Evidencat 3.31.; 3.18.]		
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.	<p>Departamenti i Sociologjisë funksionin e bashkëpunimit institucional me institucione homologe kërkimore, publike dhe private, organet dhe njësitë e pushtetit vendor i ka realizuar kryesisht në organizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore si konferenca, seminare, leksione të hapura etj ku trajtohen mjaft probleme të mprehta sociale në bashkëpunim me këto institucione. Gjithashtu këto aktivitete janë realizuar edhe në kuadrin e marrëveshjeve të nënshkruara për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore.</p> <p>Gjatë këtyre aktiviteteve është realizuar edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve në diskutimin për përmirësimin, përshtatjen e programeve të studimit.</p> <p>[Evidencat 3.18.; 3.24.; 4.6.]</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe bisedat me autoritetet drejtuese të njërive konstaton se programi i studimit ka përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesore për formimin e sociologëve të rinj, duke përmbushur edhe prioritetet dhe objektivat institucionale. Programi u jep mundësi studentëve të avancojnë në drejtim të kualifikimeve të tyre në ciklin e tretë të studimit pas përfundimit të këtij programi studimi. Në Strategjinë e zhvillimit të departamentit janë përcaktuar qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor. [Evidencat 1.4.; 2.3.; 3.2.; 3.2.1.; 3.2.2.; 3.6.; 4.6.]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Duke ju referuar informacioneve dokumentare dhe takimeve që zhvilluam në datat 12 dhe 13 shtator vihet re se njësitë; ajo kryesore dhe njësia bazë, administrojnë procesin mësimor si dhe atë kërkimor në funksion të përmbushjes së misionit të Universitetit të Tiranës. Gjithashtu njësia bazë dëshmon se ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit të veprimtarive në mësimdhënie dhe të kërkimit. Në këtë aspekt janë ndërmarrë një sërë nismash që kanë ndikim pozitiv si në zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik por edhe tek studentët e këtij programi studimi. Nga evidencat shihen shembuj të mirë administrimit dhe bashkërendimit të këtyre veprimtarive. [Evidencat 3.18.; 4.6.]




<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program e shprehin qartë synimin për të motivuar dhe nxitur angazhimin e studentëve në projekte dhe veprimtari kërkimore. Këto veprimtari të parashikuara në programin e ciklit të dytë u mundësojnë studentëve të angazhohen në veprimtari që nxisin mendimin kritik dhe refleksionin personal mbi një sërë çështjesh e dukurish shoqërore. Në lëndë të veçanta janë të përfshira edhe detyrat e kursit në të cilat studentët fillojnë të zhvillojnë aftësi në drejtim të punës së pavarur me elemente kërkimi si; kërkimi dokumentar, kërkimi bibliografik apo kërkimi në terren, gjurmimi dhe hulumtimi i fenomeneve sociale duke ndërmarrë kështu punën në fazat e njëpasnjëshme (faza konceptuale, faza metodologjike dhe faza empirike) të kërkimit. Motivimi dhe nxitja e studentëve në këto veprimtari nënkupton edhe punën individuale që bëjnë pedagogët me studentët gjatë përpunimit të një projekti kërkimi. Kjo punë evidentohet veçanërisht gjatë përgatitjes së mikrotezave si punime diplome të udhëhequra nga pedagogët e kualifikuar të departamentit. [Evidencat 3.18.; 4.6.]</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Bazuar në vëzhgimin e dokumentave dhe bisedave me stafin akademik rezultoi një vëmendje e posaçme e stafit akademik të Departamentit të Sociologjisë për tu angazhuar në projekte studimi kombëtare, rajonale dhe ndërkombetare. Problematika e këtyre projekteve, qëllimi dhe pritshmëritë e tyre reflektojnë politikat kërkimore kombëtare dhe rajonale të një shoqërie në zhvillim. Në këtë kuadër, nëpërmjet aktivitetit kërkimor të punimeve shkencore, programi i studimit synon të kontribuojë në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave studimore. [Evidencat 3.18.; 4.6.]</p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në konsultat me administratën e Fakultetit të Shkencave Sociale u pohua se njësia bazë mbështet financiarisht zhvillimin e një konference vjetore, ku pjesëmarrësit, pedagogë, kerkues, doktorantë e studentë, inkurajohen të prezantojnë rezultatet e studimeve të tyre, duke marrë pjesë pa pagesë. Gjithashtu UT mbështet financiarisht periodikisht pjesëmarrjen e stafit në konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe suporton zhvillimin e projekteve kërkimore shkencore në mënyrë periodike nëpërmjet thirrjeve për projekte të financuara nga institucioni. [Evidencat 1.16.; 1.18.; 3.18.; 3.24.]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi II.8 Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë mbështet grupet lëndore dhe aktivitetet ekstra – kurikulare: përmes projekteve kërkimore, konferencave, leksioneve të hapura, etj. Departamenti bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore kombëtare dhe</p>

kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	ndërkombëtare për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Ky bashkëpunim ka një ndikim pozitiv në aspektin e formimit të kompetencave profesionale si dhe të avancimit në procesin e kërkimit shkencor. [Evidencat 3.18.; 4.6.; 3.24.]			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Sociologjisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, ju përgjigjet kërkesave për analiza konstruktive e profesionale të ecurisë së programit të studimit si në aspektin akademik ashtu edhe në aspektin kërkimor. Ai nxit punën e grupeve kërkimore të përbërë nga pedagogë dhe studentë për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të kërkimit. Këto projekte të përfshira në programin e studimit angazhojnë stafin pedagogjik dhe studentët veçanërisht në ato fusha që janë me interes reciprok një pjesë e të cilëve të orientuar tek problemet e mprehta sociale punohen nga studentet e vitit të dytë edhe si mikroteza për mbrojtjen e diplomave. [Evidencat 3.18.; 4.6.; 4.1.1.; 3.24.]			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga informacionet e dokumentuara bashkëlidhur dosjes së akreditimit dëshmohet një veprimtari efikase e përvitshme duke krijuar traditën që çdo vit akademik të organizojë një konferencë me karakter kombëtar ose ndërkombëtar. Përrjashtim bëjnë vitet e kufizimeve për shkak të pandemisë dhe mësimi online, por duke rifilluar këtë veprimtari në maj të vitit 2022. Stafi akademik me kohë të plotë e të pjesshme, studentë dhe profesionistë të fushës janë inkurajuar të marrin pjesë në funksion të arritjes së objektivave të tyre zhvilluese. [Evidencat 3.18.; 4.6.; 3.24.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT.

Standardi III.1 Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Mbështetur në dokumentacionin e dosjes rezulton se institucioni (UT dhe FShS) bazuar te përvoja por edhe te misioni dhe synimet strategjike kanë hartuar një ansambël udhëzimesh të rëndësishme në funksion të performances


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>së mësimdhënies, metodave interaktive që zhvillojnë të menduarit kritik e inovativ e njëkohësisht formimin akademik e profesional në përputhje me aftësitë dhe kompetencat e fushës dhe programit të studimit. Universiteti i Tiranës në çdo nivel të tij, e konsideron mësimdhënien si një element të rëndësishëm të zhvillimit strategjik dhe përmirësimit të cilësisë. Në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies personeli akademik përdor metoda të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies varësisht specifike të lëndëve/moduleve. Në këtë kuader përparësi i është vënë didaktikës së shkencave si mjeti më efikas për transmetimin e njohurive. Përpunimi didaktik i njohurive rrit ndjeshëm kuptimshmërinë e informacionit dhe efektin transmetues tek studentët. Gjithashtu ai ofron vazhdimisht trajnime më në fokus metodat inovative të mësimdhënies varësisht specifike të fushave të studimit.</p> <p>[Evidencat 1.4.; 1.20.; 2.3.; 2.10.; 3.2.; 3.5.]</p> <p>https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Pas njohjes me dokumentacionin dhe vizitave në institucion vlerësimi i aftësiave mësimdhënëse dhe inovative në Universitetin e Tiranës dhe në Fakultetin e Shkencave Sociale realizohet nëpërmjet strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, të cilat ndër të tjera kanë krijuar mekanizmat e nevojshme vlerësuese për ecurinë periodike të programeve të studimit. Në Universitetin e Tiranës funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili koordinon veprimtarinë dhe planin e punës me Njësinë e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë këtij fakulteti zhvillon monitorime dhe vlerësime për aftësitë mësimdhënëse të pedagogëve dhe metodat e mësimdhënies. Në çdo semestër shpërndan pyetësozin e studentëve mbi pedagogun dhe lëndën si dhe harton raporte ku publikohen rezultatet e vlerësimit nga studentët për lëndë dhe pedagogë të programit të studimit. Nga ana tjetër vetë departamenti zhvillon takime periodike me studentët dhe pedagogët e programit për diskutime të përbashkëta rreth cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të saj.</p> <p>[Evidencat 1.2.; 1.14.; 2.14.; 3.18.; 3.23.]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në këtë fakultet, nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizohet përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të efektivitetit të shpalesjes së dijeve. Nëpërmjet një pyetësozi gjysëm të strukturuar me seksione të dedikuara metodave të mësimdhënies tërhiqet opinioni i studentëve për sa i takon performancës mësimdhënëse të çdo pedagogu. Ky pyetësor realizohet çdo semestër dhe në përfundim të mbledhjes së të dhënave bëhet përpunimi i tyre dhe diskutimi i rezultateve me aktorët e përfshirë në vlerësim.</p> <p>[Evidencat 1.14.; 3.23.; 3.18.]</p> <p>Baza rregullatore e UT-së, FSHS-së dhe programit të studimit ju garanton studentëve të drejtën për të njohur gjithë elementët e vlerësimit, vlerësimin e vazhdueshëm si dhe mundësinë e trajtimit të ankimeve mbi vlerësimin.</p> <p>[Evidencat 1.3.; 2.4.; 2.28. 3.6.]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie publikon rezultatet e vlerësimit nëpërmjet raportit të përvitshëm, i cili i vendoset në dispozicion palëve të përfshira në proces si dhe strukturave përgjegjëse në Rektoratin e Universitetit të Tiranës.</p> <p>[Evidencat 1.2.; 2.14.; 2.13.; 2.16.; 3.23; 3, 18.]</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Raportet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë diskutohen dhe analizohen nën një shikim konstruktiv, kritik dhe përmirësues. Gjithashtu vlerësohen edhe praktikave të mira rezultateve të metodave të mësimdhënies me qëllim përhapjen e përvojave pozitive në realizimin cilësor të programit akademik. Bazuar në analizën e rezultateve dhe statistikave evidentohen dhe promovohen shembujt si dhe përpunohen rekomandime për të inkurajuar dhe zhvilluar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe performancës së pedagogëve. [Evidencat 2.14.; 3.23.; 3.18.]</p>		
<p>Slikalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit është i miratuar nga institucioni sipas akteve rregullative të parashikuara në statut dhe rregullore. Në syllabusa janë të përcaktuara format e mësimdhënies, të të nxëniet dhe të transmetimit të dijeve e njohurive. Ndër format thelbësore të përdorura nga stafi akademik i angazhuar në kete program studimi janë: leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale, leksionet e hapura si dhe forma të tjera të larmishme ekstra-kurikulare. Këto forma mbështeten jo vetëm në literaturën e detyrueshme, por edhe në atë mbështetëse. Seminarët organizohen duke përdorur forma të ndryshme interaktive që i japin prioritet aktivizimit të studenteve në diskutime, debate, analiza teksti, interpretime. Në funksion të transmetimit të dijeve e njohurive përdoren edhe mjete didaktike si materiale audio-vizive për tema të caktuara, por edhe esse dhe detyra kursi, të miratura nga institucioni sipas rregullores përkatëse. Në planin mësimor të programit të studimit orët mësimore të këtij programi organizohen në orë mësimi në auditor, orë pune të pavaruara të studentit si dhe orë të planifikuara praktikash profesionale. [Evidencat 4.2.; 4.2.1.; 4.3.]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Nga të dhënat e disponueshme konstatojmë se personeli akademik është i ndërgjegjësuar dhe pranon diversitetin studentor si faktor objektiv dhe kushtëzues për aplikimin e formave, metodave e teknikave didaktike alternative në përputhje me njohjen e veçorive psiko-sociale të studentëve, njohjen e nivelit të tyre. Në përputhje me fushën e programit, të lëndëve të ndryshme mësimore personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe për t'iu përgjigjur nevojave të larmishme të studentëve dhe diversitetit mes tyre, parashikojnë qysh në planifikim të programit të lëndës një sërë teknikash didaktike alternative që fuqizojnë dhe lehtësojnë përcjelljen e njohurive sa më të qarta për studentët, si dhe sigurojnë përfshirjen e studentëve varësisht nevojave dhe ndryshimeve që ata mbartin. Gjatë takimeve në institucion kjo dëshmohej edhe nga vetë studentët.</p>


<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>[Evidenca 4.3.]</p> <p>Institucioni, përfshi këtu njësinë kryesore dhe atë bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, inkurajon dhe mbështet personelin akademik në përdorimin e metodave të shumëllojshme , fleksibel dhe të efektshme pedagogjike që janë rezultative të të nxëniet duke përmbyshur kështu objektivat formuese si dhe egzigjencat e tregut te punës. Gjithashtu, institucioni në mënyrë periodike organizon dhe ofron trajnime për stafin akademik në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike me specialistë të fushave përkatëse.</p> <p>[Trajnime UT; https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnit-dhe-zhvillimit-profesional/]</p> <p>[Trajnime Fakulteti iShkencave Sociale https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim]</p>
	<p>[Evidenca 2.22.]</p> <p>Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe prioritetit ndaj cilësisë së mësimdhënies dhe metodave inovative në mësimdhënie, ka bërë që FSHS ku zhvillohet programi i studimit, të ketë edhe një infrastrukturë mbështetëse informatike dhe teknologjike në shërbim të mësimdhënies duke lehtësuar gjithë procesin e përdorimit të metodave të shumëllojshme dhe fleksibel pedagogjike, paraparë në programet lëndore dhe që mbështesin progresin cilësor. Kushtet cilësore infrastrukture dhe metodat e larmishme pedagogjike optimalizojnë realizimin e rezultateve të pritshme të të mësuarit dhe të përmbyshjes së objektivave.</p> <p>[Evidencat 2.3.; 3.5.; 2.33.]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Në shpërndarjen e personelit akademik sipas planit mësimor Departamenti i Sociologjisë analizon në mënyrë të kujdesshme profilet e studimit dhe të specializimit të personelit akademik, interesat e tyre mësimore-kërkimore duke realizuar në fillim të çdo viti akademik, planifikimin e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik në përputhje me kompetencat akademike, aftësitë dhe përvojën didaktike si dhe shkallën e kualifikimit akademik. Për të garantuar që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve, përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, departamenti merr në konsideratë: përvojën mësimore dhe kërkimore shkencore në fushën përkatëse; publikimet shkencore të realizuara; gradën shkencore./titullin akademik që mban.</p> <p>[Evidencat 1.2.; 2.21.; 4.3.; 4.5.; 4.7.; 4.15.]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në komunikimin që patëm me personelin akademik dhe me studentët u theksua se për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, njësia bazë/ pas marrjes së informacionit nga raportet periodike të cilësisë së mësimdhënies bazuar në pyetësorët e studentëve, realizon takime diskutimi me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit. Duke ju bërë të njohura rezultatet, rekomandimet dhe pikat e dobëta evidentuar nga studentët. Pas këtij diskutimi pedagogët bazuar në nevojat, mendimet e sugjerimet e studentëve vlerësojnë dhe përmirësojnë format dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Në praktikat e punës në departament, përveç monitorimit të institucionalizuar, nxiten edhe format e komunikimit të drejtpërdrejtë pedagog-student, sipas të cilave pedagogu i lëndës ju kërkon studentëve që nëpërmjet një formati të lirë</p>

	dhe anonim të shprehen për pikat e forta dhe pikat e dobëta të lëndës të cilat të bëhen objekt refleksioni përmirësues në vijim. [Evidencat 1.14.; 3.23.; 3.18.]						
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Në natyrën e përditshme të punës mësimore rezultojnë se krahas leksioneve realizohen edhe një ngarkesë optimale me seminare të programuara dhe orientuara për arritjen e objektivit formues. Ky objektivi nënkupton formimin e një mendimi shkencor të pavarur të aftë për refleksion kritik dhe ndërtimin e një mendimi të ri autentik e krijues. Për këtë arsye personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi për transmetimin e dijeve të organizuara dhe kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve (nëpërmjet rasteve të studimit apo detyrave të kursit, eseve të shumta në varësi të temave të programit të lëndës, analize teksti, etj.), në mënyrë që, orët e mësimit të bëhen sa më tërheqëse. [Evidenca 4.3.]						
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre	Tek programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” dëshmohej se orët e leksionit janë të drejtuara nga pedagogu. Leksionet janë përpunuara në aspektin didaktik në funksion të nivelit të studentëve në kuptimshmëri dhe transmetueshmëri për të lehtësuar përvetësimin e koncepteve të reja, ideve apo teorive, duke nxitur mendimin me në qëndër studentin. Orët e seminareve inkurajojnë, diskutimin e lirë, autonominë e studentit për të hulumtuar dhe studiuar me refleksion literaturën e rekomanduar ose alternative mbi një punë të pavarur jashtë auditorit, në funksion të përgatitjes paraprake për diskutim përgjatë orëve të seminarit. Nga vizita në institucion dhe biseda me studentë e pedagogë, ne konstatuam, se marrëdhëniet pedagog–studentë, janë korekte dhe karakterizohen nga një frymë bashkëpunimi e mirëkuptimi. Personeli akademik realizon edhe konsultime, për të ndihmuar studentët. [Evidencat 4.3.; 3.25.]						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Pas vizitës në institucion, konstatohet se programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe në përputhje me VENDIMIN Nr. 418, datë 10.5.2017 për “Standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”. Referuar këtij vendimi, në shkencat sociale sipërfaqja duhet të jetë 2.5 m ² /student, ndërkohë që ky raport në Fakultetin e Shkencave Sociale është 2.6 m ² /student. Fakulteti i Shkencave Sociale, ka një sipërfaqe 4,500 m ² , ka 6 salla






	<p>leksionesh dhe 16 salla seminaresh, dhe ka një kapacitet për 759 vendesh për seminarët dhe 747 vende për 6 sallat e leksionit, të shfrytëzueshme në dy turne mësimore gjë që sjell dyfishimin e kapaciteteve. Këto mjedise dallohen për nga ndriçimi i bollshëm natyror, sistemi i ftohjes dhe ngrohjes qendrore. Pastërtia dhe mirëmbajtja është e rregullt.</p> <p>[Evidenca 2.33]</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Infrastruktura e ofruar nga institucioni përsa i përket logjistikës siguron në çdo sallë forma të larmishme të informatikës dhe teknologjisë së informacionit si wi-fi, laptop, videoprojektor, monitor, etj, të cilat vihen në shërbim të mbarëvajtjes së procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p>[Evidencat 2.30.; 2.33]</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Në mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale për personelin akademik efektiv të Departamentit të Sociologjisë janë në dispozicion 4 zyra, një prej të cilave është zyra e përgjegjës të Departamentit. Të gjitha zyrat në dispozicion të personelit akademik ofrojnë poste pune të pajisura me mjetet e nevojshme informatike si printera, fotokopje, scanera, kompjutera/laptopë, akses internet kabllor dhe wi-fi duke siguruar bazë infrastrukturorë për punën e personelit akademik në funksion të procesit mësimor. [Evidenca 2.33.]. Studentët e programit të studimit kanë akses wi-fi të pakufizuar në cilindo kat të fakultetit dhe mund të përdorin lehtësisht laptopët e tyre në funksion të detyrave mësimore, gjithashtu mund të shfrytëzojnë sallën e kompjuterave të pajisur me internet dhe programe ndihmëse në funksion të kërkimit në Bibliotekën e Fakultetit. Komunikimi mes stafit pedagogjik dhe administrativ zhvillohet nëpërmjet domain-in zyrtar të Universitetit të Tiranës emër.mbiemer@unitir.edu.al. Institucioni ka një zyrë të dedikuar të IT për asistencë sipas veçorive të aktivitetëve në funksion të procesit mësimor.</p> <p>[Evidenca 2.5.; 2.30.; 2.30.1.].</p> <p>Institucioni me propozim të njësisë bazë harton buxhetin në mënyrë të vazhdueshme. Ai parashikon fonde për përmirësimin e infrastrukturës informatike në mbështetje të procesit mësimor. Pajisjet në dispozicion kompjuterike, audio, vizuale, didaktike etj, janë konform standardeve të Bashkimit Evropian dhe rregullave të konformitetit të produkteve sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Këto pajisje plotësojnë funksionin e tyre në kuadër të mirëfunksionimit të programit.</p> <p>[Evidenca 3.26.]</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Pedagogët e angazhuar në realizimin e këtij programi të studimit kanë përcaktuar saktësisht literaturën e detyrueshme si dhe atë ndihmëse. Ata priren të përdorin burime fizike ose elektronike, të cilat gjenden në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe pothuajse në çdo rast pedagogu i lëndës ofron edhe ekstrate të leksioneve në formë elektronik ose hard-copy. Biblioteka e Fakultetit ka 3.750 tituj. Institucioni ju siguron studentëve, pa pagesë, akses në bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE, WILEY, etj. për t'u ardhur në ndihmë në punën e tyre kërkimore dhe për të aksesuar informacionin e duhur për marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Gjithashtu në kompjuterat e bibliotekës studentët mund të aksesojnë edhe libra të ndryshëm sociologjikë në formatin PDF, të instaluar në kompjuterat e bibliotekës, si literaturë ndihmëse për studentët.</p>




	<p>Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave, botimet .e. konferencave, etj. Biblioteka pasurohet në mënyrë të vazhdueshme duke depozituar edhe revistat shkencore që botohen në Fakultetin e Shkencave Sociale “Politikja” dhe “Puna Sociale dhe Politika Sociale” apo edhe revista “Lente Sociologjike” pajisur me numra ISSN dhe nëpërmjet depozitimit sipas kalendarit të aktiviteteve të materialeve të konferencave si “abstract book” ose “proceeding book” pajisur me numrin unik ISBN.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë në mënyrë periodike buxheton dhe propozon në strukturat e FSHS tituj për shtimin e zërave të Bibliotekës në mbështetje të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 3.30.; 2.30.1.; 2.31.; 2.32.; 3.27.]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale funksionon mbi bazën e një rregulloreje të brendshme, e cila vendos rregullat normative të subjekteve të ndryshme që e frekuentojnë atë. Ajo gjithashtu rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të bibliotekës. Pasurimi i literaturës në përputhje me kurrikulat mësimore është proces i vazhdueshëm, që kryhet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, dhurimeve, artikujve shkencore, tezave të diplomave, botimet e konferencave, etj. Biblioteka pasurohet në mënyrë të vazhdueshme duke depozituar edhe revistat shkencore që botohen në Fakultetin e Shkencave Sociale “Politikja” dhe “Puna Sociale dhe Politika Sociale” apo edhe revista “Lente Sociologjike” pajisur me numra ISSN dhe nëpërmjet depozitimit sipas kalendarit të aktiviteteve të materialeve të konferencave si “abstract book” ose “proceeding book” pajisur me numrin unik ISBN.</p> <p>Departamenti i Sociologjisë në mënyrë periodike buxheton dhe propozon në strukturat e FSHS tituj për shtimin e zërave të Bibliotekës në mbështetje të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale aktualisht disponon disa mjedise si: salla e multimedias, sallë leximi, për studentet, fondi i hapur i librave, si dhe zyrë të përpunimit të koleksioneve dhe fondin e mbyllur.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale, aktualisht ka dy punonjëse: një përgjegjëse bibliotekë dhe një Klasifikatore.</p> <p>Referuar raportit të fundit të realizuar të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, për vitin akademik 2017-2018 biblioteka ka një volum prej rreth 3.750 titujsh dhe 70 poste pune/leximi/kërkimi, të cilët në 5 vitet e fundit janë pasuruar vit pas viti me një listë prej 869 tekstesh. [Evidencat 2.34.1.; 2.30.]</p> <p>Në bibliotekën e fakultetit, disponohet literatura bazë dhe ndihmëse e mjaftueshme në sasi, në raport me numrin e përdoruesve. Gjithashtu, gjenden në bibliotekë tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse për studentët, përkthime të ndryshme, fjalorë, CD- ROM. Vetëm nëpërmjet aksesit në bibliotekën digjitale JSTOR ofrohen më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina.</p> <p>[Evidenca 2.30.1.]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave</p>	<p>Në Fakultetin e Shkencave Sociale funksionojnë edhe bibliotekat online të Sage, Springer, JSTOR, U-library, Wiley të cilat përdoren nga studentët dhe personeli akademik në funksion të mësimdhënies dhe të mësuarit, jo vetëm për akses në literaturë të disiplinës sociologjike, por edhe në fusha të ngjashme</p>

<p>të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>ose të përafërta për lëndët ndërdisiplinare të formimit të përgjithshëm si psikologjia, ekonomia, historia, etnologjia, antropologjia që lidhen me programin e studimit. [Evidencat 2.30.; 2.30.1.]</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale për nga natyra dhe specifika e programeve nuk ka laboratorë të mirëfilltë, por në përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të programit biblioteka e institucionit dhe akseset e siguruara në platformat online sigurojnë fondin dhe informacionin e nevojshëm për të realizuar kërkime dhe studime në burime dytësore mbi detyrat e kursit, essetë si dhe diplomat. [Evidencat 2.30.; 2.30.1.; 3.21.; 3.25.]</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Puna me sistemet e-learning për programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” mund të konsiderohet në dy faza: para dhe pas pandemisë së Covid-19. Në praktikën e punës para-pandemisë së COVID-19 institucioni ka mbështetur komunikimin në sisteme të e-learning në funksion të aksesit në materiale, të komunikimit ndërmjet studentëve dhe pedagogëve, por jo për zhvillimin e mësimin në format virtual. Pandemia e COVID-19 nxiti dhe zhvilloi politika institucionale në funksion të platformave e-learning, të cilat për rreth 18 muaj zëvendësuan klasat me prezencë fizike dhe transformuan gjithë modalitetet e ndërveprimit dhe mësimdhënies në formatin on-line nëpërmjet sistemit të e-learning, për intervalin kohor mars-qershor 2020 google classroom dhe takime në kohë reale në zoom. Për vitin akademik 2020-2021 e në vijim Universiteti i Tiranës ka garantuar akses të vazhdueshëm dhe funksionim optimal të platformës e-learning Microsoft teams. Institucioni ka trajnuar studentët dhe stafin në përdorimin e tyre si dhe ka hartuar manuale specifike për të lehtësuar përdorimin në funksion të mësimdhënies si gjatë edhe pas pandemisë. [udhëzues për provimet online- https://fshs-ut.edu.al/?p=6463] [Njoftim për logiminin në platformë: https://fshs-ut.edu.al/?p=6035] [Trajnime në FSHS për përdorimin e platformës Teams dhe paketës Office 365: https://fshs-ut.edu.al/?p=5975] [Evidencat 1.15.; 1.17.]</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vëzhgimit tonë në mjediset e fakultetit konstatoam se personeli akademik dhe studentët janë të pajisur me adresa elektronike zyrtare të hartuara për pedagogun sipas modelit emer_mbiemer@unitir.edu.al dhe për studentin sipas modelit emer_mbiemer.fshsstudent@unitir.edu.al. Në këtë mënyrë mundësohet komunikimi i brendshëm dhe në rrjet duke shfrytëzuar dhe të gjitha opsionet e komunikimit në rrjet të paketës office365 nëpërmjet one drive dhe teams. Nëpërmjet këtyre formave të komunikimit garantohet në mënyrë të thjeshtë dhe ekologjike komunikimi i brendshëm dhe aksesin në dokumentacionin elektronik në grupe studentësh. [Njoftim për logiminin në platformë: https://fshs-ut.edu.al/?p=6035] [Trajnime në FSHS për përdorimin e platformës Teams dhe paketës Office 365: https://fshs-ut.edu.al/?p=5975]</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Sociologjisë mbështet dhe orienton studentët që kanë arritur rezultate të larta, në përfundim të detyrimeve përmblyëse të programit të studimit të ciklit të dytë të zgjedhin e të realizojnë një punim kërkimor në funksion të diplomës. Mbështetur në Rregulloren e</p>





	programit të studimit dhe Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë të studimeve, personeli akademik i orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave duke organizuar takime periodike me ta. Për çdo student departamenti cakton një pedagog udhëheqës, detyrat dhe të drejtat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren për diplomat e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” [Evidencat 3.6. ; 3.6.1.]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X



Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe praktikave të punës u konstatua se Universiteti i Tiranës ka organizuar disa Drejtori në nivel institucioni si: Drejtorja e kurrikulave dhe sigurimi i cilësisë, Drejtorja e teknologjisë, inovacionit dhe statistikave, Drejtorja e kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë. Këto funksionojnë si struktura që kordinojnë, mbështesin dhe promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies duke bashkërenduar aktivitetet me njësitë kryesore/bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. [Evidencat 1.2. dhe Struktura organizative e Rektoratit të Universitetit të Tiranës: https://unitir.edu.al/struktura-organizative/].</p> <p>Senati Akademik ka ngritur komisionet e përhershme në nivel institucional dhe ndër to janë: Komisioni i sigurimit të standardeve të cilësisë si dhe Komisioni i kurrikulave, të cilët në veprimtarinë e tyre kanë për fokus sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit si dhe vlerësimin e projektprogrameve të paraqitura nga njësitë kryesore apo njësitë bazë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Sociale ka ngritur Njësinë e sigurimit të cilësisë që monitoron dhe promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, dhe që kordinon veprimtarinë e saj me Komisionin e sigurimit të standardeve të cilësisë. [Evidencat 1.2.; 2.12.; 2.14.]</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	<p>Fakulteti i Shkencave Sociale si njësi kryesore dhe Departamenti i Sociologjisë si njësi bazë për ofrimin dhe zhvillimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” përcaktojnë si qëllim arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahjen e aspiratave dhe arritjeve të cilitdo që kërkon të përfitojë dije sociologjike.</p> <p>Për procesin e mësimdhënies dhe ndikimin e saj në rezultatet e të mësuarit njësia bazë e Sociologjisë në objektivat strategjike të zhvillimit të programit i njuh vetes përgjegjësinë dhe detyrimin për të ofruar një mësimdhënie cilësore si premisë bazë për suksesin në të nxënë. Nëpërmjet mësimdhënies dhe</p>




	<p>metodave të përdorura në këtë program synohet të nxitet mendimi kritik dhe krijues si mjet për arritjen e këtij qëllimi. Kjo ndikon në formimin e studenteve si qytetarë aktivë në një shoqëri demokratike. Duke vlerësuar rëndësinë e mësimdhënies në ofertën akademike të studimit, në këtë program, njësia bazë ka përcaktuar objektiva të posaçëm në funksion të mësimdhënies dhe standarteve të cilësisë.</p> <p>[Evidencat 3.2.; 3.5.; 3.22.]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Nga studimi i dokumentacionit të dosjes së këtij programi studimi konstatuam se Departamenti i Sociologjisë vlerëson dhe mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Për këtë qëllim ai ka organizuar aktivitete kërkimore ose trajnuese/ si:</p> <p>Seminaret:</p> <p>Kanvasi i Arsimit për sipërmarrjen; Dizenjimi i Arsimit që aktivizon mendësinë sipërmarrëse të studentëve,</p> <p>-Leksione të hapura trajnuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si “Eu for innovation dhe Preneurz.Amsterdam, me objektiv nxitjen e edukimit të sipërmarrjes dhe mësimin sipërmarrës https://unitir.edu.al/seminar-online-date-08-11-2021-ora-1500-organizuar-nga-eu-for-innovation-preneurz-amsterdam-team/;</p> <p>- making degree programs more relevant and more learner centred, in the light of Eu/EHEA objectives and trends” https://unitir.edu.al/universiteti-i-tiranës-nën-kujdesin-e-rektorit-prof-dr-artan-hoxha-fton-stafin-akademik-të-ut-se-të-marrë-pjesë-në-seminarin-online-me-temë-making-degree-programs-more-relevant-and-more/; etj.</p> <p>-programe të shkëmbimit në kuadrin e marrëveshjeve Erasmus+ e tje.</p> <p>[Seminare të ofruara në rang Institucioni: https://unitir.edu.al/?s=seminar]</p> <p>[Trajnime në kuadër të programeve Erasmus+ https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai mbështetës të Departamentit të Sociologjisë kanë si përparësi profesionale kualifikimin e vazhdueshëm akademik përmes kërkimit. Kërkimi shkencor është pjesë e rëndësishme e strategjisë së zhvillimit të këtij departamenti. Nëpërmjet tij synohet zhvillimi dinamik i karrierës akademike të profesoratit efektiv. Kontributet dhe arritjet e profesoratit në fushat e tyre të ekspertizës janë me interes edhe për kurse të ndryshme të studimit në këtë program. Personeli akademik efektiv në mënyrë të vazhdueshme angazhohet në forma të ndryshme të veprimtarive kërkimore-shkencore, të cilat ndihmojnë kualifikimin e tyre në kërkimin shkencor dhe përmirësimin e tyre, zgjerojnë njohuritë dhe dijet të cilat i aplikojnë edhe në procesin e mësimdhënies.</p> <p>[Evidencat 3.2.; 3.2.1.; 3.2.2.; 3.5.; 4.6.; 4.11.]</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse rezultojnë se trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj. Organizime të natyrës trajnuese apo shkencore janë në përputhje me realizimin e objektivave strategjike të sigurimit të cilësisë si dhe të mësimdhënies.</p> <p>[Evidenca 1.20.] [Seminare të ofruara në rang Institucioni: https://unitir.edu.al/?s=seminar]</p> <p>[Trajnime në kuadër të programeve Erasmus+ https://fshs-ut.edu.al/?s=trajnim]</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë</p>	<p>Gjithashtu, personeli akademik efektiv si dhe ai ndihmës akademik janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në programet e trajnimit</p>






<p>përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik ai ndihmës akademik është i angazhuar në implementimin e metodave të reja duke frekuentuar takimet dhe workshop-et e organizuara nga Institucioni, nga njësia kryesore dhe nga departamenti i sociologjisë. Gjithashtu personeli akademik zhvillon ekspertizën trajnuese dhe mësimdhënëse edhe me aktorë të tjerë jashtë IAL-së duke përmirësuar metodat dhe teknikat e mesimdhënies. [Evidencat 4.6.; 4.15.] [https://w.facebook.com/departamentiisociologjiseUT.]</p>						
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në përvojën e punës të këtij departamenti i kushtohet vëmendje dhe kujdes analizave për të shqyrtuar efektivitetin e aplikimit të metodave të reja në mësimdhënie mbi bazën e testimit të tyre nga aktorët që marrin pjesë në këtë proces. Sondazhet me studentet e diplomuar dhe ata që janë në proces reflektojnë mjaft në testimin e teknikave inovative të mësimdhënies. Personeli akademik i teston këto metoda në mësimdhënie, në raport me realizimin e objektivave formuese të programit të studimit, efektet e të cilave raportohen në mënyrë periodike në analizat e njësisë bazë, si dhe përcillen edhe në struktura të tjera të institucionit. [Evidencat 1.16.; 1.18.; 3.18.]</p>						
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni mbështetur tek bashkëpunimi me partneret që marrin pjesë në realizimin e programit akademik si: lektorë të ftuar, profesionistë të fushës, apo kërkues shkencorë, vendas dhe të huaj, sjellin ide e përvoja bashkëkohore, në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Nga dokumentimi i veprimtarisë kërkimore në nivel programi vihet re, ndër të tjera, një numer lektorësh të huaj (15 të huaj), të cilët janë përfshirë në trajnime, leksione, seminare ose referime dhe diskutime me studentë dhe pedagogë të programit të studimit. [Evidenca 3.24.; 4.6.] [Dokumentim i aktivitetit të Departamentit ndër vite https://w.facebook.com/departamentiisociologjiseUT.]</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1120 727 1196">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="727 1120 959 1196">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="959 1120 1182 1196">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1196 727 1270"></td> <td data-bbox="727 1196 959 1270"></td> <td data-bbox="959 1196 1182 1270" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Vlerësimi i studentit është pasqyruar në rregulloret e brendëshme të Universitetit të Tiranës si dhe në ato të Fakultetit të Shkencave Sociale. Po kështu format e kontrollit dhe kriteret e vlerësimit detajohen në cdo syllabus të lëndës, kjo e miratuar në Departamentin e Sociologjisë. Në kuadrin e vlerësimit ai është trajtuar në kompleksitetin e tij. Nga dokumentacioni rregullator konstatohen aspektet përbërës të një testimi e vlerësimi të studentit ku përfshihen zotërimi i njohurive akademike dhe dijeve të përfshira në programin e lëndës, aftësitë profesionale të integruara me programin e lëndës, veçanërisht me realizimin e detyrave të kursit, pjesëmarrjen aktive në seminare dhe projektet e kërkimit. Në këto rregullore janë parashikuar elementët e procesit të vlerësimit si: detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</p>



	Mënyra e vlerësimit jepet e detajuar në syllabuset e lëndëve në këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre. Ato janë të disponueshme dhe të publikuara dhe studentët mund t'i aksesojnë në çdo moment. [Evidencat 1.3.; 2.4.; 3.3.; 3.6.; 4.3.]						
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Njohja e studentëve që në fillim nga ana e pedagogut titullar me modalitetet dhe metodologjinë e vlerësimit të korpusit të dijeve e njohurive akademike si dhe aftësive profesionale dhe shkencore parashikohet si detyrim në Statutin e UT si dhe rregulloret e brendëshme. Kështu, përcaktohet qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli, lënde me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit. Studentët gjatë takimeve pohuan se njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës si dhe prezantimit të syllabusit përkatës lëndor, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, aftësitë profesionale e shkencore si dhe metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive. [Evidencat 3.6.; 4.3.]						
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të fituara nga studentët, rezulton të realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, esse, etj, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Testimi e vlerësimi rezulton se bëhet në përputhje me rregullat për provimet parashkruar në rregulloren e UT, rregulloren e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe në rregulloren e programit të studimit. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese, kuptim dhe zbërthim konceptesh, raste studimore, analiza teksti në përputhje me profilin e lëndës dhe në mënyrë të tillë që ti japë mundësi çdo studenti të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. [Evidencat 1.3., nenet 45-49; 2.4.; 3.3.; 3.6.; 4.3.]						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.6



Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	GVJ konstaton se njohuritë, dijet dhe aftësitë profesionale të studentëve maten në mënyrë të vazhdueshme dhe gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës. Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në përgatitjen sistematike dhe produktive në seancat e seminareve të cilat programohen të shtrira në kohën e zhvillimit të lëndës. Po kështu studenti vlerësohet për aftësitë në detyrat e kursit si punë e pavarur për studentin ose projektet e kërkimit që kanë shtrirje semestrale apo vjetore. Vlerësimi i njohurive dhe dijeve akademike realizohet me provime të ndërmjetme (kolokiume) si dhe me provimin përfundimtar. Të gjitha këto elemente vlerësimi të shprehura në pikë janë komponentë të vlerësimit përfundimtar. Pikët e grumbulluara sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, vlerësimit në provime, sipas syllabusit të lëndës, të

	<p>shprehura në %, të mbledhura dhe të shprehura në notë përbejnë edhe rezultatën e vlerësimit të studentit.</p> <p>Ky sistem i integruar i vlerësimit të njohurive e aftësive gjatë zhvillimit të semestrit, i nxit dhe i motivon studentët të mbështeten në një punë sistematike e të pavarur për të qenë rezultativë.</p> <p>Këto forma të vlerësimit u japin mundësi studentëve përfitimin e njohurive të plota deri në përfundimin e semestrit, si dhe vlerësimin e kohë pas kohshëm të dijeve nga pedagogu, si mundësi për të identifikuar edhe pikat e forta dhe pikat e dobëta, të cilat duket se trajtohen në proces sipas bisedave me studentë dhe pedagogë. Testimi përfundimtar ka një peshë të caktuar të vlerësimit që shprehet qartë në syllabusin e lëndës dhe vlerësimi përfundimtar është një shumatore e gjithë komponentëve të vlerësimit.</p> <p>[Evidencat 4.3.; 3.12.]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Kemi mendimin se UT në bashkëpunim me AADF ka vënë në dispozicion sistemin clean score të korigjimit të provimeve nëpërmjet sistemeve informatike të teknologjisë, i cili mund të përdoret varësisht specifikave të fushave të studimit si dhe kërkesave të pedagogëve. Gjithashtu, përgjatë periudhës së spostimit të procesit mësimor në platformën e-learning office 365, në varësi të pyetjeve të tezës së provimit, sistemi në mënyrë automatike gjeneron korigjimin për pyetjet e mbyllura. Nëpërmjet këtyre sistemeve ruhet konfidencialiteti, rritet shpejtësia e kontrollit të provimeve të ndërmjetme dhe atij përfundimtar.</p> <p>[Evidencat 1.10.1.; 15. 1.17.]</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi përfundimtar i njohurive zhvillohet konform rregulloreve të Institucionit. Vlerësimi përfundimtar i njohurive, aftësive dhe kompetencave të lëndës realizohet nga komisionet e provimeve jo më pak se dy pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës. Komisionet dhe datat e provimit bëhen publike dhe gjenden edhe në faqen e Fakultetit të Shkencave Sociale.</p> <p>Komisionet e provimeve janë të ngritura nga departamenti dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit/, sipas cikleve të studimit, siç parashikohet në rregulloren e këtij fakulteti dhe që shprehet edhe në rregulloren e programin të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”.</p> <p>[Evidencat 2.4.; 3.6.; 3.28.]</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët e Departamentit të Sociologjisë dhe studentët e programit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” u theksua se kontrolli i testeve dhe provimeve zhvillohet në mënyrë konfidenciale, sipas rregullave të parashikuara për provimet dhe në cilësimet e kodit të etikës. Vlerësimi i njohurive bëhet duke ruajtur sekretin dhe korigjimi bëhet në mënyrë anonime. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe testet sekretohen nga sekretaria dhe kontrollohen nga pedagogu në mënyrë anonime, hapja e tezave bëhet në prezencë të komisionit të provimit dhe sekretarisë.</p> <p>[Evidencat 1.3.; 2.4.]</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet me shënime korigjuese me qëllim që studenti të ketë mundësi të reflektojë dhe të përmiresohet. Nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë</p>

për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	seminareve, nivelit të përgatitjes dhe prezantimeve të detyrave të kursit, duke iu dhënë orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. [Evidencat 3.3.; 3.6.]
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Referuar rregulloreve si dhe kodit etik rezultojnë se institucioni ka përcaktuar rregulla të qarta ndëshkuese gjatë procesit të vlerësimit në të gjithë komponentet e tij. Kështu është e ndaluar plagjiatura në punimet e detyrave të kursit, projekteve të kërkimit dhe veçanërisht mikrotezës që përgatitet për fitimin e diplomës. Po kështu edhe kopimi në provime është i ndëshkueshëm. Departamenti dhe fakulteti kanë marrë masa për të garantuar objektivitetin dhe përjashtuar kopimin në provime. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesi i departamentit orientojnë tematika kryesisht aplikative ku të dhënat që përdoren të jenë autentike dhe të inspirohet qasja kritike në fazat përkatëse të një pune kërkimi me qëllim që studenti të përdorë njohuritë, aftësitë, kompetencat që ai zotëron. [Evidencat 1.5.; 3.3.; 3.6.; 3.6.1.; 4.3.]
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi dhe rezultatet e tij, të parashikuara në aktet rregulluese, theksohet qartësisht se duhet të jenë korrekte, objektive dhe të mbështetura mbi meritën dhe punën e studentit. Rezultatet e kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit ju bëhen të njohura studentëve nga pedagogu i lëndës detyrë pas detyre, në përfundim të periudhës semestrale dhe në përfundim të korrigjimit të provimeve brenda afatit kohor të përcaktuar në rregullore. Për provimet me gojë rezultatet komunikohen direkt në mbyllje të provimit. Në rastet kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni bën transparent çelësin e zgjidhjes për studentin. Teza korrigjohet brenda 10 ditëve. [Evidencat 1.3.; 2.4.]
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në rregulloren e Universitetit, rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, është përcaktuar se studenti ka të drejtën të bëjë kërkesë dhe ankesë për rivlerësim kur ai mendon se vlerësimi për të nuk është i drejtë dhe objektiv të dijeve dhe të aftësive të tij për gjatë gjithë viteve të studimit. Institucioni i garanton studentit të drejtën për t'u njohur me vlerësimin dhe elementët e vlerësimit për çdo lëndë nëpërmjet syllabusit të lëndës që në orën e parë të mësimin. [Evidenca 1.3.; 2.4.; 3.6.]
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Bazuar në takimet në institucion, shpjegimet e studentëve dhe dokumentacionin në shqyrtim konstatohet se: studentit ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Rregulloret parashikojnë procedura rishikimi dhe rivlerësimi. Studenti paraqet me shkrim ankesë me pretendimet përkatëse drejtuar përgjegjësit të departamentit ose sekretarisë së departamentit, brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit, pasi bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Procedura e ankimit protokollohet dhe arkivohet dhe rezultati final vendoset në regjistrin e notave. [Evidencat 1.3.; 2.4.; 2.9.; 3.6.]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është i organizuar në mënyrë lineare, dhe koherente për të garantuar thellimin e njohurive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Plani mësimor i këtij programi ka 18 lëndë, përfshirë praktikën profesionale dhe provimin e formimit (diplomën) ku studenti thellon njohuritë e marra gjatë zhvillimit të lëndëve dhe zhvillon aftësitë profesionale praktike. Kjo garantohej nga harmonizimi i lëndëve mësimore të përcaktuara në kurrikul. [Evidencat 4.2.1.; 4.2.2.]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Nga shqyrtimi i planit mësimor, përmbajtjes së lëndëve si dhe vizitave në institucion rezulton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit (programit teknik statistikor SPSS), dhe programeve informatike të përpunimit të të dhënave sociologjike. Aftësi të veçanta fitohen edhe në aspektet e: mendimit kritik, të etikës, por edhe të aspekteve praktike të studimeve sociologjike, komunikimit dhe ndërveprimit. Programi në mënyrë të vazhdueshme ju është nënshtruar ndryshimeve të përmirësimit dhe përshtatjes ndaj nevojave lokale/kombëtare të atyre rajonale, e më gjerë. [Evidencat 4.2.1.; 4.2.3.; 4.3.]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Syllabuset e lëndës ose modulit paraqesin kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Ato përmbajnë objektivat, veprimtaritë formuese, kreditet, dhe orët përkatëse. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen në fund nëpërmjet diskutimeve përmblyëse dhe në përfundim të lëndëve u jepen rekomandime për përmirësime nëse shihet e arsyeshme. [Evidencat 4.1.; 4.3]
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në bisedat me studentët u theksua se në përfundim të çdo lënde apo moduli ata orientohen nga pedagogët për të përqendruar vëmendjen tek çështjet më të rëndësishme të lëndës si dhe para provimit jepen orientime edhe për pyetjet që do të ketë provimi final. Njëkohësisht risillet në vëmendje pesha që do të ketë në notën finale të modulit apo provimi final. Në përfundim të çdo lënde personeli akademik përmbledhtasi vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre, gjithashtu në funksion të transparencës me studentin ju komunikon studentëve rezultatet e vlerësimit të vazhduar. [Evidenca 4.3.]
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të	Departamenti i Sociologjisë planifikon për pedagogët efektive, krahas programit, edhe orë të hapura ose seminare, për të sjellë informacionet e fundit


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al





43





<p>hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>shkencore në atë fushë që përfshin programi i lëndës. Në këto aktivitete integrohen të rejat e fundit të shkencës dhe teknologjisë që u jepen studentëve përtej orarit normal. Në këtë kontekst departamenti dhe fakulteti vazhdimisht organizojnë leksione dhe seminare të hapura; pohuar kjo, nga studentët dhe pedagogët gjatë takimeve si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion. Aktivitete të tilla prezantohen edhe në faqen e departamentit dhe të fakultetit. [Evidenca 3.24.; 4.6.]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Bazuar tek vizita në institucion konstatuam se Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Sociologjisë ofrojnë ndaj studentëve të gjithë infrastrukturën e nevojshme për t'u mundësuar atyre zhvillimin e praktikave mësimore. Stafi akademik i kualifikuar dhe me përvojë angazhon edhe studentë që të bashkëpunojnë për aktivitete ekstra kurrikulare në institucione dhe organizma jashtë universitetit me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi. [Evidencat 3.21.; 3.24.; 4.1.]</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Pas njohjes me programet e lëndëve dhe bisedave me studentë e pedagogë konstatuam se puna në grup është një element i rëndësishëm i i procesit mësimor. Studentët gjatë orëve të seminarit apo detyrave të kursit organizohen në grupe pune të punojnë së bashku në zgjidhjen e çështjeve të caktuara të përfshira në program. Ata inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave ose studimeve të rastit që ju propozohen nga pedagogë orë pas ore në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të dijeve si dhe në funksion të vlerësimit të tyre. Kjo punë realizohet në drejtimin e pedagogut udhëheqës apo titullarit të lëndës, i cili i motivon dhe i inkurajon studentët për dhënie mendimi duke përdorur me efikasitet metodat e mësimdhënies. [Evidenca 4.3.]</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet.</p>	<p>Aktiviteti dhe veprimtaria e gjërë dhe e larmishme akademike dhe kërkimore dëshmon se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve të reja inovative, studime të avancuara kërkimore shkencore dhe mbështet këto marrëdhënie. Ai përdor metoda interaktive dhe diskutime për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës së pavarur të tyre në mënyrë që orët e mësimit të bëhen sa më tërheqëse. Për këtë qëllim renditen mjaft forma efikase si: konferencat shkencore, botimet e përbashkëta në revistën shkencore të departamentit, angazhimi i studentëve në sondazhe, intervista e analiza sociologjike si studiues të rinj, pjesëmarrja e studentëve të këtij programi në mbledhjen e të dhënave për realizimin e studimit RAFT-IMK, angazhimi i studentëve në OJQ si "Terre des Hommes" Shqipëri, "Terre des Hommes" Hungari dhe Fondacionin "Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi i mosmarrëveshjeve", pjesëmarrja e studentëve në konkurse të punëve kërkimore, aktivitete të ndryshme si ai i ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut etj. Nxitja dhe krijimi i një klime të favorshme për pjesëmarrje të studentëve në veprimtari kërkimore -shkencore e aktivitete të tjera kanë gjeneruar ide të reja inovative tek studentët. [Evidenca 4.6.] http://ë.arkivalajmeve.com/Si-mund-të-hysh-në-Republikën-e-Spacit.1047919971/ https://fshs-ut.edu.al/?s=departamenti+i+sociologjisë https://ë.facebook.com/departamentiisociologjisëUT</p>

<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni dhe Departamenti i Sociologjisë vlerësojnë aktivitetet për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore në bashkëpunim me studentët. Në mjaft raste stafi akademik nxit studentët të publikojnë artikuj studimorë në bashkëpunim me pedagogë si dhe të referojnë në veprimtari kërkimore shkencore, apo në aktivitete të tjera ku prezantohen (bashkë me studentët) rezultatet e kërkimeve. Në kuadër të marrëveshjeve të programeve Erasmus + ofrohen një sërë oportunitetesh për mobilitete të financuara për studentët.</p> <p>Me gjithë vështirësitë financiare institucioni mbështet studentët dhe strukturat e tyre organizative për aktivitetet që synojnë implementimin e ideve inovatore.</p> <p>[Evidenca 2.27.; 4.6.; 3.20.]</p>		
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera përmirësojnë mundësitë për ndërthurje formash mësimdhënëse nëpërmjet ofrimit të ekspertizës praktike nga specialistë dhe ekspertë të institucioneve bashkëpunuese. Departamenti dhe personeli akademik i programit të studimit, kanë një përvojë pozitive në marrëdhëniet e partneritetit dhe krijojnë kushte për integrimin institucional. Gjithashtu është krijuar një komunikim që i siguron mundësi për të realizuar praktikat mësimore për studentët në të gjitha fushat e interesit.</p> <p>Institucioni dhe Departamenti tregojnë interes për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve me institucione të tjera vendase dhe të huaja që operojnë në fushën e arsimit të lartë. Megjithatë nga takimi me departamentin u theksua nevoja e rritjes më tepër të angazhimit institucional në projektet ndërkombëtare që favorizojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe mobilitetin e tyre në këto projekte.</p> <p>[Evidencat 3.19.; 3.21.]</p> <p>[Evidenca 3.20.]</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga vëzhgimi dokumentar rezulton se departamenti ka hartuar një rregullore të posaçme për mbrojtjen e diplomës e cila është vënë në dispozicion të studentëve. Studentët në përmbyllje të ciklit të studimeve e kanë detyrim ligjor realizimin dhe mbrojtjen e diplomës. Studentëve ju kërkohet të depozitojnë në sekretarinë e departamentit një projekt kërkimor sipas anekseve të rregullores ku përcaktohet qartë fusha e studimit, tema e mikrotezës, qëllimet, objektivat, rëndësia e studimit, literaturë e shqyrtuar si dhe propozohet pedagogu udhëheqës. Departamenti në një mbledhje të posaçme ngre me vendim komisionin e provimit/ ose atë të mbrojtjes të temës së diplomës me profesorë /pedagogë me përvojë si dhe kryetarin e këtij komisioni. Të gjitha procedurat publikohen në mjediset e fakultetit.</p> <p>[Evidenca 3.6.1.]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe</p>	<p>Departamentet dhe stafi akademik janë përgjegjës për njohjen e studentëve me udhëzimet dhe afatet kohore, për procesin e mbrojtjes së diplomës dhe realizimin me sukses të detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit. Studentët asistohen nga pedagogët për dhënien e provimit final apo përgatitjes të mbrojtjes të</p>

<p>materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>mikrotezës, si punim i diplomes. Kështu studentët e programit të studimit “Master i shkencave” kanë si provë finale diplomimi realizimin e një punimi diplome. Studentit i caktohet një udhëheqës shkencor, i cili ndër të tjera ka përgjegjësi të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t’i mundësojë studentit të arrijë standarde të larta të hulumtimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e punës për shkrimin dhe përgatitjen e punimit për mbrojtje. [Evidenca 3.6.1.]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Të gjithë studentët e këtij programi janë të obliguar të mbrojnë diplomën me anën e punimit të pavarur të mikrotezës konform Ligjit 80/2015, të Arsimit të Lartë. Për përgatitjen e punimit të diplomes studenti nën udhëheqjen dhe konsulencën e pedagogut mban në vëmendje kodin Etik të kërkimit në institucion si garant për një punim autentik, të ndershëm e të suksesshëm. [Evidenca 3.6; 3.6.1.]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Bazuar në rregullore si dhe në praktikën e aplikuar, përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e fushave orientuese të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Në zgjedhjen e temës studenti duhet të jetë i aftë të argumentojë zgjedhjen e tij mbështetur në parimet e metodologjisë së kërkimit. Argumentat e studentit lidhen me interesin e temës, egzistencën e punimeve të mëparshme, egzistencën e burimeve të disponueshme të informacionit si dhe kushtet e nevojshme infrastrukurore apo logjistike për realizimin e studimit. Tema e diplomës ka karakter teoriko- aplikativ dhe studenti drejtohet për këtë qëllim nga një pedagog i departamentit i cili ka përvojën e kërkimit në fushën e temës përkatëse. Drejtimi i studentit bëhet nga pedagogu përkatës i miratuar nga departamenti, duke respektuar detyrimet për një temë diplome sipas standardeve të miratuara për këtë qëllim në rregulloren për përgatitjen e temës së diplomës. Pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin gjatë gjithë punës për përgatitjen e temës. [Evidenca 3.6.; 3.6.1.; 3.18.; 4.6.]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti i Sociologjisë dhe personeli akademik i angazhuar i asiston studentët për lehtësimin e mbledhjes së të dhënave në terren, matjes së koncepteve apo variablove në studim sipas shkallëve të masës që studenti duhet të përdorë, analizave të tipit statistik bazuar tek programet e informatizuara, testeve të kontrollit etj, në mjediset e institucionit apo jashtë tij. Veçanërisht pedagogët udhëheqës së temave të diplomës dhe praktikave profesionale ndihmojnë studentët me kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma të tjera kërkimore. Ambientet e fakultetit mund të përdoren nga studentët për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, si përpunimin dhe klasifikimin e të dhënave, përgatitja e grafikëve statistikorë, analizimi i të dhënave etj. Të cilat mund t’i duhen studentit për të përgatitur temën e tij të diplomës. [Evidenca 3.6.1.; 3.18.; 4.6.]</p>

<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e punimit të diplomave të ciklit të dytë si dhe kodin e etikës në kërkim rezultojnë se një nga detyrat e udhëheqësit të diplomës është të kërkojë nga studentët diplomantë zbatimin e kriterëve dhe kërkesave që sanksionohen në këto dokumenta. Një nga elementët që komisioni i vlerësimit mban parasysh për vlerësimin e punimit të diplomës është kontrolli i plagjiaturës apo kopjimit si dhe manipulimi i të dhënave, kërkesa këto të etikës në kërkim.</p> <p>Udhëheqësi vlerëson progresin e studentit rregullisht dhe monitoron punën e tij në fazat kryesore të realizimit të tij; fazës konceptuale, fazës metodologjike dhe fazës empirike. Udhëheqësi shkencor vetëdijëson studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar për të ndërmarrë mbrojtjen para komisionit. Udhëheqësi kontrollon studentin nëse ai i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e reflektuara gjatë procesit të konsultimeve. Gjithashtu udhëheqësi e asiston studentin edhe në nxjerrjen e përfundimeve dhe sidomos në shpjegimin dhe interpretimin e tyre. Në rastet kur udhëheqësi garanton cilësinë e rezultateve dhe konfirmon se punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit, lëshon deklaratën përkatëse, e cila sipas rregullores, vendoset në fillim të punimit të diplomës.</p> <p><i>[Evidenca 3.6.; 3.6.1.]</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Institucioni dhe Departamenti i Sociologjisë i ka përcaktuar qartë edhe modalitetet e mbrojtjes të diplomës të ciklit të dytë "Masteri shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore" sipas rregullores së programit të studimit. Në përfundim të mbrojtjes të temës së diplomës studenti vlerësohet me notë nga 4 deri në 10.</p> <p>Për vlerësimin e punimit, anëtarët e komisionit, udhëheqësi dhe reçensenti duhet të mbajnë parasysh kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përcaktuara qartë në rregullore. Vlerësimi i punimit të diplomës bëhet nga një komision me një përbërje me jo më pak se tre anëtarë.</p> <p><i>[Evidenca 3.6.; 3.6.1. neni 9]</i></p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme studentët, që kanë plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe kanë mbrojtur punimin e diplomës, pajisen nga institucioni me Diplomë dhe suplementin e diplomes "Master i shkencave" në "Sociologji e zhvillimeve shoqërore" të miratuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajiset vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj.</p> <p><i>[Evidencat 3.6.; 3.7.; 3.8.; 3.10.]</i></p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nga investigimi i kryer në Fakultetin e Shkencave Sociale rezultojnë se studentit në përfundim të studimeve pajiset me diplomën si dhe suplementin e diplomës në të cilin përmbahen: rezultatet e gjithë provimeve dhe detyrimeve, kreditet përkatëse (të miratuara nga Ministria e Arsimit), si dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të detajuar.</p> <p><i>[Evidencat 1.2.; 3.6.]</i></p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni, mbështetur në ligjin e administrimit të dokumentacionit zyrtar ruan për një periudhë të pacaktuar dokumentacionin. Ruajtja e dokumentacionit përcaktohet nga ligji në fuqi si dhe aktet e brendshme rregullatore të Universitetit të Tiranës.</p> <p>Dokumentacioni themelor për studentin është:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Rregjistri themeltar i studentit i cili vërteton rregjistrimin e studentit i cili pajiset me numër matricullimi deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës. - Rregjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. - Rregjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave që vërteton emërtimin e diplomave dhe çertifikatave. <p>Këto dokumenta si dhe procesverbalet e provimit, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalitetin në formë hardcopy dhe elektronike. [Evidenca 1.2.; 1.3.; 2.9.]</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Universiteti i Tiranës(më tej UT) mbledh, ruan dhe përditëson periodikisht të dhënat për stafin akademik të përfshirë në programin e studimit Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore. UT ka në strukturën e vet njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës, mbështetur në statutin e vet, neni 44, dhe një përfaqësues i saj është atashuar në Fakultetin e Shkencave Sociale(më tej FSHS), me detyrë të mbledhë, të ruajë dhe përditësojë të dhënat për personelin e angazhuar në programin Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore (më tej MSHSZHSH).</p> <p>Nga shqyrtimi i raportit të vlerësimit të brendshëm (më tej RVB) dhe vizita në institucion vlerësojmë se institucioni ka ruajtur të dhënat për personelin akademik, efektiv dhe të fuar, sipas organigramës së UT dhe strukturën analitike të FSHS, në rang njësie bazë me personelin përkatës. Departamenti i Sciologjisë (më tej DS) ka ndërtuar prej vitesh një praktikë pune të mirëorganizuar për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e angazhimit të çdo anëtari në secilin semestër dhe vit akademik të përfshirë në programin e studimit dhe personat përgjegjës për funksionimin e duhur të programit të studimit sipas profileve përkatëse.</p>



	<p>Referimi sipas seksioneve me dokumenta të atashuar në dosjen e akreditimit:</p> <p>Seksioni 1: Dokumente rregullatore të Universitetit të Tiranës</p> <p>Seksioni 2: Dokumente rregullatore të Fakultetit të Shkencave Sociale</p> <p>Seksioni 3: Dokumente rregullatore të Departamentit të Sociologjisë dhe të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”.</p> <p>Seksioni 4: Dokumente përmbajtësore të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”.</p> <p>Seksioni 5: Dokumente përmbajtësore të përkthyer në anglisht të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore”.</p> <p><i>Për këtë kriter iu referohemi dokumentave të atashuar:</i></p> <p><i>1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT dhe neni 44, 1.3. Rregullore e UT; 1.7 Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.8 Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 2.20. Informacion për politikën e burimit njerëzore dhe vlerësimin e personelit, 2.23 Udhëzim për dosjen e pedagogut.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatohet se DS në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit, mbështetur në nenet 67 dhe 68 të statutit të UT, që fillojnë me shpalljen e thirrjes, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendime në bazë të kriterëve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme, si Statuti dhe rregulloret e UT dhe FSHS. Shih dokumentacioni e dosjes në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm (më tej GVJ).</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT dhe nenet 67 dhe 68, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatohet se DS shpall kriteret për rekrutimin e pedagogëve me kohë të plotë dhe të pjesëshme, sipas Manualit të punësimit në UT, dhe në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për rekrutimin e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e thirrjes në faqen e Agjencia e Prokurimeve Publike (më tej APP-së) duke paraqitur dhe afatet kohore të aplikimit, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendime në bazë të kriterëve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme, Statuti dhe rregullore e UT/FSHS dhe i bën publike.</p> <p>Për vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për vendet e lira të punës për staf akademik efektiv apo me kontratë, Dekani krijon komisionin ad hoc me përbërje 5 anëtarë sipas kësaj ndarjeje: 3 anëtarë nga departamenti që ka aplikuar, 1 anëtar përfaqësues i Dekanit, 1 anëtar përfaqësues i Rektoratit/punëdhënësit. Komisioni mbi bazën e manualit të punësimit administron procesin, përmes hartimit të kriterëve objektive të vlerësimit ndërton një sistem vlerësimi me pikë për çdo konkurrent/e.</p> <p>Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës ndjek të gjitha procedurat në lidhje me rekrutimet e reja, si koordinimin e punës me Njësinë Bazë, shpalljen e vendit të punës në APP dhe në faqen e UT-së, hartimin e ofertës së punës, kriteret e pranimit, ngritjen e komisionit ad hoc, vlerësimin e dosjeve, zhvillimin e konkursit, dhënie të informacionit përfundimtar, shpalljen e vendimit dhe lidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, që është Rektori i UT-së.</p>

	<p>Shih dokumentacioni e dosjes në dipozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe praktikata e rekrutimit (më tej GVJ).</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT dhe nenet 67 dhe 68, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion dhe vizita e takimet në FSHS, konstatohet se DS në bashkëpunim me njësinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës harton dhe zbaton procedura specifike për rekrutimin e personelit bazuar në kritere të përgjithshme dhe specifike që garantojnë rekrutimin e personelit akademik në përputhje me nevojat e programit bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT/FSHS. DS kujdeset që stafi akademik të përditësojë CV akademike rregullisht, Marrëveshjen vjetore, ngarkesën vjetore si dhe çdo dokumentacion që i bashkëngjitet Rregullores së programit të studimit në MSHSZHSH. Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DS. Bazuar në kuadrin ligjor kjo njësi arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK si dhe marrëveshjet kontratë të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të procesit të rekrutimit.</p> <p>Shih dokumentacionin e dosjes në dipozicion të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe praktikata e rekrutimit (më tej GVJ).</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT dhe nenet 67 dhe 68, 1.3. Rregullore e UT; 1.12 Manuali për punësimin e personelit UT, 2.4 Rregullore e FSHS.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht						
			X						



Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS, DS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m², 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 3,750 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë falas bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik, UT-ja ka ngritur në strukturën organizative të saj Sektorin e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë si dhe komisionin përkatës për promovimin e stafit akademik, që administron dosjet me informacion të plotë, në lidhje me kërkimin shkencor dhe promovimin akademik të personelit akademik. Ndërkohë që në Departamentin e Sociologjisë, personeli akademik depoziton të</p>

	<p>dhëna mbi arritjet akademike, periodikisht Të gjitha nevojat e stafit në funksion të realizimit të planit mësimor, mësimdhënies dhe detyrave të tjera administrative, që stafi akademik ka detyrimin të kryejë brenda vitit akademik, përmes koordinatorit të programit i referohen personelit të administratës, sipas nevojës dhe sipas procedurës, që të përmbushen shërbimet e kërkuara. Kështu, kërkesat për mjete pune, referohen nga koordinatori tek punonjësja e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe së fundi në Zyrën e Financës, që i referojnë tek administratori i FSHS-së. Pasi firmosen, kalojnë më magazinë dhe bëhet shpëmdarja e materialeve të kërkuara, tek pjestari i stafit të brendshëm që i ka kërkuar ato. Personeli administrativ, është gjithnjë në mbështetje të stafit akademik në realizimin e veprimtarisë së përditshme mësimore dhe kërkimore, Nevojat për njoftime dhe publikime për programin e MSHSZHSH, por jo vetëm, referohen nga departamenti tek Sektori i IT-së në FSHS.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.20 Modeli i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS, DS kanë krijuar hapësira e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe programit të studimit: <i>Aftësimi i studentëve për të realizuar kërkime konkrete sociologjike në terrenin e shoqërisë shqiptare, si dhe të kenë mundësi për të ndjekur studimet e thelluara në nivelin e tretë të doktoratës.</i> FSHS dhe DS janë të angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që realizon dhe administron programin e studimit MSHSZHSH. UT-ja në dokumentet bazë të veta shpreh angazhimin për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik, duke inkurajuar kërkimim shkencor, promovimin dhe trajnimin e personelit akademik në universitetet perëndimore me të cilat ka lidhur marrëveshje për shkëmbim të stafit akademik për trajnime dhe mësimdhënie. Në funksion të këtij angazhimi, është hartuar dhe është duke u zbatuar strategjia e ndërkombëtarizimit të universitetit, pjesë e strategjisë së UT-së 2018-2023 dhe një strategji katërvjeçare për kërkimin shkencor. Fakulteti i Shkencave Sociale është angazhuar në kualifikimet dhe pjesëmarrjen e pedagogëve të DS, përmes pjesëmarrjes në konferenca të organizuara si brenda institucionit edhe jashtë tij.</p> <p>UT, FSHS dhe DS mbështet stafin për pjesëmarrje në konferenca në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me tematika në fushat e studimit që departamenti mbulon përmes grantit që parashikon mbështetje financiare për stafin, nxiten dhe mbështeten të publikojnë në organet shkencore periodike të DS dhe FSHS si Lente sociologjike, Politikja, Puna Sociale dhe Politika Sociale. Në kuadrin e nxitjes së kërkimit shkencor, në zbatim të elementeve të planit strategjik të DS dhe strategjisë së zhvillimit të programit MSHSZHSH, si dhe në kuadrin e strategjisë së ndërkombëtarizimit, kualifikimi i stafit ka marrë dimensione të reja.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 1.18. Vendim nr. 36, datë 02.09.2021 "Për miratimin e programit të grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 2.25 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 4.11.</i></p>

	<p><i>Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DS kanë mundësuar programe specifike për përdorimin e metodave të të përparuara të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik dhe të personelit mësimor-shkencor si është Qendra virtuale e trajnimit dhe zhvillimit profesional. Në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të UT-së, 2018-2023, UT-ja synon të jetë një institucion aktiv në implementimin e dijes, gjenerimin e ideve krijuese dhe nxitjen e shkencës në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një mësimdhënieje bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Për arritjen e këtij qëllimi, stafi akademik inkurajohet në mënyrë të vazhduar prej të gjitha niveleve drejtuese, për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja.</p> <p>Në varësi të nevojave akademike, UT-ja ka krijuar udhëzimet e nevojshme për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme edhe inovative në funksion të lehtësimit dhe pasurimit të metodave të mësimdhënies, në bazë të fushës së studimit. Është për t'u vënë në dukje se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19-të, procesi i mësimdhënies u bë i mundur të realizohet në distancë, duke qenë i mbështetur nga rregulloret dhe udhëzimet e nevojshme për stafin dhe studentët. Njëkohësisht në nivel departamenti janë organizuar trajnime si seminari online “Making degree programs more relevant and more learner centered, in the light of EU/EHE objectives trends”, ashtu edhe në nivel institucioni janë organizuar trajnime për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie, si për përdorimin e programit Moodle, në të cilin kanë marrë pjesë edhe anëtarë të stafit akademik.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 1.15 Udhëzues UT për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë, 1.17 Vendim për disa shtesa në udhëzuesin e UT- Për zhvillimin e mësimi në distancë, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DS janë të angazhuar maksimalisht për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë , që dëshmohet edhe në strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Sociologjisë për periudhën kohore 2020-2024, të programit të studimit MSHSZHSH, <i>Aftësimi i studentëve për të realizuar kërkime konkrete sociologjike në terrenin e shoqërisë shqiptare, si dhe të kenë mundësi për të ndjekur studimet e thelluara në nivelin e tretë të doktoratës.</i> Planifikimi i kohës së punës për secilin anëtar të stafit është e shpërndarë në të tre elementet përbërës së saj: realizimi i procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve (sipas bazës ligjore në fuqi), në bazë të Udhëzimit të MASR Nr.29, datë 10.09.2018. Ndarja e ngarkesës mësimore realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit, për secilin anëtar të stafit akademik të programit Master Shkencor në përputhje të plotë me kompetencat profesionale të secilit pedagog dhe përparësive në punën kërkimore, që secili parashikon individualisht dhe në nivel Departamenti, Fakulteti apo Universiteti, në fillim të çdo viti akademik. Kjo siguron një shpërndarje optimale të ngarkesës së punës dhe specifikisht të ngarkesës mësimore ndërmjet stafit, duke e orientuar atë në këtë mënyrë në përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. Marrëdhëniet e punës midis UT-së dhe të gjitha kategorive të stafit, rregullohen me kontratat e punës, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të drejtat dhe</p>






	<p>detyrimet për secilën kategori të stafit të UT-së, janë në përputhje të plotë me statutin dhe rregulloren e UT-së.</p> <p>Për ofrimin e këtij program për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar: 1- 10 (dhjetë) personel me kohë të plotë (PAE) prej të cilëve 8 janë personel akademik me kohë të plotë të njësisë bazë të Departamentit të Sociologjisë dhe 1 prej tyre personel akademik efektiv i njësisë bazë të Shkencave politike në FSHS, UT, angazhuar në realizimin e lëndëve të profilit ndërdisiplinor.</p> <p>Nga personeli akademik efektiv i angazhuar për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” janë 1 (një) personel akademik i kategorisë Prof. Dr.; 2 (dy) personel akademik të kategorisë Prof. Asoc. Dr.; 7 (shtatë) personel akademik të kategorisë lektor me gradën shkencore Dr dhe Ph.D.; 1(një) personel akademik të kategorisë asistent lektor me statusin kandidat për doktor.</p> <p>Personeli akademik që realizon këtë program studimi është i specializuar sipas fushave përkatëse dhe i punësuar në bazë të kriterëve dhe kërkesave ligjore për anagazhim në një program studimi.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.20 Modeli i marrëveshjes për organizimin e kohës vjetore të punës, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 4.12. Tabelë përmbledhëse-Numri i personelit për çdo njësi Personel Akademik Efektiv(PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë(PAK), titujt/gradat, Personel ndihmësakademik dhe Administrativ(PNA dhe PA) (Tabela 1 dhe 2), 4.13 Tëdhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 7).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatohet se UT, FSHS, DS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësirat e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m², 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DS me rregjim turni për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 4619 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Në mjediset e FSHS-së DS-ja ka në shfrytëzim mjedise leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MSHSZHSH; salla për realizimin e konferencave, e pajisur me videoprojektor, amfiteatri, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktiviteteve</p>

	<p>doktorale, e pajisur me mjetet , përkatëse, në katin e dytë; të gjitha klasat e leksionit dhe seminarit kanë të instaluar videoprojektorë. Në dispozicion të secilit pedagog të angazhuar në programin MSHSZHSH janë laptop personal, kompjuter statik, printer dhe mjedis të përshtatshëm për të punuar dhe ruajtur materiale dhe dokumentacion, i lidhur me mësimdhënien dhe për mësimdhënien. Pajisjet kompjuterike në ndërtesë, janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion ' të mësimdhënies.</p> <p>Mjediset e fakultetit menaxhohen në mënyrë të përshtatshme dhe me efikasitet për krijimin e kushteve optimale për studentët e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Në sheshpushimet e kateve janë të instaluar ekranë që shfaqin sistematikisht informacione shumë të rëndësishme për mësimdhënien, si njoftime, orarin mësimor, informacione lidhur me veprimtari shkencore, konferenca, trajnime, diskutime, leksione të hapura, paraqitje publike tekstesh, informacione zyrtare për studentët dhe stafin. Gjithashtu në varësi të zhvillimeve të reja FSHS-ja në kërkesat e tij buxhetore, parashikon në mënyrë të vazhdueshme pajisjen e stafit dhe mjediseve me pajisje elektronike dhe teknologji bashkëkohore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedisë të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatohet se UT, FSHS, DS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësirat e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m², 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DS me efikasitet për të rritur koeficientin e shfrytëzimit; sidomos biblioteka e FSHS me 4619 tituj dhe 70 vende studimi dhe leximi, por edhe literaturë specifike për programin e mundesi për të përdorur programe profesionale si SPSS, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundesinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Në mjediset e FSHS-së DS-ja ka në shfrytëzim mjedisë leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MSHSZHSH; salla për realizimin e konferencave, e pajisur me videoprojektor, amfiteatri, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktiviteteve doktorale, e pajisur me mjetet përkatëse në katin e dytë; të gjitha klasat e leksioneve dhe seminareve kanë të instaluar videoprojektorë. Pajisjet kompjuterike në ndërtesë, janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion ' të mësimdhënies.</p> <p>Mjediset e fakultetit menaxhohen në mënyrë të përshtatshme dhe me efikasitet për krijimin e kushteve optimale për studentët e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Në sheshpushimet e kateve janë të instaluar ekranë që shfaqin sistematikisht informacione shumë të rëndësishme për mësimdhënien, si njoftime, orarin mësimor, informacione lidhur me veprimtari shkencore, konferenca, trajnime, diskutime, leksione të hapura, paraqitje publike tekstesh, informacione zyrtare për studentët dhe stafin. Gjithashtu në varësi të zhvillimeve të reja FSHS-ja në kërkesat e tij buxhetore, parashikon në</p>






	<p>mënyrë të vazhdueshme pajisjen e stafit dhe mjediseve me pajisje elektronike dhe teknologji bashkëkohore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DS mbështetur në Statutin e UT-së kanë krijuar hapësirat e duhura për veprimtarinë e stafit, kanë krijuar strukturat për të përmbushur misionin e UT dhe programit të studimit në mënyrë specifike, ashtu si kanë përcaktuar detyrat konkrete për personelin akademik dhe ndihmësakademik. Kapacitetet që disponon FSHS: godina 4,500 m², 6 salla leksionesh me kapacitet 747 vende, 16 salla seminaresh me kapacitet 759, janë në dispozicion të DS me eficiencë për të rritur koeficientin e shfytëzimit; biblioteka e FSHS me 4619 tituj dhe tekste dhe 70 vende studimi dhe leximi, biblioteka e UT gjithashtu, që u jep mundësinë përdoruesve të vizitojnë bibliotekën online JSTOR, EBSCO, SAGE.</p> <p>Në mjediset e FSHS-së DS-ja ka në shfrytëzim mjedisë leksioni dhe seminari, ku zhvillohet mësimi edhe në programin MSHSZSH; salla për realizimin e konferencave, e pajisur me videoprojektor, amfiteatri, që ndodhet në katin e parë; gjithashtu, për nevoja të stafit, shërben edhe një klasë për realizimin e aktiviteteve doktorale, e pajisur me mjetet , përkatëse, në katin e dytë; të gjitha klasat e leksionit dhe seminarit kanë të instaluar videoprojektorë. Pajisjet kompjuterike në ndërtesë, janë të lidhura me linjë interneti dhe e gjithë ndërtesa ka akses në internet WiFi. Në katin e parë të ndërtesës, studentët kanë mjedis për pushim edhe punë, për diskutime, në funksion të mësimdhënies.</p> <p>Mjediset e fakultetit menaxhohen në mënyrë të përshtatshme dhe me eficiencë për krijimin e kushteve optimale për studentët e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore”. Gjithashtu në varësi të zhvillimeve të reja FSHS-ja në kërkesat e tij buxhetore, parashikon në mënyrë të vazhdueshme pajisjen e stafit dhe mjediseve me pajisje elektronike dhe teknologji bashkëkohore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe dokumentacionit në dispozicion të GVJ konstatojmë se UT, FSHS, DS duke konsideruar profilin e studimit të programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” dhe specifikave të leximit dhe thellimit në literaturë studimore dhe aftësimin në kryerjen e studimeve sociologjike në funksion të analizave sociologjike Fakulteti i Shkencave Sociale ofron në mjediset e bibliotekës së Fakultetit përpos ulëseve për studimin e literaturës edhe pajisje të teknologjisë së informacionit që ofrojnë mundësitë për të punuar në programe profesionale si SPSS, akses në biblioteka/librari digjitale, akses në revista shkencore të profilizuara sipas programit të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.33 Të dhëna për infrastrukurën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë, 2.30. Të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj)Tabela 17).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS, DS kanë siguruar kushtet për zhvillimin e praktikave mësimore pranë institucioneve dhe shoqërive publike ose private. Për realizimin e praktikave profesionale UT, FSHS dhe DS kanë marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione për . Praktikave profesionale dhe veprimtari të</p>

<p>mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>tjera praktike zhvillohen në institucione të natyrës së sipërpërmendur në përputhje me profilin e përgatitjes së studentëve. Praktikrat e studentëve janë realizuar sipas pritshmërive dhe rezultatet kanë dëshmuar vlerën e madhe të tyre, ashtu si janë vlerësuar nga studentët si veprimtari të kryera në kushte optimale.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 3.19. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang programiesh studimi për praktikrat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorët e tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), 3.21.1. Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, internship dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se studentët përdorin në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore me sallat e leximit, multimediale, fondin e hapur, koleksionet dhe fondin e mbyllur brenda FSHS, me personel në dispozicion, me orar 08.00-18.00, i cili është i mundshëm për t'u përdorur nga studentët, gjithashtu biblioteka është në njëjtin mjedis ku studentët e MSHSZSHSH zhvillojnë programin mësimor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.98: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online eij (Tabela 17), 2.32: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS për stafin akademik dhe studentët ofrojnë të drejtën e antarësimin falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogëve, revistave dhe librarive elektronike si dhe atyre hard-copy. Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Biblioteka ka 4619 tituj dhe tekste dhe pasurohet herëpashere me blerje të reja.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.98: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj (Tabela 17), 2.32: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS për stafin akademik dhe studentët ofrojnë të drejtën e antarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogëve, revistave dhe librave elektronike si dhe atyre hard-copy. Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Biblioteka ka 4619 tituj dhe tekste dhe pasurohet herëpashere me blerje të reja. Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka finalizuar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR për qasje të drejtpërdrejtë në Bibliotekën digjitale JSTOR në të gjithë godinat dhe rrjetin e UT-së. Biblioteka digjitale JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina. Kjo bibliotekë digjitale u krijua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të konvertojnë punimet e shtypura në format digjital, të cilat do të ruhen për brezat e ardhshëm. Libraria është e aksesueshme në adresën: https://wvww.jstor.org/. Gjithashtu, në web-in e UT-së personeli akademik dhe studentët, kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line ULIBRARY, përmes të cilës eksplorohet në fusha të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës, i cili gjendet po në këtë faqe dhe ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në përdorim është gjithashtu faqja Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës ku përditësohen tekste dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.Net. Studentët kanë kërkuar për materiale/tekste, artikuj digjitalë, sipas manualit të libraries digjitale, i cili ka shërbyer për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, duke aksesuar këtë shërbim në linkun: https://ulibrary.rash.al.</p> <p>Për Bibliotekën elektronike online është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor, EIFL/ Informacioni Elektronik për Biblioteka dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ koordinator për projektin ERA 2012, ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga e-library Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi- Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis. UT dhe FSHS i ka hapur rrugën edhe investimeve të reja në infrastrukturën teknologjike për të rritur mundësitë e shfrytëzimit pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik të bibliotekave apo faqeve mësimore elektronike.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.98: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj (Tabela 17), 2.32: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se studentët përdorin në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore me sallat e leximit, multimediale, fondin e hapur, koleksionet dhe fondin e mbyllur brenda FSHS, me personel në dispozicion, me orar 08.00-18.00, i cili</p>

<p>kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>është i mundshëm për t'u përdorur nga studentët, gjithashtu biblioteka është në njëjtin mjedis ku studentët e MSHSZHSH zhvillojnë programin mësimor.</p> <p>Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka finalizuar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR për qasje të drejtpërdrejtë në Bibliotekën digjitale JSTOR në të gjithë godinat dhe rrjetin e UT-së. Biblioteka digjitale JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe 2 milion dokumenta në 75 disiplina. Kjo bibliotekë digjitale u krijua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të konvertojnë punimet e shtypura në format digjital, të cilat do të ruhen për brezat e ardhshëm. Libraria është e aksesueshme në adresën: https://www.jstor.org/. Gjithashtu, në web-in e UT-së personeli akademik dhe studentët, kanë mundësi të aksesojnë libraritë on-line ULIBRARY, përmes të cilës eksplorohet në fusha të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës, i cili gjendet po në këtë faqe dhe ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Në përdorim është gjithashtu faqja Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës ku përditësohen tekste dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.Net. Studentët kanë kërkuar për materiale/tekste, artikuj digjitalë, sipas manualit të librarise digjitale, i cili ka shërbyer për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, duke aksesuar këtë shërbim në linkun: https://ulibrary.rash.al.</p> <p>Për Bibliotekën elektronike online është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor, EIFL/ Informacioni Elektronik për Biblioteka dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ koordinator për projektin ERA 2012, ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga e-library Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi- Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis. UT dhe FSHS i ka hapur rrugën edhe investimeve të reja në infrastrukturën teknologjike për të rritur mundësitë e shfrytëzimit pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik të bibliotekave apo faqeve mësimore elektronike.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.98: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj (Tabela 17), 2.32: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukurën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT, FSHS për stafin akademik dhe studentët ofrojnë të drejtën e antarësimit falas në bibliotekë dhe të përdorimit të katalogëve, revistave dhe librave elektronike si dhe atyre hard-copy. Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Biblioteka ka 4619 tituj dhe tekste dhe pasurohet herëpashere me blerje të reja.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.29: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj (Tabela 17), 2.32:</i></p>

	<i>Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë, www.unitir.edu.al.</i>		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se studentët përdorin në mënyrë të barabartë bibliotekën mësimore me sallat e leximit, multimediale, fondin e hapur, koleksionet dhe fondin e mbyllur brenda FSHS, me personel në dispozicion, me orar 08.00-18.00, i cili është i mundshëm për t'u përdorur nga studentët, gjithashtu biblioteka është në njëjtin mjedis ku studentët e MSHSZSHH zhvillojnë programin mësimor. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.98: Rregullore e bibliotekës, 2.30: të dhëna për bibliotekën, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj (Tabela 17), 2.32: Dokument mbi blerjet e fundit për bibliotekën e FSHS, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 3.9: Propozim për blerje librash nga Departamenti i Sociologjisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se në zbatim të Ligjit Nr. 80 2015, Neni 101, Universiteti i Tiranës dhe FSHS-ja, mban në formë të shkruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✦ Regjistrin themeltar të studentëve, ✦ Regjistrin e arritjeve akademike, ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik, ✦ Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <p>Sekretaritë mësimore të departamenteve i plotësojnë këto tre regjistra edhe në formë elektronike. Sekretaria është struktura përgjegjëse për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me arritjet akademike deri në diplomimin e studentëve. Krahas sekretarisë mësimore, në ndihmë të këtij procesi në UT dhe FSHS funksionon Sektori i IT-së dhe Sistemi kompjuterik, i cili është një sistem modular, që operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundur shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish (aktualisht jo në kushte teknike pune). Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Secili grup përdoruesish, është i autorizuar ta përdorë në mënyrë të përgjegjshme sistemin. Sistemi i menaxhimit të informacionit është një platformë digjitale moderne, që iu mundëson, së pari, studentëve që të kenë në çdo kohë mundësinë për të aksesuar ofertën akademike, administrative, sociale, kulturore dhe sportive në UT brenda dhe jashtë procesit mësimor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 2.20. Informacion për</i></p>

	<i>politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit, 2.23. Udhëzim për dosjen e pedagogut.</i>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT-ja ka hartuar dokumenta që rregullojnë procedurat e menaxhimit të informacionit brenda institucionit. Moduli për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit ende nuk është pjesë e platformës së menaxhimit të informacionit, por strukturat përgjegjëse për administrimin e këtij informacioni, e ruajnë këtë informacion në tabela excel apo word dhe e vendosin në përdorim, sipas kërkesave për shfrytëzimin e këtij materiali. Sektori i burimeve njerëzore dhe protokoll arkivës menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve dhe të regjistrave themeltarë, ndjek procedurat për shpërndarjen dhe grumbullimin e kontratave të punës për të gjithë punonjësit e FSHS/DS-së, menaxhon afatet kohore të kontratave të punës për çdo punonjës, hedh të dhënat personale të çdo punonjësi në regjistrat themeltarë, nxjerr të dhëna nga dosjet personale ose librezat e punës për çdo punonjës, kur kërkohen për evidence nga strukturat respektive. Nga RVB shihet se ka rinisur të funksionojë sistemi i menaxhimit të informacionit në UT.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.9: Privatësia në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.20. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit, 2.23. Udhëzim për dosjen e pedagogut.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se sektori i IT-së siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë MSHSZSH. Çdo burim informacioni në sistem shoqërohet me dokumentacionin administrativ përkatës sipas procedurave të UT-së, të përcaktuara në rregulloren përkatëse të UT-së.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm, mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra IT - Përgjegjës Departamenti - Sekretare - Kryesekretare - Studentët - Pedagogët - Rektor <p>Programi i Transparencës për Universitetin e Tiranës dhe rregullorja e UT-së për mbrojtjen e të dhënave personale krijojnë kushtet e nevojshme për të përfitur akses të dedikuar në informacione e dokumente, për stafin akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët e programit të studimit, të cilët mbi bazën e kërkesave të adresuara zyrtarisht, përfitojnë mundësi për të përdorur informacionin e kërkuar. Nëse nuk marrin shërbim në rrugë elektronike studentet dhe stafi akademik marrin shërbim përmes kërkesave që bëjnë zyrtarisht apo përmes platformës e-albania.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit</i></p>



	<p><i>ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.9: Privatësi në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore 2018, www.unitir.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ngashqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se personeli akademik dhe studentët kanë në përdorim adresa zyrtare në @unitir.edu.al, dhe përdorin platformën Microsoft Teams për të komunikuar dhe marrë informacion në faqen e Institucionit: https://unitir.edu.al/aksesi-online. UT-ja ka hartuar një dokument të posaçëm, ku përcakton modalitetet e marrjes së shërbimeve dhe krijimin e hapësirave të komunikimit midis stafit akademik dhe studentëve, në procesin e mësimdhënies, por jo vetëm</p> <p>Sistemi kompjuterik i UT-së, është një sistem modular, i cili operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Çdo hyrje informacioni në sistem, shoqërohet me dokumentacionin administrativ përkatës, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e UT-së. Ky sistem ofron mundësi komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve, konkretisht studentët vlerësojnë programin mësimor nëpërmjet pyetësoreve në sistem, ashtu si personeli akademik nëpërmjet sistemit përcjell rezultatet e provimeve tek studentët. Këto shërbime kanë qene thelbësore gjatë periudhës së pandemisë Covid -19, sepse e gjithë veprimtaria e DS u realizua përmes platformës Microsoft Teams, u zhvillua mësimi në distancë, përfshirë pajisjen e studentëve me leksione dhe literaturë, ngarkimin e punëve të pavarura dhe të grupit, projektet e kursit, provime të pjeseshme dhe finale, vlerësimi përfundimtar, sikurse edhe trajnime, mbledhje, komunikime për çështje të mbarëvajtjes së departamentit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore 2018, www.unitir.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se sistemi kompjuterik i Universitetit të Tiranës, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Sipas nevojave sistemi mundëson dhe prodhon raporte statistikore, mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit etj. Sistemi informatik në FSHS dhe platformat e përdorura, kanë siguruar raportime dhe monitorim në kohë reale të procesit të mësimdhënies, në të gjithë hallkat e tij, e nevojshme për periudhën e mësimdhënies, kontrollit dhe vlerësimit në distancë, për të krijuar raporte reale mbi ecurinë e proceseve në të gjitha nivelet.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore 2018.</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se UT ka një faqe web të posaçme ku publikohen informacione që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe veprimtaritë e ndryshme. Ky informacion publikohet në faqen online në gjuhën</p>

paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	shqipe dhe në gjuhën angleze. FSHS ka faqen e vet të web-it, ku paraqitet në mënyrë analitike programet e studimit, departamentet, kërkimi shkencor, informacione, njoftime dhe botimet. Të gjitha informacionet e publikuara respektojnë politikat institucionale të publikimit të informacionit për të drejtën e informimit, si dhe një faqe e web-it merret posaçërisht me Programin e Transparencës. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.8: Rregullore e UT për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT, 1.10: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT, 2.9: Rregullore e sekretarisë mësimore 2018. www.unitir.edu.al</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GJVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT-ja, harton në mënyrë periodike Raportin Financiar të institucionit, i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student, në nivel universiteti. Hartimi i buxhetit të Universitetit fillon nga njësia bazë pra që nga departamenti, duke patur parasysh nevojat e secilit prej tyre, por plotësimi i nevojave varet nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo departament dhe fakultet. Gjithsesi, ruhen balancat midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke ndjekur një politikë favorizuese për ato fakultete që krijojnë më shumë të ardhura, por pa diskriminuar fakultetet e tjera të cilët për nga natyra e tyre gjenerojnë më pak të ardhura dhe duke reflektuar në çdo rast nevojat për ndryshime në buxhet.</p> <p>UT-ja nuk harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, por harton një kosto mesatare studenti në nivel Universiteti. Në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit, si dhe në varësi të kërkesave të njësive kryesore, UT-ja harton plane afatmesme buxhetore. Gjithashtu, UT-ja ka miratuar edhe procedura dhe instrumente në mbështetje të stafit akademik, për arritjen e objektivave të mësimdhënies me standarde bashkëkohore dhe kualifikimit të mëtijshëm të tij, së bashku me udhëzimet përkatëse mbi mënyrën e përdorimit të tyre.</p> <p>FSHS harton planin buxhetor të përvitshëm, mbështetur në nevojat e identifikuara dhe kërkesat e stafit akademik, ndihmësakademik të departamenteve. DS paraqet çdo vit një plan të tillë në përputhje me nevojat e stafit për vitin akademik përkatës. Gjithashtu, FSHS harton plane financiare për të buxhetuar periudha afatmesme në përputhje me ciklet e kohëzgjatjes së një programi studimi, pra 2-vjeçar dhe 3-vjeçar. Planet i nënshtrohen konsultimit dhe diskutimit në dekanat, për t'u përcjellë</p>

	<p>më pas në Senatin Akademik dhe miratohen përfundimisht në Bordin e Administrimit të UT-së.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.32: Të dhëna për infrastrukurën, 2.36. Projekt buxheti afatmesëm FSHS 2019-2020, 2.37.; Raport financiar FSHS 2019, 2020, 2021, 3.26. Propozime për projektbuxhetin afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, 3.27. Propozime për projektbuxhet vjetor të Departamentit të Sociologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se në fillim të çdo viti buxhetor (joakademik), bëhet shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në UT, në përputhje të plotë me strukturën e Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza: Faza e parë është hartimi dhe miratimi i buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MASR. Faza e dytë është hartimi dhe miratimi i buxhetit nga të ardhurat e Universitetit. Hartimi dhe miratimi në total i buxhetit të Universitetit, pavarësisht nga burimet e financimit të tij, fillon nga njësitë bazë, kryesore dhe ndihmëse të tij. Departamentet e hartojnë projekt buxhetin e tyre dhe më pas ato koordinohen dhe miratohen në nivel fakulteti në dekanatin përkatës, më pas e paraqesin atë në Rektorat. Projekt buxheti paraqitet për shqyrtim dhe miratim në organet kolegjiale, fillimisht në Rektorat, në Senat dhe përfundimisht në Bordin e Administrimit.</p> <p>Gjithashtu Departamenti i Sociologjisë harton një plan financiar buxhetor të përbashkët për programet e studimit që mbulohen nga departamenti, i cili pasi miratohet nga departamenti, integrohet në planin financiar të institucionit, që si rregull përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.33: Të dhëna për infrastrukurën, 2.35. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, për FSHS (Tabel 18), 2.36. Projekt buxheti afatmesëm FSHS 2019-2020, 2.37.; Raport financiar FSHS 2019, 2020, 2021, 3.26. Propozime për projektbuxhetin afatmesëm të Departamentit të Sociologjisë, 3.27. Propozime për projektbuxhet vjetor të Departamentit të Sociologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se Universiteti i Tiranës, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar të jashtëm dhe të brendshëm. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm realizohet kryesisht prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MASR. Referuar organigramës së Universitetit të Tiranës dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, UT-ja ka ngritur në strukturën e vet Sektorin e Auditit të Brendshëm, i cili është në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit. UT-ja dhe FSHS kryejnë auditim të përvitshëm, vlerësojnë dhe dokumentojnë gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar, i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si dhe ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të UT pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Administratorja e FSHS-së raporton periodikisht për mënyrën e realizimit të buxhetit sipas zërave të parashikuar dhe të</p>

	<p>realizuar si dhe përgatit raporte dhe pasqyra që dokumentojnë gjendjen financiare dhe shpërndarjen e burimeve financiare.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 2.35. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, për FSHS (Tabel 18), 2.36. Projekt buxheti afatmesëm FSHS 2019-2020, 2.37.; Raport financiar FSHS 2019, 2020, 2021.</i></p>								
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se dokumenti i analizës financiare hartuar nga FSHS dhe UT, në fund të çdo viti buxhetor, miratohet e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivën dhe protokollin. Analiza nuk përshkruan vetëm periudhën korrente, por ka edhe një natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit në periudhat ushtrimore të shkuara, çka do të thotë, se të jep mundësinë për gjykuar mbi raporte financiare të tre viteve të kaluara akademike dhe mundësi të planifikimit të ndërhyrjeve të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të secilit program studimi, për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Mbi bazën e rezultateve të këtij raporti, hartohet dhe miratohet plani financiar për vitin në vijim.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 2.35. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, për FSHS (Tabel 18), 2.36. Projekt buxheti afatmesëm FSHS 2019-2020, 2.37.; Raport financiar FSHS 2019, 2020, 2021.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se burimet e financimit të Universitetit të Tiranës, si institucion publik, janë shprehur dhe përcaktuar në dokumentet baze të institucionit</p> <ul style="list-style-type: none"> - granti i politikave të zhvillimit; - granti i mësimdhënies; - granti i punës kërkimore-shkencore dhe i veprimtarive krijuese <p>Financimi i Universitetit, mbështetur në modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe zbatimi i skemës së financimit, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin</p> <p>Më qëllim mirëmenaxhimit e këtyre fondeve dhe sigurimit e një qëndrueshmërie financiare, UT shfrytëzon të gjitha burimet e mundshme të financimit, në përputhje me bazën ligjore dhe statusin e institucionit. Në analizën financiare vjetore të FSHS-së, shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare në nivel fakulteti, në përputhje me objektivat financiarë dhe politikat në nivel universiteti.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.33: Të dhëna për infrastrukturën, 2.35. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, për FSHS (Tabel 18), 2.36. Projekt buxheti afatmesëm FSHS 2019-2020, 2.37.; Raport financiar FSHS 2019, 2020, 2021.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="568 1749 735 1821">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="735 1749 967 1821">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="967 1749 1193 1821">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1193 1749 1461 1821">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="568 1821 735 1892"></td> <td data-bbox="735 1821 967 1892"></td> <td data-bbox="967 1821 1193 1892"></td> <td data-bbox="1193 1821 1461 1892" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminë programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se Universiteti i Tiranës mbështetet në një traditë të krijuar si universiteti i parë në vend në ofrimin e programeve të studimit të cilat reflektojnë kërkesa të reja të tregut të punës. Në Universitetin e Tiranës dhe në FSHS procesi i pranimit të studentëve e deri në përfundimin e plotë të ciklit të studimit, mbështetet në procedura të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Për çdo vit akademik, pranimi i studentëve kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. Kriteret e pranimit propozohen nga Departamenti i Sociologjisë dhe më pas miratohen nga Senati Akademik. Gjatë periudhës së zhvillimit të programit studentët kanë në dispozicion për informacione dhe shërbime të vazhdueshme struktura të tjera të posaçme siç janë Zyra e Informacionit, Zyra e Karrierës, Zyra e Shërbimeve & IT-jadhe Sekretaria Mësimore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.13.Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se në Statutin e UT përshkruhen qartë të drejtat dhe detyrimet e studentëve të cilat bazohen në parimet e barazisë. Rregullorja e UT dhe FSHS përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikatat e trajtimit të studentëve që nga rregjistrimi i tyre, deri në përfundim të studimeve, apo procedura dhe praktikatat e transferimit të tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë studentët të cilët aplikojnë dhe më pas shpallen fitues në programin e studimit MSHSZSH</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.13.Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.14.1 Vendim departamenti për ngritje</i></p>

	<p><i>komisioni ad-hoc pranimit në programin e ciklit të dytë të studimeve, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen nga Statuti i UT dhe Rregullorja e Transparencës, aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit apo në faqen zyrtare të FSHS për kandidatët për studentë, studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë ciklit akademik, të cilët arrijnë lehtësisht tek informacioni që iu duhet.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.13.Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.14.1 Vendim departamenti për ngritje komisioni ad-hoc pranimit në programin e ciklit të dytë të studimeve, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me FSHS dhe Departamentin e Sociologjisë si njësi bazë përgjegjëse, në fillim të vitit akademik harton dhe publikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Pranimit në programin e studimit bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara nga Senati Akademik për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.13.Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.14.1 Vendim departamenti për ngritje komisioni ad-hoc pranimit në programin e ciklit të dytë të studimeve, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS dhe DS si njësi kryesore e programit realizojnë komunikimin me publikun e interesuar nëpërmjet disa formave:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✳️ pasqyrimin në faqet e web -it të UT dhe FSHS dhe seksionit të Departamentit të Sociologjisë në lidhje me përmbajtjen, karakteristikat dhe kriteret e pranimit në këtë program studimi, ✳️ Organizimit të ditëve të hapura <p>Përvoja ka ndihmuar që programi i studimit të ketë vazhdimësi dhe cilësi mjaft të mirë të studentëve në hyrje dhe në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.13.Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.14.1 Vendim departamenti për ngritje komisioni ad-hoc pranimit në programin e ciklit të dytë të studimeve, www.unitir.edu.al.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Përcjellja e informacionit të plotë përmes rrugëve formale të komunikimit me studentët, përcaktohet në rregulloren e UT. Pasi fiton statusin e studentit, çdo student pajiset me adresën e tij elektronike në formatin emër.mbiemër@unitir.edu.al, që është një ndër format e komunikimit midis tij dhe institucionit.</p> <p>Në Rregulloren e UT, e cila është e aksesueshme për studentët në faqen e UT, përcaktohen qartë kushtet dhe procedurat që duhet të plotësojnë studentët për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve shpallen nga Dekani në fillimin të vitit akademik. Ato publikohen edhe në faqen Web të institucionit ku mund të aksesohen nga studentët. Website i FSHS është një mjet shumë i rëndësishëm ku publikohen informacione të përditësuara mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Po ashtu, publikohet edhe orari mësimor (me ditën, lëndën, sallën, orën e zhvillimit të mësimin dhe pedagogun e lëndës) në mjediset e FSHS</p> <p>Për çdo lëndë pedagogu përgatit syllabusin e lëndës, i cili përmban informacion të detajuar mbi literaturën që do të përdoret, format e kontrollit të dijes gjatë lëndës dhe vlerësimit të studentëve. Syllabusi u prezantohet studentëve në fillim të semestrit. Komunikimi i personelit akademik me studentët bëhet i mundur edhe përmes orareve të pritjes, të afishuara në mjediset e FSHS. Komunikimi i personelit akademik me studentët bëhet i mundur edhe përmes orareve të pritjes, konsultimit të afishuara në mjediset e FSHS. Listën e notave dhe krediteve të fituara apo vërtetime të tjera në lidhje me përparimin akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin të studentit realizohet nëpërmjet ndërveprimit me sekretarinë mësimore të programit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.16.1. Broshurë informative, 3.25. Orare konsultimi me studentë, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se është sekretaria mësimore që informon mbi kriteret e procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme, bazuar në Statutin e UT-së dhe rregulloren e transferimeve, parashikuar në aktet e brendshme rregullues. Informimi bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të FSHS-së si dhe njoftimeve të afishuara në mjediset e fakultetit dhe rrjeteve sociale. FSHS u ofron studentëve mundësi për njohjen e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

67

	<p>krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël, programeve të përafërta, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, etj., duke ndjekur procedurat dhe kriteret e vendosura nga institucioni. Me urdhër të dekanit në Departament e Sociologjisë ngrihet komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i cili miratohet nga Dekani, dhe shqyrton kërkesat e studentit për njohjen e kualifikimeve të mëparshme.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.16.1. Broshurë informative, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se Departamenti i Sociologjisë e realizon informimin e studentëve në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në disa mënyra. Rregullorja e UT, e FSHS dhe Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore, përshkruajnë qartësisht procedurat dhe kriteret për vlerësimin e dijeve të studentëve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, ku përfshihen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimi i tyre e deri te ankimi. Mbështetur në rregulloret e sipërpërmendura, çdo pedagog përcakton në syllabusin e lëndës që harton rregulla apo specifika të provimeve, peshën (përqindjen) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literaturën, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, ditën apo javën e provimit, orën dhe sallën e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve me notë. Të gjitha këto informacione iu përcillen studentëve që ndjekin programin nga vetë pedagogu në auditor gjatë paraqitjes së syllabusit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15), 3.16.1. Broshurë informative, Syllabuset e programit të studimit 108-139, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se rregullorja e UT-së, FSHS, DS parashikojnë qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programet e studimit Master i Shkencave.</p> <p>Për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një punimi diplome bazuar mbi kriteret e miratuara nga DS. Rregullorja e programit të studimit në Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore, specifikon procedurat specifike për paraqitjen e punimit dhe zhvillimin e provimit të diplomës së këtij programi. Sekretaria mësimore, është një tjetër burim i rëndësishëm informacioni, ku studentët mund të drejtohen në lidhje me këto procedura dhe të marrin informacion.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 3.3. Rregullore e Departamentit, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.6.1. Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15)</i></p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se Departamenti i Sociologjisë si njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit në fillim të çdo viti punon intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë duke organizuar disa veprimtari informuese në formën e takimeve të hapura me studentët e diplomuar në ciklin e parë të të studimeve në FSHS dhe më gjerë, ku paraqiten informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qënë të hapur ndaj diskutimeve apo sugjerimeve që mund të shfaqen në këto takime.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15), 3.13 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 3.14 Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 3.16.1. Broshurë informative, Syllabuset e programit të studimit 108-139, www.unitir.edu.al.</i></p>
---	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X


Standardi V.3
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatohet se studentët e Programit Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore nëpërmjet faqes zyrtare web të UT dhe FSHS kanë mundësi që në fillim të çdo viti akademik të përfitojnë informacionin e hollësishëm në lidhje me strukturën e vitit akademik në të cilën detajohet kohëzgjatja e vitit akademik, ndarjen e tij në semestra, periudha e provimeve. Informacioni në web në lidhje me organizimin dhe programet që ofron departamenti, krijon mundësinë për të marrë informacionin e duhur në lidhje me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi.</p> <p>Gjithashtu, që prej regjistrimit dhe fitimit të statusit të studentit e në vazhdim, përgjatë gjithë kohës studentët informohen në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin e programit të studimeve përmes Sekretarisë Mësimore të departamentit.</p> <p>Sipas RVB, Zyra e këshillimit dhe Karrierës realizon takime me studentët, gjatë të cilave i informon në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, lëndët që do të frekuentojnë gjatë një semestri, oraret, klasat e kështu me radhë.</p> <p><i>2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15), 3.16.1. Broshurë informative, Syllabuset e programit të studimit 108-139, rrjeti social Facebook, www.unitir.edu.al.</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës në institucion konstatojmë se UT, FSHS dhe Departamenti i Sociologjisë si njësi bazë, vendosin në dispozicion të studentëve gjithë informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e universitetit dhe të fakultetit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, syllabuset, organizimin e lëndëve, etj. Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme nga studentët në disa rrugë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzues dhe informacione të printuara në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve; • Njoftime dhe udhëzues të shpallur në mjediset e përcaktuara të FSHS (njoftime të ndryshme, oraret e mësimit, oraret e provimeve, etj). • Në format elektronik në website-n e universitetit, i cili është i arritshëm nga të gjithë studentët; në adresa interneti dhe faqe web-i lehtësisht të arritshme per ta. <p>Vendimet e rëndësishme të marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati dhe Departamenti i Sociologjisë në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, të studentëve, rezultatet e analizave të bëra, u bëhen me dije studentëve në forma të ndryshme si, takime të drejtpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të universitetit, njoftimeve në website-n e UT dhe FSHS.</p> <p><i>2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15), 3.16.1. Broshurë informative, Syllabuset e programit të studimit 108-139, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se Personeli akademik i Departamentit të Sociologjisë, Koordinator i programit dhe Zyra e Karrierës u sigurojnë informacione dhe këshillim studentëve në lidhje me mundësitë për trajnime, internship dhe punësim.</p> <p>Këto njësi shërbejnë si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Nga takimi në FSHS me Dekanin dhe anëtarët e DS u evidentua se sfida e fushës është vlerësimi i sociologëve si nevojë në fusha të ndryshme, në administratë dhe</p> <p><i>2.26. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierës 2021, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, 3.16.1. Broshurë informative, 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang programiesh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorët e tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimine lartë (Tabela 5), 3.21.1. Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, internship dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihen në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se UT dhe FSHS disponojnë kapacitete dhe mjete logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe studentët marrin informacion, i cili është lehtësisht i aksesueshëm dhe i plotë në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet strukturave dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit,</p>


<p>shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>qoftë përmes komunikimit verbal dhe zyrtar në faqen web të FSHS, qoftë edhe vizualisht, në mjediset e brendshme dhe të jashtme të FSHS.</p> <p>Studentëve iu vihet në dispozicion user-name dhe password personal për përdorim e sistemit informatik (platforma Microsoft Teams gjatë mësimi online), ku marrin informacionet në lidhje me procesin mësimor: oraret me klasat ku zhvillohen leksionet, njoftimet për zëvendësimet e leksioneve përditësohen vazhdimisht në këtë hapësirë. Ky informacion i plotë dhe i detajuar ofrohet edhe në faqen web e FSHS-së; për më tepër, në mjediset e sekretarisë mësimore të FSHS-së, përpos shërbimeve të tjera për studentët, afishohen të gjitha informacionet e përditësuara. Studentët kanë mundësi të aksesojnë informacion të plotë në lidhje me organizimin e mësimi përmes orarit të afishuar në mjedise të dukshme të FSHS-së.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 2.33 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj)Tabela 17), www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se të gjitha strukturat në funksion të realizimit të programit të studimit, duke filluar që nga strukturat drejtuese dhe personeli akademik i Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale, personeli ndihmësakademik i departamentit, sekretaria mësimore, zyra e informacionit, zyra e karrierës dhe strukturat më të larta drejtuese të fakultetit me studentët janë çdo rast të disponueshëm të lehtësojnë jetën e tyre studentore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 2.33 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj)Tabela 17), www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit përmes platformës “E-student” që përdoret për çështjet akademike të studentëve, si regjistrimi, menaxhimi i studentëve, stafi akademik, degët e studimit, lëndët, syllabuset e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, njoftimet e ndryshme etj. “Microsoft Teams” është një tjetër platformë që përdoret për mësimdhënie. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve kontroll të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 2.33 Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16 Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale/Njësive Bazë, 2.30.1. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online etj)Tabela 17), www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se UT përmes stafit ndihmësakademik, mbështetur në Statutin e vet, disponon dhe mban statistika vjetore mbi: numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi; numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë; tërheqjet e studentëve nga programi; transferimet, ekuivalentimet, largimet, ndërprerjen e përkohshme të frekuentimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, gjatë të cilit zhvillohet programi i studimeve; të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Grupi i ekspertëve konstatoi gjatë vizitës se, bazuar tek Rregullore e UT, Sekretaria Mësimore e FSHS-së, i dispononte këto të dhëna në formë të shkruar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ rregjistrin themeltar të studenteve, ✚ rregjistrin e arritjeve akademike, ✚ rregjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave <p>Në programin Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore për vitin akademik 2019-2020 janë pranuar 10 studente, dhe për vitin akademik 2020-2021 janë pranuar 8 studentë, me rritje nga një vit në tjetrin të treguesit cilësor mesatare e pranimit. Nuk ka të dhëna për transferime, ekuivalente por ka të dhëna për ndërprerje të studimeve për arsye shëndetsore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 4.8. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve(Tabela 21), 4.9. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve(Tabela 23).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se FSHS mbledh të dhëna statistikore që ndodhen në Sekretarinë Mësimore mbështetur në dokumentacionin ligjor të miratuar për këtë tipologji dokumentacioni.</p> <p>Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në rregjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e Universitetit. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të këtyre të dhënave personale të studentëve prej universitetit, kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. FSHS disponon dhe mban statistika vjetore mbi: numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi; numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë; tërheqjet e studentëve nga programi; transferimet, ekuivalentimet, largimet, ndërprerjen e përkohshme të frekuentimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, gjatë të cilit zhvillohet programi i studimeve; të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>

	<p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 4.8. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve(Tabela 21), 4.9. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve(Tabela 23).</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se sistemi informatik, është instrumenti kryesor për dhënie të shërbimeve, duke lehtësuar, siguruar dhe përmirësuar edhe mbarëvajtjen e procedurave në sekretarinë mësimore të FSHS.</p> <p>FSHS mbështetur në rregulloret e miratuara, rregjistron, ruan, përditëson dokumentacionin me të dhënat e studentëve të çdo programi në përputhje me hapësirat ligjore përkatëse, kodin e Etikës dhe respektimit e ruajtjes së privatësisë në administrimin e tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 4.8. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve(Tabela 21), 4.9. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve(Tabela 23).</i></p>		
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se të dhënat statistikore të studentëve në Universitetin e Tiranës, menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, në formë elektronike, por edhe të shkruar. Sistemi informatik jo vetëm siguron ruajtjen e të dhënave duke respektuar privatësinë e të dhënave, por është një mjet efikas komunikimi mes pedagogëve, stafit administrativ dhe studentëve. Sektori i IT-së mundëson që të dhënat të jenë të përdorshme nga studentët elektronikisht, por edhe të printuara, sikurse janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar dhe me interes të veçantë për këto të dhëna. Rregulloret e posaçme rregullojnë kompetencat dhe detyrat e stafit dhe studentëve, duke krijuar lehtësi për marrjen e shërbimeve dhe ruajtjen e të dhënave. Gjithashtu, sektori i IT-së në FSHS, publikon informacionin e konsultuar dhe të nevojshëm, mbi bazën e kërkesave të ndryshme dhe nevojës për njoftime, informacion kundrejt transparencës, duke i bërë kështu edhe studentët pjesë të shpërndarjes së informacioneve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 4.8. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve(Tabela 21), 4.9. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve(Tabela 23), www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se në zbatim të udhëzimit të MASR Nr. 5 datë 19.02.2018, çdo fund viti akademik, FSHS harton raporte vjetore analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, këtë raport e harton çdo departament ashtu edhe Departamenti i Sociologjisë.</p> <p>Në raportin vjetor të universitetit, përfshihen raportet analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si edhe shkalla e cilësisë së punësimit të tyre në njësitë kryesore, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.9. Rregullore e Sekretarisë mësimore 2018, 3.31. Studim i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve, 4.8. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve(Tabela 21), 4.9. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve(Tabela 23), www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se bazuar në përcaktimet e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Statutin e UT-së studentët kanë të drejtë të përfshihen dhe angazhohen në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Në zbatim të Statutit të UT-së, përfaqësimi i studentëve bëhet në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit, në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës me dy anëtarë, nga rradhët e studentëve, Komisionet e përhershme të lejuara me statut, si në Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të marrëdhënieve me studentët, me tre përfaqësues, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, me një përfaqësues, Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, me dy përfaqësues, apo në Këshillat e studentëve me synim mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, njërive bazë dhe kryesore, si edhe konfigurimin korrekt të marrëdhënieve me studentët.</p> <p>Përfaqësimi i studentëve si pjesë e komisioneve të përhershme, apo njërive të tjera kolegjiale të UT dhe FSHS, garanton përfshirjen e tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, sipas akteve ligjore dhe rregullatore të IAL-së. Njëkohësisht studentët e UT-së mund të jenë sipas rastit, anëtarë të komisioneve ad-hoc, të ngritur në nivel Institucioni/Njësie Kryesore/Departamenti. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve, dhe përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse, është konkretizuar në zgjedhjet për anëtar të Bordit të Administrimit të Universitetit, për të cilin votojnë të gjithë studentët.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.21. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion nënvizojmë se Statuti dhe Rregullorja e UT dhe FSHS përcaktojnë se studentët e UT kanë të drejtë që, përmes anketimeve të zhvilluara çdo vit mbi cilësinë e mësimdhënies nga personeli i UT, të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre mbi këto çështje. Rregullorja dhe Statuti i UT, garantojnë që studentët, në mënyrë përfaqësuese të përfshihen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik. Përzgjedhja e përfaqësuesve të studentëve realizohet përmes një procesi transparent, duke filluar me propozimet e kandidatëve dhe votimin dhe nxjerrjen e rezultatit. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtuese si, në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, në Këshillat e Fakulteteve ku janë të regjistruar, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Universitetit. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë, si edhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në universitet, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese</p>

	<p>të universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve, në komisione ad hoc për çështje të veçanta të institucionit.</p> <p>Përmes realizimit të anketimit, konkretizohet e drejta e studentëve për t'u shprehur mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi që ndjekin, si edhe për punën e realizuar nga stafi i FSHS dhe DS. Rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve, pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve që përgatitet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional. Raporti diskutohet më pas në Njësinë Bazë, nga ku dalin sugjerimet konkrete për përmirësimin e gjetjeve të matura.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.11. Manuali i Cilësisë, 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personeli akademik i UT, 1.21. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: Politika për mbështetjen e studentëve dhe strukturat e tyre organizative 2018.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se për hartimin e programit Master i Shkencave në Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore, janë konsultuar programe dhe praktika ndërkombëtare, por dhe plotësimet e vijueshme të legjislacionit.</p> <p>Programi është hapur bazuar në legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet e bëra në kurrikulat mësimore për përmirësimin e programit, janë realizuar duke mbajtur parasysh ndryshimet e bazës ligjore, si dhe përshtatjes së programit të studimit me nevojat e tregut të punës. Në vlerësimin e ngarkesës akademike të studentit janë mbajtur parasysh jo vetëm marrja e informacionit teorik, por edhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë përgjatë semestrit, sipas zërave të vlerësimit të vendosur në programet e lëndëve nga lektorët përkatës, ku përfshihen provimet e ndërmjetme, detyrat apo projektet e kursit dhe angazhimi aktiv në orët e seminareve dhe provimi përfundimtar. Është parashikuar, gjithashtu, edhe lehtësimi i procedurave të ndjekjes së përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të studentëve, si në rastin e procedurave të ekuivalentimit dhe njohjes së lëndëve, të krediteve për studentët që transferohen (vijne nga jashtë universitetit dhe lëvizin brenda Fakultetit të Shkencave Sociale, duke ndryshuar degë), dhe rastet e ripranimit të studentëve me ndryshim planesh mësimore.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.4 Rregullore e FSHS 2016, 2.27: 3.6. Rregullore e programit të studimit, nenet 12 dhe 13, 4.2. Plani i miratuar mësimor i programit të studimit, 4.2.1. Plani mësimor sipas modeli të tabelës 10, 4.2.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese(A-E) (Tabela 9), 4.2.3. Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Tabela 11), 4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentet në institucion konstatohet se Universiteti i Tiranës dhe FSHS në dokumentat bazë të tyre, përkatesisht Statuti dhe Rregullorja, garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta, dhe reflekton kontributin e tyre në to. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UT-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin</p>

	<p>e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.</p> <p>Raporti i Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve përgatitet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional dhe është objekt diskutimi dhe reflektimi në njësinë bazë, lidhur me përfundimet e raportit.</p> <p>Në RVB kjo praktikë pune vlerësohet mjaft pozitive sepse krijon hapësira për ndërveprim dhe konsultim të ndërsjellë ndërmjet palëve të përfshira në procesin e mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulave dhe programeve të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT 2018, nenet 41, 42, 139,141, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.14. Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet, dhe provimet, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësies së Sigurimit të Cilësisë 2017, 2.15. Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave, 2.17. Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel e FSHS. Vendim i Dekanit të FSHS për ngritjen e GVB. 2017, 2022, 3.6. Rregullore e programit të studimit, kreu XIII, 3.23. Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësies/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se Statuti i UT-së dhe Rregullorja parashikojnë të drejtën e studentit për të dhënë mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë këtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit, përfundimin e studimeve, provimet dhe riprovimet, sikurse edhe përfundimin dhe regjistrimin e vlerësimit të studentëve në sistemin informatik, procese këto të rregjistruara në dokumentacionet përkatëse të sekretarisë mësimore</p> <p>Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korrigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korrigjimet e duhura. Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit, i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse Dekani e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rrizhfillimin e provimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngrë një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.</p> <p>Kjo procedurë, krijon mundësinë për studentin për të marrë informacion të plotë dhe të shpejtë për vlerësimin e tij. Nga ana tjetër, sistemi informatik, krijon mundësinë që për çdo ndërhyrje të lihet gjurmë për kohën, apo edhe numrin serial të kompjuterit prej nga është regjistruar vlerësimi. Pas periudhës së parashikuar në rregullore funksionimi i sistemit nuk lejon ndërhyrje pa një procedurë të veçantë të parashikuar në manualin dhe rregulloret e Universitetit.</p>

	<p>Në takim me Grupin e ekspertëve studentët konfirmuan se janë të kënaqur nga korrektesa e marrëdhënieve të krijuara me pedagogët përsa i përket barazisë, ndershmërisë në vlerësim përfshirë edhe të drejtën e ankimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2016, neni 49, 2.28. Informacion për bazën rregullatore të ankimit të studentëve, 3.6. Rregullore e programit të studimit, neni 22 dhe 23, 4.3. Programet mësimore të lëndëve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se personeli akademik merr vazhdimisht pjesë në konferenca apo aktivitete në fushën e kërkimit. Mësimdhënia e Departamentit është e lidhur ngushtë me kërkimin shkencor e reflektuar kjo në realizimin e temave studimore, apo në pervojën e fituar nga pjesëmarrja në konferenca, seminare, leksione të hapura nga ana e stafit akademik. Rezultatet e këtyre veprimtarive bëhen objekt diskutimesh përgjatë orëve në auditor më studentët me qëllim motivimin e tyre për t'u afruar me kërkimin shkencor. si dhe zhvillimi i detyrave të kursit dhe temave të diplomave, ku studentët zhvillojnë aftësitë e tyre mbi metodologjitë e punës në kuadër të kërkimit shkencor.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 1.18. Vendim nr. 36, datë 02.09.2021 "Për miratimin e programit të grantit për prezantimin e një punimi/kërkimi në konferenca ndërkombëtare, 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 2.24 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi, 4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se për realizimin optimal të misionit të tij si në aspektin e përmirësimit të kurrikulave dhe të angazhimit për kërkimin shkencor me profil shoqëror, Departamenti i Sociologjisë zhvillon dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projektin zhvillimin e mëtejshëm të partneriteteve. Është ndër prioritetet strategjike të zhvillimit të programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve zhvillimi i mëtejshëm i partneriteteve me aktorë ndërkombëtarë dhe ndërkombëtarizimi i programit të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 2.24 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi, 4.11.</i></p>

	<i>Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.</i>
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se personeli akademik nxit vazhdimisht studentët të ecin në karrierën akademike dhe universitare përmes botimeve, kërkimeve shkencore dhe angazhimeve të tjera të cilat rrisin mundësitë e tyre për t'u përfshirë në studime dhe kërkime shkencore në hapësirën shqiptare dhe përtej saj.</p> <p>Në sesionet e konferencave shkencore të departamentit dhe në botime të tij gjithmonë një vëmendje e posaçme i kushtohet përfshirjes së studentëve nëpërmjet punimeve të tyre kërkimore</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi (kreu VIII. Aktivizimi i studentëve në veprimtari shkencore).</i></p>
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se në prioritetet strategjike të Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Departamentit të Sociologjisë zë një vend kryesor zhvillimi dhe mbështetja për kërkimin shkencor. Në këtë kuadër institucioni në çdo nivel të tij mbështet publikimin nga stafi akademik në revista shkencore vendase dhe të huaja, e cila dëshmohet në veprimtarinë kërkimore, analizën vjetore të punës dhe aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe institucioni.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.21 Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik, 2.25 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi, 4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se institucioni dhe personeli akademik i motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative, megjithë vështirësitë që mbart ky nivel angazhimi në fushën e studimeve sociologjike. Gjithësesi, vlen qç të theksohet se fryma është shumë mbështetëse dhe nxitëse në këtë plan duke u ofruar vazhdimisht studentëve gjatë dhe pas diplomimit mundësi për angazhime të tilla në nivele kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 2.24 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 3.21.1. Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, internship dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar.</i></p>
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se departamenti i Sociologjisë vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve të programit të studimit në realizimin e punimeve të tyre të diplomës. Pedagogët ndihmojnë studentët me kryerjen e matjeve, analizave në terren apo të dhënave të grumbulluara në forma të tjera kërkimore. Mjediset e fakultetit mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga stafi i departamentit të Sociologjisë për realizimin e detyrimeve akademike dhe kërkimore, apo për hedhjen e të dhënave tabelore, grafike dhe të analizës statistikore, etj. që mund t'i duhet një studenti për të përgatitur temën e tij të diplomës. Departamenti i</p>

	<p>Sociologjisë dhe personeli akademik i angazhuar i asiston studentët për lehtësimin e kryerjes së matjeve, analizave, testeve, në mjediset e institucionit apo jashtë tij, në bazë të temave dhe fushës së studimit sipas përcaktimeve në rregulloren e përgatitjes së punimit të diplomës.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT; 2.4 Rregullore e FSHS, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.6.1. Rregullore për diplomat e ciklit të dytë.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se Universiteti i Tiranës dhe njësitë përbërëse të tij në strategjinë e zhvillimit të tyre kanë në fokus të veçantë dhe prioritet zhvillimin e partneriteteve dhe të bashkëpunimeve me organizma shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë me qëllim rritjen e mobilitetit të stafit dhe studentëve.</p> <p>UT, FSHS, DS për realizimin e prioritetit strategjik të zhvillimit të bashkëpunimeve me organizma shkencorë dhe të rritjes së mobilitetit kanë realizuar një sërë marrëveshesh në nivel IAL, njësie kryesore dhe njësie bazë që kanë sjellë bashkëpunim me institucione/njësi homologe dhe mundësi mobiliteti, veçanërisht në kuadër të programit të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022; 1.2. Statuti i UT, 1.3. Rregullore e UT, 1.4. Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës (2018-2023), 2.3. Strategjia e zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit (të Sociologjisë). 2.24. Politika e FSHS për bashkëpunimin dhe partneritetin 2019, 2.25 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studenteve, 3.21. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang programesh studimi për praktikant profesional me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorët e tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), 3.21.2. Draft marrëveshje bashkëpunimi me University of Southern Denmark.</i></p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se kurrikula e programit të studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” është konceptuar si një kurrikul formuese që adreson në mënyrë të konsoliduar formimin e studentit për të qënë i suksesshëm në kryerjen e ciklit të tretë të studimeve. Të gjitha modulet dhe programet lëndore, të cilat frekuentohen nga studentët përgjatë ndjekjes së këtij program studimi, kanë një impakt të dukshëm në zhvillimin e kompetencave për të kryer kërkime shkencore dhe për të ndihmuar në implementimin e projekteve të ndyshme me ndikim në kontekstin komunitar të shoqërisë shqiptare apo edhe më gjerë, për të qënë konkurrues në tregun e</p>

	<p>studiuesve ndërkombëtarë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 3.6. Rregullore e programit të studimit, 3.6.1. Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve, 4.3. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se në strategjinë e Departamentit të Sociologjisë është e rëndësishme nxitja dhe përfshirja e studentëve dhe kërkuesve të rinj në kërkime dhe projekte kërkimore vendase dhe të huaja.</p> <p>Për këtë në praktikën e punës me studentët FSHS dhe Departamenti i Sociologjisë jo vetëm që mbështet dhe inkurajon pjesëmarrje të tilla, por edhe pas diplomimit ofron mundësi dhe informacion për angazhime në projekte të ndryshme.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.21.1. Tabelë përmbledhëse me trajnime, konkurse, praktika profesionale, internship dhe mundësi punësimi për studentët e diplomuar, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi (2018-2023), 4.11. Të dhëna për aktivitetet për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit, por edhe në kontekstin e rritjes së ndërveprimit dhe shkëmbimit me kërkuesit e huaj, vazhdimisht fakulteti dhe departamenti realizojnë aktivitete me pjesëmarrje të ekspertëve të huaj. Aktivitete të tilla shihen si një mundësi për të krijuar ura të reja bashkëpunimi, por edhe për të krijuar një përfaqëse integruese të personelit akademik dhe studentëve me kërkuesit e huaj dhe institucionet e tyre. Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj i mbajtur nga Departamenti i Sociologjisë shkon mbi 15. Gjithashtu, personeli akademik efektiv i Departamentit të Sociologjisë që është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit “Master i shkencave” në “Sociologji e zhvillimeve shoqërore” ka marrë pjesë në aktivitete të tjera shkencore jashtë vendit, të cilat ndihmojnë në realizimin e strategjisë së integritit të komunitetit shkencor vendas me kërkuesit shkencorë të huaj.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se institucioni ka ndjekur një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve duke lidhur marrëveshje bilaterale dhe marrëveshje në kuadër të programit Erasmus + që favorizojnë mobilitetin dhe duke krijuar praktikat më të mira të njohjes së periudhave të shkëmbimit dhe të ekuivalentimit të tyre. Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme për oportunitete shkëmbimi dhe mobiliteti në aktivitete dhe në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit elektronik si faqja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Faqja e Universitetit të Tiranës si dhe rrjetet sociale të Universitetit, fakultetit dhe Departamentit</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZHSH 2022, 2.25 Politika e FSHS për mobilitetin e personelit dhe të studentëve, , www.unitir.edu.al.</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fiton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se FSHS prirët që në bashkëpunim me departamentin të krijojë një mjedis ndërveprimi multinacional edhe në mjediset e punës së përditshme nëpërmjet veprimtarive dhe aktiviteteve ndërkombëtare të zhvilluara në mjediset e FSHS si pjesëmarrja në trajnime, leksione të hapura, workshope, konferenca etj., me pjesëmarrje të ekspertëve dhe lektorëve të huaj. Departamenti i Sociologjisë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e OSCE dhe te ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Republikën e Shqipërisë në datat 14-16 dhjetor 2021, kanë mbajtur leksione/seminare mbi tema me rëndësi në kuadër të temës kryesore Drejtësi tranzitore; gjithashtu nëpërmjet skemave të programeve ndërkombëtare të mobilitetit dhe shkëmbimit institucioni ofron një sërë oportunitetesh për mobilitetin e studentëve për t'u angazhuar në aktivitete ndërkombëtare.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB i MSHSZSH 2022, 3.24. Dosje e leksioneve/aktiviteteve/konferencave të hapura, 4.6. Veprimtaria kërkimore në nivel programi, www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>
<p>Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>			
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>		
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vlerësojmë se Universiteti i Tiranës ka ngritur një sistem funksional informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurë në lidhje me veprimtari të ndryshme në kuadër të procesit mësimor. FSHS ofron shërbimin e informacionit për studentët përmes njësive të Karrierës dhe Zyrës së Informacionit dhe kjo veprimtari e njësive të Këshillimit dhe Karrierës realizohet në përputhje me statutin e UT. Faqja zyrtare e webit pasqyron të gjitha aktivitetet që zhvillohen në FSHS e si edhe nga departamenti i Sociologjisë dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta edhe në kuadër të programit të transparencës. Institucioni është mjaft aktiv dhe në rrjetet sociale. Institucioni përdor për komunikimin e brendshëm e-maillet zyrtare dhe platformën Microsoft Teams.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2016, 2.16. Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit, 2.26. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021, www.unitir.edu.al.</i></p>		
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se në Universitetin e Tiranës funksionon një njësi e posaçme e informimit të studentëve dhe publikut në tërësi përmes Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët dhe Marrëdhënieve me Publikun. Informacioni i nevojshëm publikohet në formë të ndryshme: në formën</p>		

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave etj, të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve. Në FSHS nëpërmjet ekraneve të instaluar afishohen në mënyrë të vazhdueshme informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin akademik dhe njoftime të tjera të fakultetit. Po ashtu, faqja zyrtare e fakultetit pasurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe publikohen informacione të nevojshme në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe programin e transparencës që FSHS zbaton.</p> <p>Për t'u ardhur në ndihmë studentëve të rinj FSHS dhe DS përditëson dhe publikon materiale dhe broshura informative, të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme për programin e studimit, infrastrukturën, personelin akademik, jetën studentore, dhe mjaft informacione të vlefshme për studentët dhe përfshirjen e tyre në veprimtaritë në Fakultet. Stafit akademik në funksion të ofrimit të asistencës së vazhdueshme për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në dispozicion të studentëve, ofron dhe shpall edhe orarin e takimeve/konsultimeve në zyrë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2016, 2.16. Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit, 3.25. Orare konsultimi me studentë, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se Fakulteti i Shkencave Sociale ka funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe mbështetjen e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, me strukturat e ngritura si shërbimi ndaj studentit, koordinatori i programit, etj. FSHS nëpërmjet njësive së Këshillimit të Karrierës ofron në mënyrë të vazhdueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✿ -Këshillim karriere ✿ -Informacion mbi vende pune ✿ -Informacion mbi praktikën profesionale ✿ -Informacion në lidhje me trajnime dhe workshop <p>Specialistja e Këshillimit të Karrierës është në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premte, në orarin 8.00- 16:30</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.10 Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënies, dhe provimit, 2.26. Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës 2021, 3.21. Institucionet e dhe Organizata bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetive biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve me studentët në institucion konstatohet se njësia e Këshillimit të Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit MSHSZHSH dhe ua vë në dispozicion ato studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese sipas nevojës. Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore mban kontakte me studentët e diplomuar përmes email-it, numrave të kontaktit përmes telefonit dhe rrjeteve sociale dhe përpunon të dhënat për punësimin e tyre dhe i paraqet në formën e relacioneve rregullisht. Gjithashtu GVJ konstatoi se</p>



	FSHS paraqet informacione për veprimtaritë e zhvilluara me Alumni, publikon të dhëna për Alumni dhe Formularin e Alumnit. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 2.25 Rregullore e shërbimit të karrierës, 3.31. Studim i tregut në lidhje me statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve, 4.9. Të dhëna për diplomimin e punësimit të studentëve (Tabela 23).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	Përbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	Përbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatohet se UT e përcakton Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Universiteti i Tiranës, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 dhe Statutit të UT si dhe në përmbushje të misionit të tij, përpaket sigurojë për stafin dhe studentët shërbime cilësore në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë. Për këtë qëllim UT po punon për të ngritur e konsoliduar një sistem efektiv të sigurimit të cilësisë, i cili udhëheq veprimtarinë akademike dhe funksionet administrative në institucion.</p> <p>Në përputhje me detyrimin ligjor, institucioni ka hartuar politika dhe dokumentat përkatëse, të cilat kanë gjetur zbatim përmes procedurave dhe instrumentave transparente të rëndësishme, për të drejtuar dhe orientuar punën e strukturave të posaçme edhe me pjesëmarrjen e studentëve, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Vlerësimi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i përgjithshëm ose pjesor, kryhet jo më pak se një herë në gjashtë vite, por mund të kryhet edhe më shpesh, nëse shihet e arsyeshme.</p> <p>Më konkretisht, në Statutin e Universitetit të Tiranës parashtrohet se Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni, përmes ngritjes së strukturave</p>

	<p>dhe funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Statuti parashikon ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Sigurimit të Cilësisë në nivel Institucioni dhe Njësie Kryesore, ku pasqyrohen në mënyrë të hollësishme mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve detyrat dhe përgjegjësitë. Politikat e ngritura prej institucionit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, realizohen nëpërmjet një sërë instrumentash që parashikohen në Rregulloret e Institucionit. Referuar këtyre dokumentave, janë parashikuar strukturat, parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe ngritja në njësitë kryesore të UT dhe funksionimi i Njësive të Vlerësimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJVSBC), përbërja e të cilave përcaktohet nga vetë njësitë kryesore dhe duhet të përfshijë edhe përfaqësues të studentëve. Në rregulloret e institucionit parashikohen politikat e nevojshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentash.</p> <p>Mbështetur në Planin Strategjik të UT dhe Strategjinë e FSHS dhe DS për përmirësimin e cilësisë në të gjitha veprimtaritë që universiteti kryen, politikat dhe masat operative që propozohen si pjesë e kësaj strategjie, e drejtojnë UT, e për rrjedhojë edhe FSHS dhe DS, në mënyrë të qëndrueshme, në përmbushjen e objektivave të përcaktuara si dhe hartimin e objektivave të reja në përputhje me dinamikat e zhvillimit të UT.</p> <p>Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme organet kolegjiale të institucionit, kanë miratuar procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku përshkruhet në mënyrë të hollësishme procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizës së rezultateve të pyetësoreve, deri tek plani i masave, që propozohet për përmirësimin, vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë jetës studentore në UT, FSHS dhe DS, prej strukturave mbështetëse për programet e studimit, vlerësimin e performancës akademike të stafit me kohë të plotë e të pjesshme si dhe personelit ndihmësakademik, sipas Vendimit Nr.51, datë 23.12.2020, "Për miratimin e paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës". Faqja zyrtare e webit pasqyron me transparencë çdo veprimtari që zhvillohet në FSHS dhe në Departamentin e Sociologjisë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 2.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësive të Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS 2020, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë UT ka ngritur strukturat e nevojshme në nivel institucioni e fakulteti, në të cilat garantohet përfshirja e stafit dhe studentëve. Në rrugën e konsolidimit si struktura të reja, ato janë në proces përmirësimi, përpilimi të rregulloreve. Krijimi dhe vijmësia e punës, në zbatim të këtyre dokumenteve, përbëjnë njëkohësisht edhe një prej objektivave strategjikë të Universitetit dhe për rrjedhojë edhe të FSHS. Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, me përbërje personel ndihmësakademik, një drejtor, një përgjegjës dhe 2 specialistë.</p> <p>NJSBC e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, gjithashtu Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave</p>

	<p>Nr.531, datë 11.09.2018, Manualin për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, Statutin e UT-së, në vendime të Senatit, etj. NJSBC ka hartuar Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, si dhe në përputhje me këtë kuadër ligjor dhe administrativ janë ngritur Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni. Për rrjedhojë në Fakultetin e Shkencave Sociale është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FSHS, veprimtaria e të cilës ka qenë e fokusuar, para së gjithash, në hartimin e planit të masave për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Kjo njësi ka prodhuar dokumente që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë së brendshme dhe analizat përkatëse.</p> <p>Gjithashtu studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim opinion i tyre mbi programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin janë një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike/ ndihmësakademik dhe programeve mësimore që ofron UT.</p> <p>Në komisionet e përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni studentët përfaqësohen me një anëtar në çdo komision. Ata, gjithashtu, janë anëtarë në komisione të ndryshme ad-hoc, të ngritura me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumentave për sigurimin e cilësisë në UT.</p> <p>Për më tepër, si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nepermjet organizimit të tryezave të rumbullakta, në aktivitete të rëndësishme dhe të dobishme, për trajnimin profesional të stafit ndihmësakademik, administrativ, studentëve. Për këtë bashkëpunim ka punuar Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës dhe Qendra për Drejtësi dhe Transformim në kuadër të UT. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është përmirësimi i kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës, nëpërmjet ndarjes së përvojave me të gjithë aktorët bashkëpunëtorë të përfshirë në to.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.11. Manuali i Cilësisë, 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personeli akademik i UT, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS 2020, 2.17. Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel e FSHS. Vendim i Dekanit të FSHS për ngritjen e GVB. 2017, 2022, www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se dy prej instrumentave kryesorë për sigurimin e cilësisë në UT janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i Programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për çdo IAL sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015.</p> <p>Në vitin 2018, Universiteti i Tiranës realizoi vlerësimin e jashtëm institucional me qëllim përcaktimin e shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, që ka hyrë në fuqi në vitin 2011. Grupi i vlerësimit të jashtëm ishte i përbërë prej ekspertëve të huaj dhe vendas. Procesi i akreditimit të parë institucional të UT-së përfundoi me vlerësimin përfudimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 1 (një) vit akademik.</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të cilësisë, pas përfundimit të procesit të akreditimit, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej GVJ, me Vendim të Senatit Akademik, është miratuar grupi i punës për përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej Bordit të Akreditimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.3: Rregullore e UT, 2016, 1.14. Paketa e instrumentave të cilësisë, 1.14.1.Vendim Senati Akademik për</i></p>

	<p><i>miratimin e paketës së dokumentave të sigurimit të cilësisë në Universitetin e Tiranës, 1.19. Certifikatë e akreditimit institucional të UT-së, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC), 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.23. Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.32. Model formulari i raportimit të kërkimit shkencor për personelin akademik,</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se Universiteti i Tiranës me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka ndjekur një politikë të qartë dhe zbaton procedura periodike. Në Statutin e UT përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen; edhe në rregulloren e UT parashikohen instrumentat e kërkimit dhe procedurat, që duhet të ndjekë institucioni, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet një sërë instrumentash.</p> <p>Gjithashtu në mënyrë periodike, nëpërmjet NJSBC, në përfundim të çdo semestri akademik, para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies, për lëndët e çdo programi studimi. Për këtë qëllim me vendim të Senatit Akademik është miratuar edhe procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizës të rezultateve të pyetësoreve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p> <p>Qëllimi i këtyre politikave dhe procedurave ka qenë dhe është krijimi i kulturës së cilësisë në nivel institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit duke garantuar përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm të UT-së në këtë politikë dhe në këto procedura.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.11. Manuali i Cilësisë, 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personeli akademik i UT, 2.12 Vendim i FSHS për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë 2017, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e sigurimit të cilësisë FSHS, 2.15 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave, 2.16 Politika e FSHS e publikimit të informacionit të sigurimit të cilësisë, informacioneve për programet e studimit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se UT ka ngritur struktura/sectorë me qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit. Njësia kryesore që realizon Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përmes strukturës së posaçme për</p>

	<p>monitorimin dhe mbështetjen e programeve mësimorë në nivel institucioni, pjesë e strukturës organizative të UT është Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, me sektorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori i Kurrikulave • Sektori i Sigurimit të Cilësisë <p>Përgjegjësia e kësaj strukture ka të bëjë me ndjekjen dhe zbatimin e bazës ligjore në fuqi që nga hapja, riorganizimi apo mbyllja e programeve të studimit. Gjithashtu, në nivel institucioni dhe njësie kryesore, janë parashikuar ngritja dhe funksionimi i Komisioneve të Përhershme si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (me tej KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm të Kurrikulës (me tej KPK).</p> <p>Për më tepër, në nivel fakulteti, zv.Dekanët për anën akademike, kanë detyrë që në bashkëpunim me dekanatin e fakultetit të mbështesin dhe orientojnë politikën për zhvillimin e monitorimin e programeve të studimit që ofrohen prej Fakultetit të Shkencave Sociale. Gjithsesi, Departamenti i Sociologjisë është njësi bazë, që realizon programin e studimit MSHSZSHSH në bashkëpunim me të gjitha strukturat që monitorojnë dhe mbikqyrin programet e studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.15 Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave, 3.6 Rregullore e programit të studimit, 3.11. Vendim për caktimin e koordinatorit të programit, 3.15. Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se UT përdor mekanizma dhe procese formale dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vijueshëm të programeve të studimit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë përbërësit e tij • Raportin e analizës së kërkimit me të gjithë përbërësit e vlerësimit të tij <p>Në DS procedura për ndryshime në programet e studimit, planet mësimore apo syllabuse, miratime të programeve të studimit, kjo ndodh edhe për MSHSZSHSH, bëhet referuar ndryshimeve në bazën ligjore (ndryshime në ligj, VKM, urdhëra, udhëzime prej MASR), apo ndryshime në përshtatje me kohën dhe kërkesat e tregut të punës, e kështu veprohet edhe për programin e studimit MSHSZSHSH.</p> <p>Në shërbim të procesit të përmirësimit të programeve të studimit të ciklit të dytë shërben pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, që realizohet në përfundim të çdo semestrit të vitit akademik, para sezonit të provimeve. Në përfundim të tij, hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.14.Paketa e instrumentave të cilësisë, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se në FSHS dhe DS, nga Njësia e Vlerësimit dhe Sigurimit të Cilësisë, e ngritur me vendim të Dekanatit të FSHS është zhvilluar anketimi i studentëve për procesin e vlerësimit të pedagogëve të jashtëm, duke filluar nga semestri i dytë i vitit akademik 2019-2020, me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, si dhe matjen dhe vlerësimin e mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikën më të mira. Metodologjia e studimit ka qenë sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësori, i miratuar me Vendim të Senatit Akademik i paraqitur në Paketën e Instrumenteve të Sigurimit të</p>

	<p>Cilësise. Pyetësi është i përbërë nga pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura. Opinione të studentëve mbi pyetjet e hapura janë dhënë për çdo pedagog që ka dhënë mësim në programin e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19, pyetësi është shpërndarë dhe administruar përmes platformës Microsoft Teams, ku edhe zhvillohej procesi mësimor online. Pjesëmarrës në studim kanë qenë të gjithë studentët, të cilët kanë ndjekur programin e studimit Master i Shkencave në Sociologji e zhvillimeve shoqërore, të cilët kanë një llogari personale në sistemin elektronik të Universitetit dhe që kanë frekuentuar qoftë dhe një lëndë të vetme përgjatë vitit akademik. Një student vlerëson të gjitha lëndët ku ka marrë pjesë gjatë vitit akademik.</p> <p>Raporti i Analizës së Pyetësorit, në vitin akademik 2020-2021, përpos përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura të pyetësorit, synonte gjithashtu edhe realizimin e një analize krahasuese, midis përgjigjeve të studentëve në lëndë të ndryshme brenda të njëjtës pyetje, sikurse edhe midis rezultateve të vitit akademik 2020-2021, në raport me një vit më parë, duke evidentuar ato pyetje ku ka ndryshime të dukshme. Rezultatet e këtij pyetësi shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>UT ka krijuar dokumente me qëllim vlerësimin e stafit akademik, të cilat gjejnë zbatimin e duhur përmes Manualit të Vlerësimit të Performancës së Stafit Akademik të UT-së, e miratuar në vitin 2021 nga Senati i UT-së, që shërben si instrument potencial, për sigurimin e cilësisë brenda UT-së</p> <p>UT-ja në zbatim të dokumentit të sipërcituar, çdo vit realizon vlerësimin e performancës së personelit akademik dhe ndihmësakademik e administrativ në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe fakultetet sipas formatit të miratuar me vendim të Senatit të UT.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, 1.11. Manuali i Cilësisë, 1.14. Paketa e instrumentave të cilësisë, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC), www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se duke u nisur nga procedura e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UT, FSHS, DS, miratuar me Vendim Senati Nr. 30.datë 22.07.2021, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, përmes Sektorit të Sigurimit të Cilësisë, përpos raportit të analizës, përpilon dhe projektpropozimet dhe ; rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke i përcjellë me tej pranë strukturave përkatëse, procedura këto të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion konstatojmë se raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej DKSC-së, ju përcillen Njësitë Kryesore, të cilat realizojnë më tej një konsultim të gjerë në çdo departament, me stafin akademik, duke e bërë të gjithë procesin e përmirësimit të programit të studimit, nëpërmjet pyetësorit të studentëve transparent dhe gjithëpërfshirës.</p> <p>Njësitë kryesore dhe bazë diskutojnë rezultatet respektive, duke dhënë propozime përkatëse, të cilat diskutohen në mbledhjen e Rektoratit. Në Rektorat përpilohet plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe</p>

	<p>mësimdhënien, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit procedurë që është qartësisht e parashikuar dhe miratuar përmes vendimeve të Senatit të UT-së</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vëmë në dukje se FSHS në funksion të zhvillimit dhe ecurisë së programeve të studimit, si dhe diplomimit të studentëve, ka hartuar dokumente referues. Duke marrë në konsideratë kontekstin e procesit të akreditimit në Universitetin e Tiranës, Raporti i Vetëvlerësimit i përpiluar prej Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në nivel institucioni ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për NJSBC dhe strukturat e institucionit të angazhuara në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Për më tepër çdo fund viti akademik Universiteti i Tiranës, përpilon Raportin Vjetor sipas Udhëzimit Nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. Në këtë raport pasqyrohet veprimtaria institucionale duke realizuar një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. Kjo analizë e hollësishme, është një pikë referimi kyçe, për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet dhe kriteret ligjore, si dhe për të evidentuar mangësitë dhe masat që duhet të ndërmerren për ndreqjen e tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC), 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.23. Raportet e sigurimit të cilësisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-202.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokmumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion gjejmë se në kuadër të politikave, dokumenteve bazë të Universitetit të Tiranës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, si dhe instrumentave përkatës si monitorimi dhe vlerësimi periodik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në sektorin përkatës të Sigurimit të Cilësisë, përpilon raportin e analizës së pyetësorëve, i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport, shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë</p>

	<p>kryesore dhe bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.14. Paketa e instrumentave të cilësisë.</i></p>						
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion evidentojmë se referuar natyrës së programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore” në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së këtij programi studimi, janë përdorur disa metoda të drejtpërdrejta si testime të standardizuara, vlerësimi i punëve të pavarura, dëgjimi i studentëve në auditor, vëzhgime, me synim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës në mstitucione</p> <p>Në fillim të vitit akademik në DS, Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit, kontrollojnë dhe vlerëson përmbytjen e kurrikulave, syllabuseve etj. Në syllabuse pasqyrohen edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tij. Realizimi fizik i leksioneve dhe seminareve ka mekanizëm kontrolli në FSHS, për të siguruar realizimin maksimal të programit të planifikuar nga stafi i brendshëm dhe i jashtëm në FSHS. Të gjitha këto çështje diskutohen në departament dhe në fund të procesit të diskutimit, çdo anëtar i stafit të brendshëm, harton dhe nënshkruan marrëveshjen me përgjegjësin e departamentit, për shpërndarjen e punës dhe ngarkesave vjetore në auditor dhe jashtë tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 3.12. Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15), 4.3. Programet mësimore të lëndëve.</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vëmë në dukje se UT ka të dhëna mbi shpërndarjen e të diplomuarve, por edhe profilin gjeografik të studentëve aktualë, të shndërruar në profesionistë kërkues dhe aplikues, përfitues të vendeve të punës pas përfundimit të studimeve të nivelit të dytë.</p> <p>UT, FSHS dhe DS kanë zhvilluar metoda të tërthorta të vlerësimit, si sondazhe të vlerësimit nga studentë që aktualisht ndjekin studimet, si dhe sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies me seksione të veçanta..</p> <p>Nga takimi me stafin e DS, në funksion të MSHSZSHSH mendohet se ka nevojë të njihen më mirë nevojat e tregut të punës për profesionistë, shpërndarja gjeografike e tyre, për të krijuar një bazë të vlefshme, që do të justifikojë dhe mbështetë planifikimet që departamenti bën lidhur me kuotat e pranimit, angazhimin e stafit të brendshëm e të jashtëm në realizimin e planit mësimor. Informacioni i përpunuar nga Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit, Zyra e Karrierës, mbështetë në dokumentat bazë të FSHS. Statistikat mbi punësimin e studentëve dhe lloji i punës dhe karriera e tyre, janë një tregues mbi cilësinë e programeve të studimit të ofruar prej FSHS.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.14. Paketa e instrumentave të cilësisë, 4.9. Të dhëna për diplomimin e punësimin e studentëve (Tabela 23). Shënime nga takimi me stafin DS.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="598 1713 742 1825">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="742 1713 965 1825">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="965 1713 1492 1825">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="598 1825 742 1870"></td> <td data-bbox="742 1825 965 1870"></td> <td data-bbox="965 1825 1492 1870" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4



Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Zbatimi i politikave përmes procedurave korrekte, i jep mundësi UT, FSHS dhe DS që të krijojë më shumë partneritete të dobishme që ndikojnë dhe nxitin përbushjen e objektivave startegjikë sipas fushave, promovimin më të mirë të UT dhe FSHS, nga ku përfiton edhe programi MSHSZHSH, duke treguar përgjegjësi sociale para shoqërisë shqiptare. DS bashkëpunon për realizimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve si dëshmi e bashkëpunimit me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm për rritjen e cilësisë.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2018, 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, 1.11. Manuali i Cilësisë, 2.14 Rregullore e NJSC të FSHS 2020.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023 përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera, të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, më së pari komisioni i NJSBC-së në fakultet, i cili duhet të krijojë kulturën e arritjes dhe ruajtjes së cilësisë së lartë akademike përmes vlerësimit të programeve të studimit në marrëdhënie me standardet e cilësisë. Pjesë e këtyre proceseve janë edhe procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e NJVSC-së në UT dhe FSHS edhe në lidhje me programin MSHSZHSH.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.2: Statuti i UT, 2.13 Përshkrim i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, 2.14 Rregullore e NJSC të FSHS 2020.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se plotësimi i këtij kriteri parashikohet me ngritjen në nivel fakulteti, të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në të cilin përpos stafit akademik të brendshëm, ka edhe përfaqësues studentor (një student). Pedagogë dhe studentë nga Departamenti i Sociologjisë janë përfshirë në vlerësimin e sigurimin e cilësisë së programit të studimit, si për shembull grupi i punës për vlerësimin e brendshëm të programit, i cili propozohet nga njësia bazë dhe miratohet nga Dekani.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.17. Të dhëna tabelore për njësinë, individët, studentët e angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel e FSHS. Vendim i Dekanit të FSHS për ngritjen e GVB. 2017, 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se vlerat që karakterizojnë veprimtarinë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë: Integriteti, që do të thotë ndershmëri, objektivitet, aftësi, shmangie e konfliktit të interesave në ushtrimin e veprimtarisë.</p>

<p>çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Pavarësia dhe Objektiviteti, që do të thotë pavarësi në ushtrimin e veprimtarisë dhe dhënien e opinioneve e gjyqimeve objektive. Profesionalizmi, që do të thotë zbatim i standardeve profesionale me kujdesin e duhur profesional dhe korrektësi, mbështetur në metodologjitë dhe praktikat më të mira, si ato të universiteteve përëndimore. Komunikim dhe Informim, që do të thotë komunikim korrekt, objektiv, të qartë, konciz dhe konstruktiv gjate veprimtarisë së saj. Vlera të tilla garantohen nëpërmjet akteve rregullatore të njësive të sigurimit të cilësisë, duke siguruar në qasjen e tyre themelore përmirësimin në funksion të rritjes së cilësisë. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT, 1.7: Rregullore për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT, 1.11. Manuali i Cilësisë, 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personeli akademik i UT, 2.14 Rregullore e NJSC të FSHS 2020.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se pjesë të vlerësimit dhe e sigurimit të brendshëm bëhen edhe nga ekspertë të jashtëm, kryesisht nga personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie të programit duke dhënë ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Në kuadër të bashkëpunimeve me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ose edhe me ekspertë të organizmave të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë, në mënyrë të vazhdueshme realizohen shkëmbime përvojash dhe vlerësimesh nëpërmjet forumeve të ndryshme të diskutimit në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij. <i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.21. Institucionet e dhe Organizata bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetive biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5).</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.5</p>	
<p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se Universiteti i Tiranës, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike të Universitetit (Statuti, vendime të Senatit Akademik, vendime të Bordit të Administrimit, raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj), si dhe nëpërmjet dokumentave zyrtare tek të gjitha Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, duke kontribuar</p>

	<p>në krijimin e një institucioni të arsimit të lartë bashkëkohor, të hapur e transparent, me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij për programin MSHSZHSH, por edhe për DS, FSHS dhe UT</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.21. Institucionet e dhe Organizata bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetive biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5), www.unitir.edu.al.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” ky standard vjen i përmbushur nga FSHS kundrejt çështjes, përmes raportit të analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, për çdo lëndë të çdo programi studimi. Informacioni i publikuar në raport, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Raporti publikohet në nivel Njësie Kryesore, si një përmbledhje e përpunuar e raporteve përkatëse të çdo departamenti. Në zbatim të ligjit, UT-ja ka ndërmarrë dhe hartuar një sërë dokumentesh, instrumentesh, procedurash, për të përmbushur detyrimin e konfidencialitetit dhe ruajtjes së të dhënave personale brenda institucionit dhe Njësive Kryesore dhe të drejtës për publikimin e tyre.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 1.. Rregullore e Universitetit të Tiranës për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës, 1.9. Privatësia në UT, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.21. Institucionet e dhe Organizata bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetive biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5)</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumetacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se sipas Procedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin e Tiranës, NJSBC, përpos Raportit të Analizës, përpilon dhe projektpropozimet dhe rekomandimet hardcopy dhe elektronike për përmirësimin e cilësisë, duke i përcjellë më tej, pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Në përfundim të zbatimit të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e sipërcituar, përpilohet Plani i Masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Programet e Studimit dhe Mësimdhënien, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. Pas miratimit prej këtij të fundit, Plani i Masave, publikohet në faqen UT-se, FSHS-së dhe monitorohet zbatimi i tij.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC, 3.18. Raporti vjetor i punës së departamentit të sociologjisë 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021, 3.21. Institucionet e dhe Organizata</i></p>

	<i>bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetive biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5)</i>		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se Fakulteti i Shkencave Sociale si dhe departamenti i Sociologjisë kanë strategji të qartë dhe disponojnë instrumentat e duhura efektivë për vlerësimin e vazhdueshme të cilësisë në të gjitha aspektet e veprimtarive në kuadër të programit të studimit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Evidentohet se në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë por dhe në rastin e akreditimit të programeve, dhe me synim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, institucioni e përfshin këtë informacion në vetvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të gjitha hallkat institucionale ndërveprojnë me me sukses me njëra tjetrën.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2018-2023, 2.18. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2019-2020, 2020-2021, 2.19. Raport periodik i NJSBC(ose raport vjetor i NJSBC, 3.2. Strategjia e zhvillimit të Departamentit (të Sociologjisë).</i></p>		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>Nga shqyrtimi i RVB, dokumentacionit në dispozicion të GVJ dhe vizitës e takimeve në institucion vërejmë se për ngritjen e kulturës së cilësisë, Institucioni dhe Njësia Kryesore, në përmbushje të procedurës, organizojnë aktivitete dhe seminare informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes të vetëdijshme në procesin e përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion (si për shembull plotësimi i pyetësorëve, pjesëmarrja në Sondazh Kombëtar për Studentët, etj. Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti në vijimësi u mundëson, në mënyrë periodike studentëve dhe personelit shprehjen e opinionëve lidhur me procesin mësimor me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>Ref. dokumentave të atashuar: 1. RVB, www.unitir.edu.al, rrjeti social Facebook.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Drejtimi dhe organizimi i programit të studimit tek proceset sociologjike të zhvillimit të shoqërisë në ndikimin e faktorëve të rëndësishëm socialë në kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimit “ Sociologji e zhvillimeve shoqërore” i nivelit të dytë Master i shkencave me orientimin e tij mbështet dhe reflekton interesin dhe vlerat kombëtare.
2. Personeli akademik i formuar profesionalisht, me përvojë dhe me kualifikim shkencor është një mbështetje e mirë për realizimin me cilësi të këtij programi studimi.
3. Botimet: tekste universitare, monografi, revista shkencore, përmbledhje studimesh si dhe literaturë në shqip dhe gjuhët e huaja vihen në shërbim të formimit akademik të studentëve
4. Universiteti i Tiranës përfaqëson markën më të njohur dhe më të kërkuar në nivelin universitar dhe pasuniversitar për arsye se përfaqëson IAL e parë në Shqipëri, më të hershëm nga përvoja, tradita dhe cilësia që ka krijuar.
5. Fakulteti i Shkencave Sociale përfaqëson një institucion me shumë rëndësi universitare, akademike dhe kërkimore shkencore në fushën e Shkencave Sociale.
6. Departamenti i Sociologjisë është departamenti i parë në fushën e Sociologjisë në Shqipëri, me shumë përvojë dhe arritje akademike dhe shkencore, me nivele të admirueshme në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe mbështetje më e qëndrueshme afatgjatë për zhvillimin e shkencës së Sociologjisë në Shqipëri.
7. Programi i studimit Master i Shkencave në Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore ka krijuar traditë, qëndrueshmëri dhe konsolidim në arritjet e veta.
8. Programi i studimit Master i Shkencave në Sociologji e Zhvillimeve Shoqërore u mundëson studentëve të vazhdojnë me realizimin e ciklit të tretë të doktoratës.

Pika të dobta

1. Angazhimi i departamentit në “Projektet Ndërkombëtare” nuk ka qënë i mjaftueshëm për të rritur pjesëmarrjen e studentëve dhe mobilitetin e tyre në këto projekte. **(Standardi III,10,faqe 52)**

Rekomandime

1. Studimi më i thelluar i oportuniteteve që ka tregu i punës në nivel kombëtar e rajonal për studentët e këtij programi duke realizuar edhe ndryshime përmirësuese të kurikulës së studimit, që mund të rritë atraktivitetin e këtij programi.

2. Në aspektin e përmirësimeve kurrikulare, të mbështetjes në vijueshmëri të interesave kombëtare, të shpjegimit dhe të njohjes së proceseve të zhvillimit shoqëror në kuadrin e integritimit sugjerojmë përfshirjen në kurrikulën e studimit të një moduli mbi: “Inovacioni dhe shoqëria”, modul i cili trajtohet edhe në mjaft programe të ngjashme të këtij niveli në hapësirën universitare evropiane.



Conclusions of the study program Evaluation of the second cycle Master of Science in "Sociology of Social Developments" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"

Strengths and Affirmations

1. Directing and organizing the study program on the sociological processes of society's development under the influence of important social factors in the national and international framework. The study program "Sociology of social developments" of the second level Master of Science with its orientation supports and reflects the national interest and values.
2. Professionally trained, experienced and scientifically qualified academic staff is a good support for the quality realization of this study program.
3. Publications: university texts, monographs, scientific journals, summaries of studies as well as literature in Albanian and foreign languages are put at the service of students' academic training.
4. The University of Tirana represents the most well-known and sought-after brand at the university and postgraduate level for the reason that it represents the first HEI in Albania, the earliest from the experience, tradition and quality it has created.
5. The Faculty of Social Sciences represents a very important university, academic and scientific research institution in the field of Social Sciences.
6. The Department of Sociology is the first department in the field of Sociology in Albania, with a lot of experience and academic and scientific achievements, with admirable levels in teaching, scientific research and the most stable long-term support for the development of the science of Sociology in Albania.
7. The Master of Science in Sociology of Social Development study program has created tradition, stability and consolidation in its achievements.
8. The Master of Science in Sociology of Social Developments study program enables students to continue with the realization of the third cycle of the doctorate.

Weak points

1. The department's commitment to "International Projects" has not been sufficient to increase students' participation and mobility in these projects. **(Standard III, 10, page 52)**



Recommendations

1. The most in-depth study of the opportunities that the labor market has at the national and regional level for the students of this program, making improvements to the study curriculum, which can increase the attractiveness of this program.
2. In terms of curricular improvements, continued support of national interests, explanation and recognition of social development processes in the framework of integration, we suggest the inclusion in the study curriculum of a module on: "Innovation and society", a module which it is also treated in many similar programs of this level in the European university space.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS		
	Përmbushen plotësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen pjesërisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X
VLERËSIMI TËRËSOR			X